

Dibran Fylli
TOKË
e
MBJELLË ME VARRE
Argumente

Botues
ProkultPress

Konsulentë:
Prof. Dr. Mazllum Baraliu
Prof. Akad. Bedri Tahiri

Redaktorë:
Prof. Dr. Mazllum Baraliu
Mas. Sc. Fatmir Halimi

Recensentë:
Prof. Dr. Skender Kodra
Prof. Dr. Flori Bruqi

Lektor:
Prof. Zymer Mehani

Përgatitja kompjuterike dhe faqosja:
uniART Creative

Kopertina-dizajni:
Durim Fylli

© *autori*

Dibran Fylli


TOKË
e
MIBJELLË ME VARRË
Argumente

Krimet serbe në Kosovë 1998/1999

The logo for Prokult Press features a stylized blue and orange wave above the text. The word "PROKULT" is in a bold, black, sans-serif font, with "PRESS" in a smaller, black, sans-serif font directly below it. A horizontal line with a blue-to-orange gradient runs through the text.
PROKULT
PRESS
Prishtinë, 2019



NË VEND TË HYRJES



KOSOVA

Edhe njëherë në fundshekullin XX, armiku serb po vepronte përshfarosjen e popullit shqiptar të Kosovës, por, nënat shqiptare lindin nga pesë sokola, rritin nga pesë sokolesha, i bëjnë këmbë e dorë për t'i dalë zot atdheut, për t'i dalë zot tokës së shenjtë dhe për ta mbrojtur çdo pëllëmbë të saj me gjakun e tyre.

Kosovën qysh nga fillimi i ekzistimit të njerëzimit, çdo armik u mundua ta fshijë nga harta, por nuk ia dolën dot. Mbi këto troje shqiptarekishin ardhur shumë sundues të huaj, si: Hyrrieti e Turqia, Bullgaria e Krajlia..., por asnjëherë nuk mundën për ta gjunjëzuar popullin lirishtës. Përkundër të gjithave, populli shqiptar u mbijetoi të këqijave që po i vinin nga armiqtë e egër e sundimtarët, lakmitarë të tokave shqiptare.

Sunduesi karpatnjak serbosllav, ndër më të egrit, duke filluar nga vitet e hershme, u mundua dhe po mundohet ta fshijë nga harta e ta zhduk popullin e Drenicës e të Kosovës, por çdo herë munda i kishte shkuar e po i shkon huq. Edhe sot, kur po mundohet ta bëjë të njëjtën gjë, e ka të kotë, sepse këto troje dhe ky vend, me këtë popull trim e bujar, dinë të flasin e të mendojnë shqip, të rezistojnë e të mbrohen nga armiqtë, që i turren përreth.

Kosovës kurrë s'iu nda gazepi, qysh prej atëherë kur në tokën e saj shkelën Rashat e Gashat, Jovat e Millovanat... këta armiq morën shumë jetë njerëzish të pafajshëm dhe mundoheshin që krimet e veta t'i mbulojnë me formula të shpikura. Ata nuk e dinin se historia dikur do t'ua zbulojë krimet dhe të gjitha të zezat e tyre që po i ushtronin mbi popullin fisnik të Kosovës...

Në deklaratën zyrtare, të lëshuar më 29 janar 1953 mbi bisedimet në Split, të dy delegacionet fshehën marrëveshjen "Xhentëlmenë" dhe iu referuan bashkëpunimit parlamentar dhe çështjes së Paktit Ballkanik. Me këtë marrëveshje Tito realizonte

ëndrrën e serbëve për shpërnguljen e shqiptarëve nga Kosova, ndërsa Turqia fitonte banorë vitalë dhe mjete financiare.

Ç'do shqiptar do të shpallej i rrezikshëm dhe i dyshimtë për sigurinë e vendit, sidomos intelektualët me të cilët i mbushën burgjet dhe pas kësaj u shpik kombësia turke.



Zhdukja masive e shqiptarëve nga serbët në vitet 1912-1913

PROJEKTET ANTISHQIPTARE

Gjatë gjithë historisë, shumë intelektualë serbë kanë propozuar projekte të ndryshme antishqiptare. Janë të njohur, si: Jovan Cvijiç, Vaso Qubriloviç, Ivo Andriç, Vukotiq, Stevan Moljeviç dhe të tjerë.

“Urrejtja ndaj shqiptarëve, ka qenë, është dhe mbeti shumë e pranishme në Serbi. Urrejtja shprehet me stereotipe negative, me paragjykime dhe diskriminim ndaj popullit shqiptar”.^{1}

Urrejtja mund të marrë formën e racizmit, nëse është e lidhur me besimin se shqiptarët janë një lloj race inferiore. Ndjenjat antishqiptare janë pasqyruar në përdorimin e titullit “shiptari”, që kanë konotacione negative dhe në gjuhën e urrejtjes serbe konsiderohet ofendim.

Fillimet e propagandës antishqiptare në Serbi datojnë që nga fundi i shekullit XIX dhe janë të lidhura me aspiratat e shtetit serb ndaj territoreve të huaja, kryesisht të atyre shqiptare. Pas Luftës Serbo-Turke dhe zgjerimit territorial të Principatës së Serbisë, në vitin 1878, ndodhin dëbime masive me dhunë të shqiptarëve etnikë nga rajonet e pushtuara dhe ushtrohet gjenocid ndaj tyre, kryesisht ndaj Sanxhakut të Nishit, dikur i banuar me shqiptarë, duke djegur fshatrat shqiptare dhe pjesë të qyteteve. Edhe pse shumë personalitete serbe atëherë e kanë kundërshtuar dëbimin e popullsisë shqiptare, kryeministri serb Milan Piroçanac me këtë rast kishte deklaruar për këtë ngjarje: *“Nëse do t'i lejonim të qëndrojnë këtu shqiptarët, ata do të na krijojnë probleme”.*^{2}

Rritja e mëtejshme e ndjenjave antishqiptare kaloi në urrejtje. Kjo urrejtje, sipas projekteve antishqiptare lidhet me pretendimet e politikës së jashtme të Principatës së Serbisë, të parapara në Naçertanije.

{1- Dubravka Stojanoviç, shkencëtare serbe

{2- Milan Piroçanac, kryeministër i atëhershëm serb

Shpërngulja e popullit shqiptar nga trojet e veta stërgjyshore, ishte bërë me një dhunë sistematike nga serbët që nga 1877, si nga sanxhaku i Nishit, e nga Leskovci, Vranjë, Prokupla, Krushëvcit, Kurshumlisë e me radhë. Brenda një periudhe kohore të gjatë serbët bënë gjenocid, dhe shpërngulën me dhunë shqiptarët nga vendbanimet e tyre Ilire Dardane, sidomos në kohën e Lidhjes së Prizrenit të vitit 1877-1878.

Autorët serbë i përshkruajnë shqiptarët si banditë dhe uzurpatorë, duke i përmendur krimet e tyre kundër serbëve gjatë periudhave të ndryshme historike.

Ata, popullsinë shqiptare në Sanxhakun e Pazarit të Ri, të Kosovës dhe të Maqedonisë i paraqesin si lumë vërshues i dalur nga shtrati i vet dhe se Serbia do të kthehet në të ashtuquajturin “Djep” të saj.



*Dëshmitë rrëqethëse për dëbimin e shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit
1877/1878*

MBRETËRITË SUNDUESE

Mania shtetomadhe serbe përbën tiparin e përhershëm të politikës së Beogradit, kristalizues në mbretërinë jetëshkurtër, por mjaft të shtrirë të car Stefan Dushanit. Kjo u jep atyre të ashtuquajturën “të drejtë historike” për t’i hapur rrugën oreksit të madh të Serbisë së vogël, që të zbresë deri në ultësirat e ngrohta të Adriatikut, të Jonit, të Egjeut dhe të Detit të Zi.

Trajtat dhe emërtesat e një mbretërimi të tillë përshtateshin në varësi me kohërat:

- Mbretëri Serbe,
- Mbretëri Serbo-Kroato-Slllovene,
- Mbretëri Jugosllave,
- Federatë Ballkanike etj., ku promotori ishte Serbia.

Këto tipare i shkonin përshtati Serbisë për pushtim, serbizim e shfarosje të popullit shqiptar dhe deri diku edhe të popujve të tjerë fqinjë të Serbisë, gjë që vërehen gjerësisht në shekullin XIX në politikën antishqiptare të qarqeve sunduese serbe. Rrezikshmëria e tyre ishte në rritje gjatë shekullit të kaluar. Por, panserbizmi, si gjithnjë, gjatë tërë atij shekulli hasi në dy faktorë objektivë të pathyeshëm: në faktorët *lashtësi shqiptare* dhe *qëndresë shqiptare*.

Burimet dokumentare japin të dhëna të shumta për trojet shqiptare. Kjo tregon se populli shqiptar ishte një ndër popujt më të mëdhenj e më kompaktë në Ballkan. Prandaj fanatizmi serb, pas një letargjie dimërore nën Perandorinë Osmane, përgatitej të jepte goditjet vdekjeprurëse për të dobësuar e pastaj për të zhdukur fizikisht, siç ëndërronte, viktimën e vet të fuqishme. Nga ana tjetër, populli shqiptar mobilizonte forcat për t’i hyrë një beteje të gjatë, ku armiku nuk zgjedhte mjete as forma për t’ia arritur qëllimit.

HISTORIA TREGON

Plani i Ambasadorëve, në Londër, propozoi krijimin e kufijve të Shqipërisë, sipas statistikave etnike dhe fetare që do të mblihdeshin në terren nga një komision. Serbët, duke mësuar një lajm të tillë, nxituan për të ndryshuar sa më shpejt raportet e popullsisë vendëse me atë sllave. Etja serbe për pushtim tani kish gjetur një mjet për të shkatërruar ëndrrën e drejtë të këtij populli të guximshëm dhe liridashës, para se ajo të mund të realizohej. Trupat serbe pushtuan trojet shqiptare me zjarr dhe shpatë, me moton “*Në qoftë se shqiptarët nuk mund të mposhten, atëherë të paktën, populli shqiptar mund të asgjësohej*”. Kjo ishte zgjedhja për ta.

Shtëpi dhe fshatra të tëra u shndërruan në hi, popullsia e paarmatosur dhe e pafajshme u masakrua në masë, u kryen akte të pabesueshme të dhunës, të plaçkitjes dhe të brutalitetit të çdo lloji. Të tilla ishin mjetet që janë përdorur me objektivin e tjetërsimit të karakterit etnik të rajoneve të banuara ekskluzivisht nga shqiptarët. Pas pushtimit të trojeve shqiptare deri në brigjet veriore të lumit Shkumbin, serbo-malazezët kërkuan nga qarqet diplomatike të fuqive të asaj kohe që ata tashmë kishin vendosur në vend të drejtën historike të mohuar që në vitin 1389 me Betejën e Kosovës kundër myslimanëve pushtues, teori kjo që kishte vite që përpilohej nga nacionalizmi serb për ta bërë sa më të besueshëm dhe të pranueshëm në opinionin ndërkombëtar pushtimin dhe tjetërsimin e tokave dhe të popullsisë shqiptare. Shqiptarët u dëbuan dhe u vranë nga regjimi fashist serb. Nga muaji tetor 1912 deri në mars 1914 ishin vranë: 120.000 - 270.000, qenë dëbuar 255.878 (pa u numëruar fëmijët nën moshën 6 vjeç). Në gushtin e vitit 1914 numri i të dëbuarve kishte arritur në 281.747.

Ishte koha e shpërbërjes së Perandorisë Turke dhe e shpërthimit të Luftërave Ballkanike. Në vitin 1912, shumica e Kosovës ishte

marrë nga Mbretëria e Serbisë, ndërsa rajoni i Dukagjinit ishte marrë nga Mbretëria e Malit të Zi. Shqiptarët, në këto vite po dëboheshin me dhunë nga tokat e tyre prej forcave serbe.

Në fakt, “Kosova”, term ky i përdorur në atë kohë për herë të parë, ka qenë dhe është tokë historikisht shqiptare dhe i përkiste ilirëve që nga viti 1200 para Krishtit. Shqiptarët janë pasardhës të ilirëve dhe janë banorët autoktonë të Kosovës. Gjuha shqipe, e cila i përket grupit indo-evropian, ka fjalor të veçantë, morfologjinë dhe rregullat fonetike që kanë angazhuar vëmendjen e shumë gjuhëtarëve, nga të cilët disa kanë pohuar me besim, prejardhjen e saj nga ilirishtja e lashtë. Kosova edhe po të digjej e piqej, ishte dhe është tokë shqiptare...



Oficer serb e malazez, zbatues të urdhrave për spastrimin etnik të Kosovës

Burimi:

-/Dokumentet mbi politikën e jashtme e Mbretërisë serbe 1903-1914/, libri VII, vëllimi 1, f. 617- 618. Beograd 1980

ËNDRRA SERBE - SERBIA E MADHE

Në brigjet lindore të Adriatikut jetonin shqiptarët autoktonë, që shekuj me radhë u është dashur të luftojnë për lirinë dhe pavarësinë e vet kundër armiqve dhe shtypësve të të gjitha llojeve. Ky komb ka qëndruar i palëkundur në rrënjët e tij përmes luftërave të panumërta dhe të pabesisë historike. As migrimet e mëdha dhe as luftërat me romakët, turqit dhe pushtuesit e tjerë nuk i kanë penguar shqiptarët që ta ruajnë kombësinë e tyre, gjuhën dhe pastërtinë e origjinalitetin e zakoneve të tyre. Historia e kombit shqiptar është një zinxhir i pashkëputshëm i betejave të përgjakshme kundër shtypësve të dhunshëm, por edhe më keq, i mizorive që janë kryer mbi të, me qëllim që të asgjësohej si komb.

Viktimat e para të imperializmit serb ishin Maqedonia dhe Kosova. Megjithatë, imperialistët pan-serbë, të detyruar nga imperialistët më të fuqishëm për të nxjerrë përsëri nga bregdeti shqiptar, kanë mbajtur tokën më të mirë dhe më të begatshme të Shqipërisë, Kosovën. Ndërsa Fuqitë e Mëdha e njohën Shqipërinë si shtet sovran më 29 korrik 1913, kurse Kosova, Dibra, Ohri dhe Manastiri mbetën nën sundimin ushtarak serb dhe më 7 shtator 1913, Mbreti Peteri I i Serbisë deklaroi aneksimin e territoreve të pushtuara.

Gjatë pushtimit, ushtria serbe ka kryer krime të shumta kundër popullsisë shqiptare, me synimin për të realizuar ndryshimin e karakterit etnik të këtyre rajoneve, duke kryer krime, masakra, spastrim etnik, përdhunim sistematik dhe gjenocid. Krimet janë kryer zakonisht jashtë bazave etnike dhe fetare dhe ishin të drejtuara kryesisht kundër civilëve. Qëllimi i këtyre krimeve ishte për të krijuar një shtet të pastër etnik serb, ose “Serbinë e Madhe”, që përfshin Serbinë, si dhe zonat e populluara nga serbët në Ballkan.

MARRËVESHJA TURKO-JUGOSLLAVE E VITIT 1938 PAKTI BALLKANIK 28.02.1953

Ka patur dy marrëveshje të mëdha, që kanë patur për qëllim shpërnguljen e shqiptarëve nga trojet e tyre; Marrëveshja Turko-Jugosllave e vitit 1938 dhe Marrëveshja Turqi-Greqi-Jugosllavi, më 28 shkurt 1953, e njohur si Pakti Ballkanik, pra këto janë dy nënshkrimet më fatkeqe për shqiptarët.

Në bazë të hulumtimit sistematik të të dy shërbimeve konsullare jugosllave dhe turke, dëshmohet se në periudhën 1951-1968 prej Jugosllavisë në Turqi janë shpërngulur 414.500 shqiptarë, ndërsa gjatë periudhës në fjalë, bazuar në statistikat sekrete jugosllave, në Kosovë ishin sjellë në heshtje 63.000 kolonë sllavë, prej të cilëve, shumica prej tyre ishin udbashë e kriminelë të ardhur nga Serbia.

Ndërkaq sipas statistikave të publikuara më vonë del se në periudhën 1952-1965 për në Turqi janë shpërngulur 452.371 shqiptarë.


Në ato vite me dhunë detyrohen të shpërngulen edhe mijëra shqiptarë, kryesisht nga Mali i Zi: nga Hoti, Gruda, Plava, Gucia, Vuthaj, Ulqini, Tivari, Triepshi, Shpuza, Kraja etj.

Në dimrin e vitit 1955/56 organizohet aksioni për mbledhjen e armëve dhe gjatë këtij procesi të dhunshëm ishin keqtrajtuar në format më mizore mëse 30.000 shqiptarë. Në këtë ekspeditë udbeske, nga rrahjet dhe torturat u mbytën 103 shqiptarë, ndërsa u gjymtuan për jetë rreth 10.000 të tjerë!...

Hulumtimet shkencore për zbardhjen e një ngjarje historike, siç është marrëveshja “xhentëllmene” Turko-Jugosllave e vitit 1953 ndërmjet Titos dhe Kypreliut, sado që janë jo të mjaftueshme, prapë na japin një pasqyrë shumë të mirë për ta kuptuar këtë marrëveshje.

Pas vitit 1953 filloi dëbimi masiv i shqiptarëve për në Turqi, gjë e cila e zbardhi këtë marrëveshje. Represioni serb u përcoll nga instrumentet shtetërore dhe në mënyrë të organizuar nga vetë shteti serbo-jugosllav.

Paraprakisht ishte një marrëveshje mes Jugosllavisë dhe Turqisë, e njohur si “Konventa Jugosllavo-Turke e vitit 1938”, e cila parashihte dëbimin e shqiptarëve për në Anadoll. Çështja e shpërnguljes së shqiptarëve pothuajse u hesht gjithëherë, ndërsa u shkrua dhe u propagandua nga qarqet serbe, kinse për shpërngulje serbo-malazeze, që në të vërtetë nuk ishte asgjë tjetër, veçse migrim i vogël, i vullnetshëm i popullsisë.



Shpërngulja me dhunë e shqiptarëve për Anadol (1953)

Burimi:

-Hakif Bajrami /Politika e shfarosjes së shqiptarëve dhe kolonizimi serb i Kosovës 1844-1995/

-Sabile Basha /Dëbimet e shqiptarëve dhe kolonizimi i Kosovës 1877-1995/

FAKTE TË VITEVE 1920/1921

Në vitet 1920/'21, oficeri serb i quajtur Kapiten Rasha me ushtarët e vet sejmënë, gjithmonë të etur për gjak shqiptari dhe me urdhrat e autoriteteve serbe, filloi fushatën e djegies të këtyre fshatrave. Më 15.11.1920, në orët e hershme të kësaj dite kobzezë, kapiteni me ushtarët e vet bëri plaçkitjen e shumë fshatrave, gjë që kuptohej se më pas këto fshatra do të bëheshin shkumb e hi...

Flakën ua vuri fshatrave, u dogjën këto shtëpi shqiptare:

Taragja 18 shtëpi, Zallaku 20 shtëpi, Bikashi 21 shtëpi, Shtitari 30 shtëpi, Duboci 40shtëpi, Beqiqi 15 shtëpi, Prelloci 25 shtëpi, Krasaliqi 20 shtëpi, Kazhica 30 shtëpi, Krasmiroci 40 shtëpi, Brezniku 15 shtëpi. Këtyre shtëpive ua vuri zjarrin, nga të cilat më parë kishin plaçkitur çdo gjë. Ata plaçkitën 1200 krerë lopë, 3500 dele, 400 mijë kg. drithë dhe të gjitha pasuritë tjera. Në këtë rast 255 familje që bënëin 3060 veta, të shkretë, pa shtëpi e pa mall, të gjithë ikën e u shpërndanë nëpër fshatrat më të thella të Drenicës për t'i shpëtuar gjenocidit serb, ndër ta shumë pleq e plaka dhe fëmijë, të cilët nuk kishin arritur të ikin, ishin djegur në zjarr. Në mesin e të djegurve ishte edhe Azem Krasaliqi, plak 100-vjeçar.

Kapiten Rasha duke mos u ngopur me këto mizori, mblodhi të gjitha batalionet që asaj kohe ishin në Mitrovicë e në Vushtrri, duke filluar një operacion mizor kundër shqiptarëve.

Më 20.11.1920, pamëshirshëm vrau një burrë dhe një grua nga fshati Bikosh. Këta të pambrojtur i kishte takuar rrugës, ata kishin dalë për të kërkuar strehim, pasi që shtëpia e tyre u ishte djegur nga zjarri i kriminelëve të kapitenziut.

Më 21.11.1920, i njëjti vrau Kadri Asllanin bashkë me të birin e tij, Shaqirin dhe një tjetër burrë, po nga kjo shtëpi. Edhe këta ishin duke kërkuar strehim.

Kapiten Rasha në qarqet e Beogradit është i përmendur si armik i përbetuar i shqiptarëve, i cili ka marrë shumë grada e nishane për shërbimin e besnikërinë që ai bëri në zbatim të programit që thoshte: "Të gjithë shqiptarët duhet t'i shpërngulim nga Kosova, ose shkurt, t'i vrasim...", pra parime që kanë serbët dhe diplomacia e tyre.

Kjo nuk është e tëra. Ky kapiteni pangopur me gjakun e shqiptarëve, kishte shkuar vetë në fshatin Salle, kishte marrë Feriz Sallqin (të parin e fshatit) me 16 vetë të tjerë. Prej aty kalon në fshatin Beçuk dhe i merr 12 shqiptarë. Në fshatin Strofc e merr Bajraktarin me 23 veta. Kalon në fshatin Zhilivodë, ku e merr Limon Brahimin me 16 veta. Në fshatin Gradicë e merr Ymer Azemin me tre të tjerë dhe pasi i kishte tubuar 74 veta, të gjithë shqiptarë të pafajshëm e të moshave të ndryshme, të cilët as që e dinin pse ishin marrë, por sipas fjalëve të kapitenit, që ua kishte thënë atyre, ata do të dërgoheshin në Vushtrri, pa e ditur arsyen. Ky i pashpirt, në vend që t'i dërgojë në Vushtrri, i çon në malin Makosh dhe aty i ekzekutoi të gjithë, duke mos i shpëtuarvdekjes asnjëri nga të 74-tit, sa ishin. Këtë ua bëri vetëm pse ishin shqiptarë, pra sipas formulës serbe "kundër shtetit". Këta mbetën të vrarë, të shtrirë për tokë, të masakruar nga dora e tij gjakatare dhe pas 6 ditësh u gjendën kufomat e tyre, të cilët u varrosën nga disa fshatarë, që ishin afër këtij vendi.

Më 23.11.1920 ishin vrarë edhe dy burra e dy gra të familjes Prekaj nga Dobroshefci. Po të njëjtën ditë, e njëjta dorë gjakatare vrau edhe Qerim Mehmetin me tre shokët e tij dhe shumë njerëz të tjerë, të gjithë nga fshati Gllanasellë. Ushtarëte Rashës nuk ndalonin dot. Ata ishin kanibalë të vërtetë, që po në këtë ditë vranë edhe Mulla Latifin dhe Mulla Bajramin, imamin e fshatit Verbofc dhe Mulla Ismajlin, imamin e fshatit Palac.

Më 24.11.1920 sejmenët serbë të kapitenit vranë Bilall Tahirin nga fshati Shtuticë, bashkë me nipin e tij, Rexhë Muratin

fshati Shtuticë, bashkë me nipin e tij, Rexhë Muratin nga Krasaliqu me të vëllanë Bajramin, si dhe Sefer Xanin nga Palaci. Që të dy ishin pleq 80 e 90 vjeç.

Më 27.11.1920, autoritetet serbe të dirigjuara nga komanda supreme e kapiten Rashës vranë një grua me fëmijën e saj 9-muajsh nga fshati Dubofc. Në Lubovec, në shtëpinë e tij e zunë dhe e vranë Bislim Fejzullahun, prapë sipas formulëssë njëjtë serbe.

Më 28.11.1920, këta të pashpirt vranë Hysen Qelën prej fshatit Dërvar, të cilin bashkë me 16 shqiptar të tjerë prej moshës 7-70 vjeç, të gjithë prej këtij fshati, i kishin lidhur duar e këmbë dhe i kishin therur me bajoneta në malin Qyqavicë.

Për përfundim rrjedh vetë logjika: atëherë dhe sot nëpër trojet shqiptare shkelte po i njëjti armik, që kishte po të njëjtat qëllime dhe bënte po të njëjtat krime, si dhe ushtronte të njëjtën metodë e presion për spastrim etnik.

Këta mizorë çdo herë iu kanë turrë Drenicës rreth e përqark, kështu që më 04.01.1921, ushtarët serbë dalin prej Rahoveci dhe vijnë në fshatin Gjurgjevik, ku djegin shtëpinë e Sadik Ramës, pa i përmendur mijëra shqiptarë, që janë rrahur në rastin e zgjedhjeve për çështje të partive, për arsye se shqiptarët e asaj kohe nuk donin t'i njohin as radikalët dhe as demokratët, sepse për ta kishin një qëllim. Do ta përmendim një çështje të rëndësishme të qeverive jugosllave. Qeveria apo autoritetet e saj serbe, atëherë nëpërmes Rashës e Qubrilloviqit e më vonë të Millosheviqit, pa paragjykuar se nesër kush mund të dalë në skenë, që nga atëherë e deri më sot kanë për qëllim dëbimin e shqiptarëve nga trojet e tyre, pra spastrimet etnike.

Burimi:

-Sabile Basha, /Dëbimet e shqiptarëve dhe kolonizimi i Kosovës 1877-1995/

-Nga raporti i KMDLNJ-së

DRENICA - FLAMURTARE E LIRISË

Beogradi, që nga vitet e njëzeta, e sidomos në vitet 1945 e këndej e cilësonte Drenicën si një rajon kryengritës. Sipas realitetit, Drenica ia kishte ndalur hovin çdo armiku që me kokë lart i mësynte trevat e saj.

Kështu veproi Drenica, sipas fakteve historike, kur ushtria serbe nxori dhe i vuri përballë UÇK-së mbi 600 tanke të kalibrave të ndryshëm, topa dhe armë tjera të rënda, duke mos i përjashtuar as raketat tokë-tokë që zbrazeshin mbi malet e saj. Nga shtëpitë e veta u detyruan të zhvendosen të moshuar, gra e fëmijë, por jo edhe ta kalojnë kufirin. Ata dolën nëpër male, lugje e lugina të Drenicës nën qiellin e hapur duke u zhvendosur nga një anë në anën tjetër, por gjithmonë brenda territorit të Kosovës. Numri i të zhvendosurve arriti deri në 48.000, të gjithë të ikur nga zonat e rrezikuara, nga vendet ku shkelte armiku me arsenalin luftarak.

Makineria ushtarake e policore serbe drejtohej nga oficerë të lartë serbë e rusë. E gjithë kjo ndodhi e Drenica dhe ushtria e saj i rezistoi armikut shekullor serbosllav.

POPULLI LIRIDASHËS

Populli shqiptar ishte, ka qenë dhe mbeti i pamposhtur, i pathyeshëm, besnik e bujar. Ai ka qëndruar gjithmonë në mbrojtje të vendit, kur qe nevoja edhe me armë në dorë, për t'i dalë zot atdheut, duke i thënë vdekjes "qe ku jam në fushë të nderit, në roje të atdheut". Ky popull kurrë s'e njohu fjalën robëri.

Burimi:

-Dibran Fylli, /Prekazi brezni trimash/ kronologji, f. 3, Prishtinë 2012

LUFTA E UÇK-së ISHTE E PASHMANGSHME

Sa i përket spastrimeve etnike në Kosovë, serbët u munduan, por nuk ia arritën, sepse gjithherë kanë hasë në rezistencën e trimërive, si në Drenicë ashtu edhe në rajonet tjera të Kosovës. Këta trima të natyrës, edhe kur nuk kishin armë zjarri, luftën kundër armiqve e bënë me sëpata dhe nuk frikësoheshin të vdisnin duke mbrojtur nderin e kombit e të atdheut. Kujtojmë trimëritë e Ahmet Delisë që luftoi në Prekaz me serbët, duke mbrojtur nderin e komshiut të vet. Ahmet Delia nuk është i vetmi, që ishte i pakënaqur me regjimet e huaja në Kosovë, ngase të pakënaqur ishin edhe shumë patriotë të tjerë që luftonin kundër armiqve në ditët dhe netët e dimrave të gjatë, si: Shotë e Azem Galica, Shaban Palluzha, Mehmet Gradica, Bec Sinani, Hysen Shala, Nak Berisha, Tahir Meha e deri tek Adem Jashari. Këta e shumë patriotë të tjerë kurrë s'u pajtuan me armikun dhe luftuan deri sa ranë për të mos vdekur kurrë.

Duke e parë armiku serbosllav se shqiptarët nuk nënshkruajnë me gisht, u vërsul dhe ua mori universitetin, ua ndaloi edhe atë pak punë që kishin, ua mori administratën dhe më në fund edhe të drejtën për të jetuar.

Me rënien e LKJ-së e me ndërtimin-riemërimin e një reparti të ri të saj në Kosovën e robëruar, populli shqiptar u sul pas duke menduar se aty do ta gjente shpëtimin, por edhe kjo përpjekje ishte e kotë, ishte humbje, ishte vonesë, në mos e tepruar, e qëllimshme po se po! Vite me radhë priti populli, më në fund mbeti duke kërkuar mëshirë nga reparti i ri, i quajtur LDK, që të apelojë tek institucionet ndërkombëtare gjoja se ç'po ndodhte me popullin shqiptar. Nga metoda e re e repartit të ri ndodhi edhe kjo, 400.000 shqiptarë të shpërnguleshin nga Kosova. Të gjithë ishin të përndjekur nga regjimi fashist i Beogradit.

Pas humbjes kot së koti të kohës shumëvjeçare, populli shqiptar i Kosovës humbi durimin, ngase e kuptoi se me politikën paqësore duhet duruar vetëm dajak shpinës dhe asgjë tjetër, atëherë filloi të organizohej, duke ndërmarrë aksionet e para kundër forcave pushtuese serbe. S'do të kalojë shumë kohë, kur do të themelohej e konsolidohej Ushtria Çlirimtare e Kosovës me në krye Komandantin e saj, Adem Jashari.



Burimi:

-Dibran Fylli, Argumente /Drenica dikur e sot /, Tiranë, 1998

28 NËNTORI I RI

Drenica ka qenë dhe mbetet ashtu siç ishte. S'iu nënshtrua as car Dushanit e as Milloshit e Millanit. Organizoi, themeloi e konsolidoi ushtrinë çlirimtare, që lindi nga vetë populli i saj - UÇK-në e lavdisë.

UÇK-ja doli në skenë publikisht më 28.11.1997, në varrimin e mësuesit Halit Geci, në Llaushë të Skenderajt, i cili ra nga plumbat e armikut serb, në shkollën e fshatit.

Nga Prekazi heroik, nga kodra e Açarevës, Vajniku, Rezalla, Llausha e nga shumë vende tjera, pra nga mbarë Kosova, iu drejtua pushka Serbisë, duke i treguar se malet dhe shtëpitë tona janë plot ushtarë, që duan dhe dinë ta mbrojnë nderin e kombit, duke mos e kursyer as pikën e fundit të gjakut të tyre për atdhe.



*Paraqitja publike e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës
Llaush-Skenderaj, 28.11.1997*

Burimi:

-Argumente /Drenica dikur dhe sot /, Tiranë, 1998

UÇK NDËRRON POZICIONET DHE TAKTIKËN

Një luftë heroike që bëri Ushtria Çlirimtare e Kosovës është për t'u admiruar nga e gjithëbota. Kjo ushtri, më e reja në botë, i rezistoi armikut që është i njohur për mizoritë e bëra më parë në luftërat që zhvilloi në Slloveni, Kroaci dhe Bosnjë, e tani në fund të ekzistencës po përdorte metodat më barbare e çnjerëzore ndaj popullit shqiptar të Kosovës.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës, edhe pse e pabarabartë me atë serbe, i bëri rezistencë armikut, duke zhvilluar beteja pothuajse në të gjitha viset e Kosovës. Në rezistencë të madhe serbët hasën edhe në Açarevë, ku në ofensivën e 4 gushtit patën humbje të mëdha si në njerëz, ashtu edhe në makineri. Në këtë betejë morën pjesë qindra mijëra ushtarë, policë, paramilitarë serbë e mercenarë rusë. Ata futën në përdorim armët e rënda dhe tërë arsenalin luftarak. Aty mësynë mbi 100 automjete të blinduara luftarake të kalibrave të ndryshëm, duke mos i përjashtuar as tanket e rënda, as raketat tokë-tokë e tjera.

Falë shkathtësisë së UÇK-së që ndërroi pozicionin dhe taktikën e luftës, kjo makineri policore e ushtarake serbe nuk ia arriti ta shkatërrojë tërë fshatin, por dogji e shkatërroi disa lagje, kurse lagjen e Fyllajve, nga ku u bë rezistenca titanike, e shkatërruan tërësisht. Në këtë lagje i bënë rrafsh me tokë 14 shtëpi, duke djegur dhe plaçkitur çka shihnin dhe zinin përpara. Krejt çka ishte shqiptare u shkatërrua nga çetnikët e pamëshirshëm serbë.

Kështu ndodhi edhe me fshatrat Morinë, Rezallë, Ticë, Plluzhinë, Likofc..., ku këto hordhi çetnike tentonin çdo ditë që nga Skenderaj të kalonin në Likofc, aty ku ishte vendosur SHP i UÇK-së. Forcat e UÇK-së u ballafaquan me armikun fytafyft. Në çdo betejë, armiku pësonte humbje të mëdha.

Një ditë, forcat e UÇK-së u detyruan që t'i ndërrojnë pozicionet e veta për ta ndihmuar popullatën civile të kësaj ane që të zhvendoseshin në vende më të sigurta. Të zhvendosurit ishin kryesisht pleq, gra, fëmijë dhe të sëmurë...



Largimi i popullatës civile nga barbaria serbe në vitin 1998/1999

Karakteristikat kryesore të UÇK-së ishte; lufta e drejt dhe përcaktimi për t'u sakrifikuar për lirinë e atdheut. Aktet e saj të heroizmit përbëjnë pikat kulmore nga më të lartat që njeh historia jonë kombëtare.

Burimi:

-Argumente /Drenica dikur e sot /, Tiranë 1998,

-Dibran Fylli, /Shënime nga ditari i luftës/, Açarevë-Drenicë, 1998

UÇK - REALITET DHE E SIGURT NË FITORE

Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte forca që e detyroi Serbinë ta nxjerrë nga kazernat ushtrinë dhe arsenalin e vet luftarak kundër forcave çlirimtare të Kosovës, pasi që me polici po humbte betejë pas beteje. Dikur, dikujt, ndoshta edhe shumëkujt i shkonte ndërmend se në Kosovë po bëhej luftë civile, apo edhe konflikt, por jo, në Kosovë po zhvillohej luftë çlirimtare në mes UÇK-së dhe ushtrisë e policisë serbe, në mes okupuesve dhe çlirimtarëve, ku pala serbe luftonte për ta mbajtur Kosovën nën okupim, kurse Ushtria Çlirimtare e Kosovës luftonte për çlirimin e vendit nga okupatori që drejtohej nga kriminelët serbë. Ndonjëherë disave u shkonte mendja të thoshin se në Kosovë UÇK-ja po bënte luftë fetare (kjo është absurde). S'e hedhim poshtë as faktin se disa të tjerëve u shkonte ndërmend të thoshin se këta janë terroristë, e çka jo tjetër, por realiteti doli ndryshe, gënjeshttrat ngelën gënjeshttra, realiteti po mbetet ai që është.

UÇK-ja në radhët e saj kishte trimëresha e trima me zemër të Shotë e Azem Galicës, që me armë në dorë po i dilnin zot atdheut. Kur e vërtetoi bota e civilizuar (por pak e vonuar) se në Kosovë UÇK-ja bënte luftë të drejtë çlirimtare, e jo civile, nacionale, fundamentaliste, e ku ta dije sesi ndryshe e interpretonin fatzinjtë, (për fatin e keq kishte ndër shqiptarë që e quanin edhe dorë e zgjatur e Serbisë), atëherë bota e mori këtë çështje më seriozitet dhe e vuri në rend dite. Pranoi komunikimin përmes të dërguarit special, z. Riçard Holbruk.

Riçard Holbruk më 24 qershor të vitit 1998 e bëri takimin e parë me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës në Junik të Kosovës. Ishte diplomati i parë amerikan që takoi publikisht pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në kohën kur ajo nuk ishte pranuar ende nga shumica e vendeve perëndimore.

Ai ishte një takim që faktikisht shqiptarët në përgjithësi e kishin ëndërruar, jo vetëm luftëtarët e UÇK-së, të lirisë, por edhe vet populli kur përfundimi dhe konkretisht SHBA-të do ta kthenin kokën nga Kosova dhe ta shohin që lufta e UÇK-së në Kosovës është e drejtë. Prandaj ardhja e Richard Holbrooke për shqiptarët ishte një gëzim i madh, sepse e kuptuan që SHBA-të kanë filluar ta kuptojnë luftën e drejtë të Kosovës.

Ai ishte diplomat shumë i drejtpërdrejt e jashtëzakonisht i sinqertë. Dhe kulmi i atij takimi, i gjithë asaj bisede që kishte zgjatur rreth një orë e dyzet minuta, ishte se; nëse UÇK-ja do t'i bashkërendojë veprimet e veta me SHBA-n dhe NATO-n, Kosova do të fitojë. Do të fitojë edhe po qe se UÇK-ja të gjitha betejat e veçanta do t'i humbë.



Diplomati amerikan Richard Holbrooke dhe Hajdin Abazi-Lum Haxhiu

Burimi:

-Argumente /Drenica dikur e sot /, Tiranë, 1998

-Mr. Hajdin Abazi, /Shënime nga Ditari i luftës/,qershor 1998

SERBËT GJATË LUFTËS NË KOSOVË, UA KANË NXJERRË ORGANET QINDRA SHQIPTARËVE {3

Në Raportin e Komisionit Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur, thuhet se gjatë luftës në Kosovë, në mesin e viktimave civile, të cilat janë gjetur në varrezat e masive në Serbi, janë ngritur dyshime serioze për heqjen e organeve të civilëve shqiptarë, që ishin marrë peng nga forcat serbe në Kosovë.

Ky raport është hartuar nga antropologu i lartë i ICMP-së, për mjekësi ligjore Dr. Mark Skinner, sipas të cilit këto dyshime janë përqendruar te 82 persona, të cilët ishin transportuar të gjallë deri në Serbi, ku të njëjtit më pas ishin varrosur me arkivole dhe qese të etiketuara në varrezat e Rashkës, Batanjicës dhe Petrovosellës.

Espertiza ka vërtetuar se këta trupa nuk ishin ekzekutuar me plumba apo mbytur me mjete tjera, por vdekja e tyre është kretjesisht e një natyre tjetër, ka shkruar në raport Dr. Skinner, i cili potencon se në Batajnicë kishte 8 lokacione, ku janë bërë këto zhvarrime. Të gjitha lokacionet në këtë raport janë shënuar me shkurtesa si; BA1, BA2, deri në BA8.

Nga zhvarrimet e këtyre lokacioneve janë 705 kufoma të plota. Serbia nuk ka qenë aq humane që t'i dërgojë viktimat për pushkatim e më pas të përkujdesej për varrimin e tyre në mënyrë të rregullt.

Në mesin e këtyre viktimave që dyshohet se iu janë nxjerrë organet, kanë qenë 13 meshkuj, 14 femra dhe 9 fëmijë.

{3 Dr. Mark Skinner, /Të dhëna nga raporti i ICMP-së/

KRIMET SERBE NĚ KOSOVĚ



MASAKRA E LIKASHANIT DHE E QIREZIT 28.02.1998

Kur e kuptoi makineria vrastare serbe se në Drenicë populli kishte mbrojtje, kishte ushtrinë e vet çlirimtare, më datën 27.02.1998 ishte drejtuar papritmas dhe në mënyrën më tinëzare për të hyrë në Likashan e Qirez, aty ku edhe ndodhi masakra e paparë në fundshekullin e kaluar.

Më 28 shkurt deri më 1 mars 1998, në Likoshan dhe Qirez të Drenicës ndodhi njëra prej betejave të përgjakshme, që u shoqërua me përballje luftarake ndërmjet njësiteve të UÇK-së dhe policisë e ushtrisë serbe të Lisat Binjakë. Ato ditë u vranë 24 banorë të Likoshanit, Qirezit dhe një nga fshati Gradicë i komunës së Drenasit, në mesin e të cilëve kishte edhe fëmijë dhe një grua shtatzënë.

Ushtria e policia serbe gjatë ushtrimit të krimit mbi popullsinë civile përdorën mjete të blinduara dhe helikopterë. Likashani dhe Qirezi, fshatra të komunave Drenas, përkatësisht Skënderaj, të shtunën dhe të dielën, më 28 shkurt dhe 1 mars 1998 deri në orën 15 përjetuan një terror 26-orësh, që u shoqërua me krim të policisë dhe ushtrisë serbe. Lagjet e Gjellajve në Likashan dhe ajo e Prekazëve të Qirezit, befaz u gjetën nën terrorin shtetëror serb dhe përjetuan masakër, që serbëbënë mbi popullatën e asaj ane. Banorët e këtyre fshatrave, ato ditë u qëlluan pandërprerë nga armët automatike, të mjeteve të blinduara dhe të artilerisë kundërajrore.

Të shtunën, në ora 11 e 40 minuta, në fshatin Likashan, një veturë e stacionit të policisë serbe të Drenasit është ndeshur me një patrullë të UÇK-së, të Lisat Binjakë. Me këtë rast, vetura e policisë serbe nuk ka lëvizur nga vendi. Të vranë në vend kanë mbetur disa policë serbë. Mirëpo, pas dhjetë minutave, veturës i ka ardhur në

ndihmë një veturë e policisë, një pizgauer dhe një helikopter, i cili ka shtënë mbi fshatrat Likashan e Qirez. Ndërkohë, nga drejtimi i Aeroportit të Prishtinës, duke fluturuar fare ulët mbi shtëpitë e fshatit Dobrashefc, ka ardhur edhe helikopteri tjetër, i cili më pastaj ka shtënë mbi shtëpitë e lagjes Gjelij dhe të Prekazëve të Qirezit. Këto të shtëna patën zgjatur deri në orën 23.15 minuta të ditës së shtunë. Ndërkaq, helikopteri i tretë mbi këtë lagje është sjellur, duke shtënë gjatë tërë kohës dhe bashkë me dy helikoptere tjerë janë larguar dhjetë minuta para orës 18.

Shtetrrëthimi i fshatrave nga policia dhe ushtria serbe ndodhi edhe ditën e dytë, më 1 mars 1998, deri në orën 15:15 minuta.

Lidhur me këtë rast, drejtoresha shumëvjeçare e Fondit për të Drejtën Humanitare (FDH) Natasha Kandiç, duke iu referuar dëshmimeve të pjesëtarëve të policisë serbe pjesëmarrës në këtë masakër, ka deklaruar:

“... Urdhëresat për likuidim nuk i kanë dhënë vetëm komandantët e njësiteve policore dhe ushtarake. Ata (policët serbë) më kanë thënë se personalisht Danica Marinković (gjykatëse hetuese e Gjyqit të Qarkut në Prishtinë) ka urdhëruar likuidimin e disa meshkujve të plagosur të familjes Ahmeti, më 28 shkurt 1998, në fshatin Likoshan. Në hetimet në vendin e ngjarjes ajo ka ardhur në përcjellje të zëvendësit të prokurorit publik të qarkut, Jovica Jovanović, dhe punëtorëve të policisë kriminalistike. Para shtëpisë së familjes Ahmeti gjendej turma e kufomave. Disa meshkuj jepnin shenja jete. Në praninë e rreth 30 pjesëtarëve të njësiteve speciale antiterroriste, gjykatësja hetuese Danica Marinković thuhet se ka thënë: “Unë këta nuk i marr, vrisni”. Atyre u është dhënë fund me hekler...”⁴

⁴ Natasha Kandiç, /Gjyqtarja urdhëroi vrasjen e të plagosurve në Likoshan/, "Koha Ditore", 8 mars 2002.

Të ekzekutuarit-masakruarit më 28.02.1998:

1. Ilir Nebihu (30 vjeç), nga Qirezi
2. Rukie Nebihu (27), Qirez
3. Xhemshir Nebihu (33), Qirez
4. Rexhep Rexhepi (63), Qirez
5. Beqir Rexhepi (30), Qirez
6. Beqir Sejdiu (26), Qirez
7. Nazmi Sejdiu (24), Qirez
8. Bedri Sejdiu (24), Qirez
9. Bekim Sejdiu (23), Qirez
10. Ismail Behrami (30), nga Baksi
11. Behram Fazliu (50), nga Gradica
12. Ahmet Ahmeti (50), nga Likashani
13. Elhami Ahmeti (16), Likashan
14. Shemsi Ahmeti (21), Likashan
15. Lumni Ahmeti (20), Likashan
16. Naim Ahmeti (22), Likashan
17. Driton Ahmeti (23), Likashan
18. Hilmi Ahmeti (48), Likashan
19. Basri Ahmeti (20), Likashan
20. Hamzë Ahmeti (44), Likashan
21. Gani Ahmeti (46), Likashan
22. Ibish Rama (38), Likashan
23. Muhamet Gjeli (70), Likashan dhe
24. Naser Gjeli (38), nga Likashani.

Burimi:

-Zeqir Bekolli, gazetar i luftës, /Shënime nga ditari i luftës/ Drenicë 1998

-Argumente /Drenica dikur e sot /, Tiranë 1998

PREKAZI - DJEP I LIRISË

Rrethimi i Kullës së Jasharëve në Prekaz, më 5, 6 dhe 7 mars 1998

Edhe pse Prekazin e kishin sulmuar më 22.01.1998, pikërisht shtëpinë e Shaban Jasharit, çetnikët serbë nuk u ngopën vetëm me disa të plagosur e të vrarë, por, të njëjtit, tani me formacionet policore ushtarake, më datën 05.03.1998, në orët e hershme të mëngjesit kishin filluar një sulm të ri mbi Prekaz. Pikësynim kishin prapë kullat e Shaban Jasharit.

Rreth e përqark Fabrikës së Municionit në Skënderaj, më 3 dhe 4 mars, ishin dislokuar forca të shumta të artillerisë së rëndë. Po ashtu, policia serbe kishte bërë përforcime të shumta nëpër të gjitha postbllloqet e saj në Drenicë. Në orën 5:30 të datës 5 mars, artilleria serbe, nga Fabrika e Municionit fillon gjuajtjet në drejtim të kullës së Shaban Jasharit dhe të të gjithë Jasharëve. Lufta dhe qëndresa titanike e kryetrimave në Prekaz kishte dhënë kushtrimin në të gjitha trojet e Shqipërisë dhe në mërgatë.

Anteu i lirisë, Adem Jashari, kishte marrë vendimin historik, vendimin më të vështirë dhe më të dhembshëm që ka marrë ndonjëherë njeriu, gjatë tërë historisë së qytetërimit.

-Nuk do të dorëzohemi për së gjalli!

-Vratarët nuk do të kalojnë, veçse mbi trupin tim të vdekur!

Tashmë ishte e largët koha kur thirrja e çetave të trimave të Drenicës: “Prite Azem Galicën, ore!”, ua kallte datën hordhive të krajlit serb. Vitet dhe dekadat e robërisë së Kosovës kishin venitur në kujtesën e sunduesit serb, pamjen e dragoit të Galicës, që fluturonte hipur në kalë. Vetëm atëherë kur lubisë serbe i doli përballë uniforma e UÇK-së, si fantazmë tmerruese, pushtuesit serbë, sikur të parët e tyre dikur, filluan të ndiejnë dridhjen nën këmbë të tokës arbërore.

Ushtria e policia serbe kishte provuar disa herë ta kafshonte Drenicën: në Prekaz, në Llaushë, në Vajnik, në Likashan, në Qirez e sërish në Prekaz. Më 5 mars, ajo po rikthehej edhe një herë te Prekazi i legjendave të trimërisë, për ta kafshuar helmueshëm Drenicën. Po sulmohej Kështjella e Jasharëve, ku ruhej i paprekur nderi shqiptar. Ajo kishte brenda zemrën e madhe të kryekomandantit të luftës për liri, Adem Jashari, plakun fisnik Shaban Jashari, trimin e paepur Hamëz Jashari, nipat dhe mbesat e Shotës. Mëngjesi i asaj dite të acartë marsi, bashkë me krismat dhe me zjarrin e topave, po derdhte mbi Prekaz edhe tërë llahtarinë e barbarisë serbe. Por, atë çast, brenda kështjellës u mor vendimi i madh:

-Nëse duhet vdekur dikush, më mirë unë, sesa Kosova ime,- kishte thënë Komandanti.

- Nëse duhet vdekur dikush, më mirë të gjithë ne, sesa Atdheu,- kishin thënë të gjithë Jasharët në Kështjellë.

Po shkrepnin pushkët, e po këndonte zemra shqiptare. Pushka dhe kënga e trimave po shkruanin simfoninë e qëndresës së pamposhtshtur, jehona e tyre po prekte rrënjët dhe majën e historisë së luftës sonë për liri. Në Prekaz po bëhej historia. Kështjella e Jasharëve po bëhej muranë e lirisë.

Në këtë operacion shfarosës nga forcat serbe ranë:

1. Adem Shaban Jashari (1955-1998), Prekaz
2. Adile B. Jashari (1957-1998), Prekaz
3. Afete H. Jashari (1980-1998), Prekaz
4. Afije A. Jashari (1938-1998), Prekaz
5. Ajvaz K. Jashari (1980-1998), Prekaz
6. Ali R. Jashari (1937-1998), Prekaz
7. Avdullah Z. Jashari (1982-1998), Prekaz
8. Bahtije M. Jashari (1953-1998), Prekaz

9. Beqir B. Jashari (1955-1998), Prekaz
10. Besim H. Jashari (1981-1998), Prekaz
11. Blerim H. Jashari (1985-1998), Prekaz
12. Blerim Z. Jashari (1992-1998), Prekaz
13. Blerina H. Jashari (1991-1998), Prekaz
14. Bujar Z. Jashari (1987-1998), Prekaz
15. Elfije S. Jashari (1963-1998), Prekaz
16. Elheme U. Jashari (1938-1998), Prekaz
17. Faik T. Jashari (1964-1998), Prekaz
18. Fatime H. Jashari (1989-1998), Prekaz
19. Fatime S. Jashari (1970-1998), Prekaz;
20. Fatime Xh. Bazaj (1978-1998), Tërstenik;
21. Feride H. Jashari (1955-1998), Prekaz
22. Fitim A. Jashari (1980-1998), Prekaz
23. Hajrije Z. Jashari (1957-1998), Prekaz
24. Hajzer Z. Jashari (1969-1998), Prekaz
25. Halil B. Jashari (1960-1998), Prekaz
26. Halit I. Jashari (1934-1998), Prekaz
27. Hamdi S. Jashari (1960-1998), Prekaz
28. Hamëz Sh. Jashari (1950-1998), Prekaz
29. Hamide S. Jashari (1910-1998), Prekaz
30. Hamit H. Jashari (1934-1998), Prekaz
31. Hanife Z. Jashari (1981-1998), Prekaz
32. Hidajete R. Jashari (1979-1998), Prekaz
33. Igbal R. Jashari (1981-1998), Prekaz
34. Igballe R. Jashari (1989-1998), Prekaz;
35. Isak F. Halili (1934-1998), Duboc;
36. Kajtaz M. Jashari (1953-1998), Prekaz
37. Kushtrim A. Jashari (1985-1998), Prekaz
38. Lirie H. Jashari (1983-1998), Prekaz

- 39.Mihrije F. Jashari (1942-1998), Prekaz
- 40.Murtez Z. Jashari (1979-1998), Prekaz
- 41.Nazmi Z. Jashari (1967-1998), Prekaz;
- 42.Osman Sh. Geci (1943-1998), Llaushë;
- 43.Qazim O. Jashari (1948-1998), Prekaz
- 44.Qerim H. Jashari (1942-1998), Prekaz
- 45.Ramiz S. Jashari (1974-1998), Prekaz
- 46.Sabrije Z. Jashari (1976-1998), Prekaz
- 47.Sadik H. Jashari (1932-1998), Prekaz
- 48.Salë Sh. Jashari (1943-1998), Prekaz
- 49.Selvete H. Jashari (1977-1998), Prekaz
- 50.Shaban M. Jashari (1924-1998), Prekaz
- 51.Shahin Q. Jashari (1973-1998), Prekaz
- 52.Sherif B. Jashari (1951-1998), Prekaz
- 53.Sinan R. Jashari (1935-1998), Prekaz
- 54.Smajl A. Jashari (1951-1998), Prekaz;
- 55.Smajl Xh. Bazaj (1980-1998), Tërstenik;
- 56.Ukshin Q. Jashari (1976-1998), Prekaz
- 57.Valdete R. Jashari (1983-1998), Prekaz
- 58.Zahide Sh. Jashari (1924-1998), Prekaz
- 59.Zarife B. Jashari (1948-1998), Prekaz. ¹⁵

Mes të rënëve kishte 15 fëmijë të moshës 7 deri 16 vjeç dhe 17 femra. Ndër të rënë të kishte pleq e plaka deri në moshën 74-vjeçare. Të gjithë të rënë të identifikuar dhe të pidentifikuar policia i varrosi më 10 mars, pa respektuar kurrfarë normash të traditës ose të rregullave të varrimit dhe pa e bërë ekspertizën mjeko-ligjore. Sulmit i mbijetoi vetëm një vajzë, Besarta.

Burimi:

-Kosova e Lirë, /Përkujtojmë Dëshmorët e kombit/-Familja Jashari dhe beteja e 5,6,7 marsit 1998
{5 Xhevat Imeri, Shënime nga Kompleksi Memorial "Adem Jashari", Prekaz

JANAR - TETORIT 1998

Përveç të gjitha të këqijave që bëri ushtria serbe, kjo luftë u manifestua edhe me bombardime e djegie të fshatrave, plaçkitje të pasurive shqiptare, kidnapime dhe marrje peng, arrestime masive dhe procese të montuara politike e zhvendosje të mëdha të popullatës.

Situata humanitare tashmë kishte marrë përmasa kërcënuese për një numër të madh të popullsisë shqiptare të zhvendosur, që së shpejti përfundojë, apo kishte arritur katastrofë humanitare. Nga kjo krahurë nuk përjashtohen as pleqtë, fëmijët, të sëmurët, lehonat që lindin në male, si dhe të porsalindurit, të cilët janë kategoria më e rrezikuar.

Lista e vrasjeve nga janari 1998, kur u keqësua situata, kap shifrën 1646 shqiptarë të vrarë. Struktura e të vrarëve është: 174 femra, 152 fëmijë, 338 mbi moshën 55 vjeç, prej tyre 408 të pidentifikuar, kurse të vrarët tjerë janë të moshës 18-55 vjeç. Në listën e të vrarëve janë përfshirë persona të masakruar, të ekzekutuar, persona, të cilëve u janë djegur kufomat, ose kanë pësuar nga granatimet, që ushtria e policia serbe përdorte kundër popullatës civile...

Vetëm gjatë muajit shtator 1998 janë vrarë 492 shqiptarë, 73 prej të cilëve janë varrosur të pidentifikuar, kurse numri i të plagosurve mund të jetë shumë më i madh se 159. Gjatë kësaj periudhe mund të jenë 206 persona, që konsiderohen të zhdukur dhe të zënë peng, kurse numri i përgjithshëm i tyre kap shifrën mbi 1300 veta. Në mesin e të kidnapuarve është edhe Xhavit Haziri, 31 vjeç ish-i burgosur politik dhe anëtari i këshillit, Hafir Shala, mjek... Gjatë kësaj kohe janë arrestuar, apo është hapur proces hetimor ndaj 98 shqiptarëve. Sipas të dhënave, gjatë kësaj periudhe disa depo, fabrika, miniera, shkolla, madje edhe

manastire janë shndërruar në burgje hetuesie e kampe të përqendrimit, ku shqiptarët torturoheshin mizorisht.

Më 23 shtator forcat policore ushtarake kishin sjellur nga Prekazi i Epërm 60 meshkuj, kryesisht të rinj dhe në gjendje të rëndë shëndetësore, të cilët i dërguan në stacionin e policisë në Glllogvc dhe nuk dihet asgjë për fatin e tyre.

Po ashtu edhe në vendin e quajtur "Fusha e Mollës", forcat serbe kanë arrestuar mbi 60 shqiptarë. Aty mësohet se 4 veta mbetën të vrrarë e të masakruar. Ata janë: Shyqri Krasniqi, Skënder e Behxhet Karaxha dhe një djalë i Beqir Morinës nga Glllobari.

Po të njëjtën ditë këta shpirtzinj të pangopur me gjak shqiptari, në Vërbofc i masakruan së paku 7 veta. Ndër të masakruarit u gjend edhe plaka Bahtije Gashi, 81-vjeçe.

Vërbofci, që deri tani ishte rezistent dhe vend i pakapërcyeshëm, prej 160 shtëpive sa kishte, i dogjën dhe i rrafshuan 100 shtëpi, duke i plaçkitur. Më pas me të njëjtën formulë serbët vazhduan spastrimin, shkatërrimin, djegiet dhe më në fund pasoi thirrja nga "organet zyrtare serbe" që të ktheheshin nëpër shtëpitë e tyre (po ku të ktheheshin...!?)



Ikja e popullatës civile nga barbaria serbe 1998/1999

Burimi:

-Raportet e KMDLNJ-së, Prishtinë 1998

KRIMET SERBE AFËR PIKËS C-2-KOSHARE (22-23.04.1998)

Në natën mes 22 e 23 prillit 1998, derisa rreth gjashtëdhjetë vetë nga Hereçi e Sllupi po ktheheshin nga Shqipëria në Kosovë, afër pikës C-2 në malet e Koshares, diku rreth orës 5:45 të mëngjesit ndeshen në pritën e organizuar të forcave ushtarako-policore serbe, ndaj të cilëve u përdorën edhe helmet kimike. Aty u ekzekutuan njëzet prej tyre.

Të ekzekutuarit:

1. Bekim Salih Aliaj (1973-1998),
2. Hajdar Ramadan Thaçi (1962-1998),
3. Hasan Bajram Tahiraj (1954-1998),
4. Sadik Lush Alijaj (1961-1998),
5. Skënder Qazim Hajdaraj (1969-1998),
6. Shefqet Selim Aliaj (1969-1998),
7. Ukë Misin Shabanaj (1970-1998),
8. Vehbi Asllan Hasanaj (1967-1998) dhe
9. Gazmend Hasan Ramaj (1972-1998), nga fshati Hereç;
10. Prof. Selman Brahim Lokaj (1950-1998),
11. Astrit Xhafer Hadërgjonaj (1977-1998),
12. Bekë Sefer Hadërgjonaj (1976-1998),
13. Bekim Shefqet Mazrekaj (1976-1998),
14. Beqë Binak Lokaj (1968-1998),
15. Hajdar Ramadan Lokaj (1975-1998),
16. Imer Isuf Lokaj (1970-1998),
17. Tahir Abaz Mazrekaj (1962-1998),
18. Xhemajl Sejdë Mazrekaj (1969-1998), nga fshati Sllup
19. Veli Adem Noci (1969-1998) dhe
20. Blerim Ramë Januzaj (1968-1998), nga fshati Dujakë

Gjatë këtij operacioni të forcave ushtarake e policore serbe, tinëzisht vriten edhe dy civil nga fshati Dujakë.

Aty vriten edhe:

- 21.Veli Adem Noci (1969-1998) dhe
- 22.Blerim Ramë Januzaj (1968-1998) nga Dujaka.

Gjatë këtij operacioni të forcave serbe, përveç vrasjeve të civilëve shqiptarë, i zunë robë dy veta;

Të zënit robë:

1. Gazmend Tahiraj dhe
2. Ibër Sherif Metaj (1962), të dy nga fshati Hereç.

Ndaj këtyre të zënve robë u ngrit procedurë penale në Gjyqin Ushtarak të Nishit. Me këtë rast u mor gjyqtari hetues i Gjyqit Ushtarak të Nishit, nënkoloneli Radenko Milladinoviq.¹⁶



¹⁶ Fitnete Ramosaj, /Krimet serbe në Kosovë, Pa apologji -2/ , Prishtinë

KRIMET SERBE NË LYBENIQ (25-29.05.1998)

Më 25 maj 1998, që nga ora 9.30 deri në orët e mbrëmjes fshati Lybeniq u rrethua nga forca të mëdha policore. Pas gjuajtjeve të shumta nga armët e rënda, ekspedita e policisë serbe hyn në fshat dhe me këtë rast në oborret e shtëpive të tyre vrasin e masakrojnë shqiptarë të pafajshëm:

Të ekzekutuarit:

1. Zeqë Hamzaj,
2. Brahim Hamzaj,
3. Dervish Hamzaj,
4. Ymer Hamzaj,
5. Gani Hamzaj,
6. Rifat Hamzaj,
7. Bashkim Hamzaj,
8. Hysen Alimehaj dhe mysafirin e familjes Huskaj,
- 10.Haxhi Gogaj nga Deçani.

Si dhe plagosen:

- 1.Nezir Sali Jahmuratajn;
2. Lulzim Ymer Hamzajn dhe
3. Ardeshtik Mehmet Gogajn nga Deçani.

Ndërkaq, më 29 maj 1998, policia serbe vazhdoi dhunën e krimet ndaj popullatës civile ku vrau;

1. Mehmet Ukë Ukshinajn dhe ia dogjën kufomën.

Burimi:

-Raporti i KMDLNJ-së

-/Krimet serbe në Kosovë, Pa apologji -2/ , Prishtinë

KRIMET SERBE NË RANCË TË SHTIMES (26.08.1998)

Krimi serb që ndodhi më 26 gusht të vitit 1998, mbi familjen Asllani në Rancë të Shtimes ishte i planifikuar nga forcat policore ushtarake, që vepronin në komunën e Shtimes. Kjo ka ndodhur derisa Familja Asllani po largohej nga fshati për t'u strehuar në ndonjë vend më të sigurt e për t'i ikur barbarisë serbe. Atyre qëllimisht dhe me urdhër të eprorëve të lartë serbë ua goditen rimorkion e traktorit me një predhë topi dhe thuajse të gjithë që ishin në rimorkio u vranë e u shkatërruan. Aty ishin vranë pleq, gra e deri te fëmija 7- muajsh.

Të vranët:

1. Jalldyze Bajrami-Asllani (1934-1998),
2. Halide Asllani (1968-1998),
3. Burim Asllani (1985-1998),
4. Lumnije Asllani (1986-1998),
5. Ejup Asllani (1988-1998),
6. Luljeta Asllani (1991-1998),
7. Shpend Asllani (1993-1998),
8. Xhafer Asllani (1995-1998),
9. Antigona Asllani (1997-1998),
10. Ajshe Asllani (1971-1998) dhe
11. Albiona Musa Asllani-foshnje 7 muajshe (1998-1998).

Burimi:

-Raporti i KMDLNJ-së, 1998

-/Against forgetfulness-Serbian genocide in Kosova 1998-1999, f.94, Prishtinë 2017

MASAKRA E LEPAJËS (15.09.1998)

Pas një beteje të ashpër në mes të forcave çlirimtare dhe atyre ushtarake policore serbe në Zonën e Llapit, e njohur si “Beteja e Kaqanollit”, ku armiku kishte pësuar humbje, në shenjë hakmarrje forcat serbe shfrenimin e tyre e zbrazën në popullatën e paarmatosur civile.

Kështu ata, ditën e parë të kësaj beteje, në fshatin Lepajë i zunë gjashtë civilë, të cilët i keqtrajtuuan, i masakruan e më pas i dogjën në një shtëpi.

Të masakruarit:

1. Xhafer L. Ajvazi (1940) nga fshati Dobratin,
2. Muhamet M. Fazliu (1962) nga fshati Llaushë,
3. Ejup I. Sejdiu (1962) nga fshati Dobratin,
4. Rrahim K. Lepaja (1967),
5. Beqir Xh. Lepaja (1971) nga Bajçina lagja Lepajë dhe
6. Rrahim B. Ramadani (1982) nga fshati Dobratin.

Po ashtu forcat serbe në fshatin Dobratin këtë ditë kishin vrarë një të moshuar dhe një të ri

Të ekzekutuarit:

7. Maksut Rekaliu, plak dhe të riun
8. Haki Rekaliu,

Sipas dëshmitarëve, këtë të ri e kishin tërhequr zvarrë mbas traktorit. Britma e të cilit është dëgjuar edhe në fshatin fqinjë në Revuq.

Burimi:

-Milazim Kadriu, /Shënime-dëshmi për krimet serbe/, Besianë, 1998

KRIMET SERBE NË QYQAVICË - GALICË (22.09.1998)

Ofensiva e forcave serbe, e planifikuar mirë e gjatë, e që ua kalonte gjithë të tjerave, nisi tërbueshëm. Mbi njëzet e pesë mijë trupa, policë, oficerë, ushtarë, paramilitarë dhe vullnetarë serbë, të mobilizuar me tërë makinerinë e arsenalin e aramatimit, u vërsulën çakërdisshëm mbi trojet shqiptare. Në cak ishte zemra e Kosovës, Drenica kryengritëse dhe Artakolli. Nga çdo anë, nga Mitrovica, nga Skënderaj, nga Gllogovci, nga Obiliqi dhe nga Vushtrria hijet e zeza mortore marshonin drejt Qyqavicës...

Më 22 shtator 1998, në fshatin Galicë forcat serbe i ekzekutuan 14 shqiptarë, kryesisht të rinj, në mesin e tyre dhe një grua.

Të ekzekutuarit:

1. Shashivar Ademi (51-vjeç),
2. Fatmir Ademi (17),
3. Gani Ademi (16),
4. Burim Ademi (17),
5. Bajram Sahiti (33),
6. Agim Ademi (28),
7. Hetem Halili (45),
8. Bujar Halili (17),
9. Bekim Halili (22),
10. Nazmi Halili (22),
11. Nexhat Halili (17),
12. Hajredin Lahu (44),
13. Sejdi Kabashi (24), nga Palaci dhe
14. Enver Kastrati (36), nga Palluzha

Gjatë kësaj lufte, Galica pësoi shumë. Më 17 mars 1999 e tëra u rrafshua me tokë. Ishte kjo djegia e shtatë e saj gjatë historisë njëqindvjeçare. Mu për këtë edhe nuk arriti të shtohet shumë popullata e saj dhe thujse kurrë burrat e saj nuk arritën të mplanen e të vdesin me kokë në jastëk. Popullata u dëbua dhe u degdis gjithandej trojeve shqiptare e në mërgatë, mbetën vetëm burrat dhe luftëtarët e lirisë, të cilët për asnjë çast nuk u larguan nga shkrepat e Arbërisë së pamposhtur.

Pos tjerash, Galica lirisë ia fali edhe 18 veta (14 meshkuj e 4 femra) dhe pati 5 të plagosur.

Të plagosurit:

1. Fidaim Ademi,
2. Halim Ademi,
3. Sami Zena,
4. Mexhit Zena,
5. Nexhmedin Tahiri.

Të brgosurit:

1. Sejdi Lahu,
2. Ismet Lahu,
3. Mujë Shabani dhe
4. Fazli Ademi, (i cili nga torturat vdiq fill pas daljes në liri).

Si dhe krime tjera makabre:

1. Mehreme Zena (*e djegur në Galicë, më 1999, ka qenë e paaftë*),
2. Zyhrrie Zena (*e djegur në Galicë, më 1999, me të meta, memece*)
3. Shehide Kamberi (*e vrrarë në Prekaz më 1999*).

Burimi:

-Bedri Tahiri, /Toponimia e Galicës/, Prishtinë, f. 42-44

KRIMET SERBE NË ASHLAN (22.09.1998)

Ende pa aguar e marta e 22 shtatorit 1998, Ashlani u gjend i rrethuar keq nga forcat ushtarake policore serbe. Pasi ata hasën në rezistencën titanike të çlirimtarëve, duke pësuar humbje nga pushkët e lirisë, filluan hakmarrjen në popullatën e pafajshme shqiptare. Aty filluan keqtrajtimet, plaçkitjet dhe vrasjet e popullsisë së paarmatosur.

Të ekzekutuarit:

1. Mustafë Shyti (51),
2. Arsim Ibrahim (14),
3. Sheremet Sheremeti (42),
4. Rrahim Mehmeti (60),
5. Musë Shaban Sheremeti (60),
6. Lutfi Hyseni (65),
7. Hajrullah Gjaka (70),
8. Selatin Hyseni (28),
9. Halit Hyseni (40),
10. Hamit Hyseni (41),
11. Idriz Mehmeti (85),
12. Kada Mani (70),
13. Milazim Mani (36),
14. Asllan Sheremeti (70),
15. Bislim Brahimi (30),
16. Agim Rr. Ramadani (38) nga Prekazi
17. Hysen Murati (70) nga Balinca dhe
18. Ismet Zherovnica (60), nga Balinca.

Burimi:

-Bedri Tahiri, /Adem Jashari - legjendë e legjendave/, (botimi katërt), f.129
Prishtinë, Rilindja, 2001,

MASAKRA E ABRISË (26.09.1998)

Më 26 shtator 1998, në lagjen Deliu, të fshatit Abri e Epërme, vetëm një kilometër larg shtëpive të tyre, forcat ushtarako-policore serbe masakruan 23 anëtarë të familjes Deliu, në mesin e tyre gra, fëmijë e pleq (prej moshës 6 muaj deri në 94 vjeç). Po në këtë ditë, pasi që forcat ushtarake policore serbe u tërhoqën nga Abria e Epërme, në terrenin ku kishin qëndruar, u zbuluan krime të tmerrshme që kishin bërë në familjen Deliu.



Abri, 1998, fotografi e gazetarëve ndërkombëtar

Përafërsisht 1000 metra larg shtëpisë së tyre u gjetën të masakruar 8 anëtarë të kësaj familje, kurse disa metra larg këtij vendi u gjetën të masakruar edhe trupat e pajetë të: Donjeta Deliu, Gentiana Deliu, Zahide Deliu, Fazli Deliu (ky u gjet i vrarë në shtëpinë e vet), Ali Deliu (i prerë në fyt), Pajazit Deliu e Zeqir Deliu. Tmerri i madh ishte kur në gjirin e nënës Diturie Deliu, u

gjend foshnja gjashtëjavëshe, e mbuluar me gjakun e nënës. Nëna i kishte vdekur me mall të përqaimit, me mall të saj për ta pajtuar në momentet kur ajo kishte nevojë! Dhe një ditë më vonë u gjetën tre pleq të vrarë, po të kësaj familjeje. Më 4 tetor u gjetën edhe dy viktima të masakruara, po të kësaj familjeje: Antigona Deliu, 14vjeçe dhe Mihane Deliu, 16 vjeçe.

Të ekzekutuarit-masakruarit:

1. Fazli Deliu (1904-1998), Abri e Epërme
2. Ali Deliu (1930-1998), Abri e Epërme
3. Pajazit Deliu (1929-1998), Abri e Epërme
4. Hava Deliu-Elshani (1936-1998), Abri e Epërme
5. Hamide Deliu (1938-1998), Abri e Epërme
6. Habib Deliu (1944-1998), Abri e Epërme
7. Hysen Deliu (1946-1998), Abri e Epërme
8. Zeqir Deliu (1954-1998), Abri e Epërme
9. Hajriz Deliu (1964-1998), Abri e Epërme
10. Adem Deliu (1965-1998), Abri e Epërme
11. Lumnije Deliu (1969-1998), Abri e Epërme
12. Mihane Deliu (1943-1998), Abri e Epërme
13. Zahide Deliu (1971-1998), Abri e Epërme
14. Luljeta Deliu (1971-1998), Abri e Epërme
15. Mihane Deliu (1982-1998), Abri e Epërme
16. Antigona Deliu (1984-1998), Abri e Epërme
17. Gentiana Deliu (1990-1998), Abri e Epërme
18. Donjeta Deliu (1991-1998), Abri e Epërme
19. Jeton Deliu (1988-1998), Abri e Epërme
20. Mendohije Deliu (1993-1998), Abri e Epërme
21. Valmir Deliu (1993-1998), Abri e Epërme
22. Diturie Deliu (1998-1998), Abri e Epërme dhe
23. Sherif Deliu (1931-1998), Abri e Epërme.

MASAKRA E REÇAKUT (15.01.1999)

Në orët e hershme të mëngjesit të datës 15 janar 1999, ashtu siç ishte planifikuar në Beograd, fshati Reçak u zgjua i rrethuar nga formacionet e policisë speciale, të ushtrisë dhe të paramilitarëve serbë, të shoqëruar edhe me mjete të motorizuara. Rreth orës 6:30, forcat serbe me artileri të rëndë kanë filluar të granatojnë fshatin prej vendeve të quajtura „Pishat“, „Gështenjat“, „Rrasa e Çallakut“ dhe nga „Çesta“ përmbi Reçak. Pas ndërprerjes së granatimeve forcat kriminale serbe janë futur në fshat dhe kanë filluar bastisjet nëpër shtëpi. Në këto momente të rënda, fshatarët janë përpjekur të largohen nga fshati apo të gjejnë një vendstrehim më të sigurt, por rrethimi i hekurt e ka bërë të pamundur.

Forcat policore e ushtarake serbe, që ishin futur përmes rrugës kryesore të fshatit, kishin arrestuar në oborrin e shtëpisë (afër xhamisë) Banush Azem Kamberin, ndërsa familja e tij pak kohë më herët kishte braktisur shtëpinë. Forcat kriminale Banushin, pasi e keqtrajtojnë fizikisht, e ekzekutojnë me rafale automatiku në oborrin e fqinjit të tij. Barbarët mesjetarë nuk e lënë me kaq. Pas ekzekutimit, Banushit ia këpusin edhe kokën, e cila nuk është gjetur në vendin e krimit. Formacionet kriminale, në të cilat janë radhitur edhe serbët lokalë, në këtë operacion shfarosës nuk kanë lënë vend në fshat pa kontrolluar, djegur e shkatërruar.

Drama më e tmerrshme në këtë ditë për banorët e Reçakut u zhvillua në shtëpinë e Sadik Osmanit. Qysh në orët e para të mëngjesit ishin tubuar shumë familje në bodrumin e shtëpisë dhe në një ahur, për t'u mbrojtur nga granatimet e artilerisë së rëndë serbe. Kriminelët pasi kishin hetuar strehimin e banorëve të fshatit në këtë shtëpi, fillimisht nga largësia prej shtëpisë së Ragip Jahir Bajramit dhe shitores së Lutës (siç e quajnë fshatarët) kishin

gjuajtur me armë të kalibrave të ndryshëm dhe në këto momente vrasin plakun Nazmi Nuha dhe më pastaj hidhen në sulm, e rrethojnë shtëpinë e Sadikut dhe futen në oborr.

Dëshmitarët Ramë Nesret Shabani dhe Sadie Ramadani, nga kjo ditë tragjike rikujtojnë: *“Rreth orës 8:30, jemi tubuar në bodrum të shtëpisë së Sadik Osmanit për t’u mbrojtur nga granatimet. Aty kanë qenë rreth 30 gra me fëmijë, kurse prej meshkujve ishin Sadik Osmani, Ramë Nesret Shabani, Mufail Hajrizi, Burim Osmani dhe disa djem të rinj. Ndërsa burrat tjerë, rreth 30 veta, kanë qenë të vendosur në ahurin e lopëve të Sadik Osmanit. Fillimisht policia serbe i ka nxjerrë jashtë nga ahuri burrat dhe mandej ka ardhur një polic i maskuar dhe ka hapur derën e bodrumit, ka këqyrë brenda dhe ka dalë jashtë. Ndërkohë, ka ardhur Komandanti i Policisë së Shtimes dhe e ka pyetur policin e maskuar: “Ç’ka këtu brenda?” Polici i përgjigjet: “Gra dhe fëmijë”. Komandanti ia kthen: “Pse po gënjen? Këtu paska edhe burra”. Na kanë nxjerrë në oborr dhe na i kanë marrë letërnjoftimet..., ndërsa gratë dhe fëmijët i kanë mbyllur me dry (çelës) në bodrum”.*¹⁷

Ndërkaq dëshmitari Bilall Sadri Avdiu, i cili ka qenë i strehuar në ahurin e kafshëve, e kujton ditën kritike: *“Dy-tre policë e çelën derën e ahurit... dhe thanë: “Këtu ka shumë irredentistë, he nënën!... Na urdhëruan të dalim përjashta me duart përpjete dhe kur dolëm përjashta, ata kishin qenë shumë, 30 deri në 40 policë të renditur prej kodre, krejt të armatosur deri në dhëmbë e të mëdhenj, disa me maska e disa pa to. I kanë tubuar në oborr dhe ia kanë marrë letërnjoftimet e dokumentet tjera.*¹⁸

Sipas dëshmitarëve që kanë mbijetuar, kriminelët serbë pasi i kanë legjitimuar burrat e zënë, i kanë shtrirë për toke dhe

{7 Shënime nga Ramë Shabani dhe Sadie Ramadani, (te mbijetuarit e masakres)

{8 Shënime nga Bilall Sadri Avdiu, (i mbijetuari i kimit serb)

kanë filluar t'i rrahin mizorisht duke përdorur kondakët e armëve, shqelmat, dru, zinxhirë dhe gjësende tjera të forta. Gjatë rrahjeve në oborrin e Sadikut, dëgjoheshin gjëmat dhe britmat e burrave, ndërsa në bodrum qanin e lemerisnin gratë e fëmijët.

Pas kësaj drame tmerruese, kriminelët sipas skenarit të përgatitur më herët, kalojnë në fazën e dytë të veprimtimit. Dëshmitarët gjatë rrahjeve brutale në oborrin e shtëpisë së Sadik Osmanit kanë dëgjuar një komunikim me radiolidhje të drejtuesve të këtij operacioni. Pas një orë e gjysmë rrahjesh për vdekje, dikur në mesditë, këta burra i marrin dhe në rresht për një i nisin në drejtim të malit dhe te "Gropa e Bebushit" ndalohen nga njësitë tjera kriminale serbe, me të cilat pak kohë më parë nga oborri i Sadikut është biseduar në radiolidhje.

Pikërisht në rrugicën e "Gropës së Bebushit", ashtu siç kanë qenë duke ecur në kolonë, njësitë kriminale serbe me rafale automatiku nga afër i ekzekutojnë pamëshirshëm 24 burra, ndërsa me këtë rast (meqë ishin të fundit në kolonë) arrijnë të shpëtojnë: Ramë Shabani, Bilall Bilalli, Nesret Shabani, Ali Qazimi dhe Imer Imeri. Më 15 janar 1999, në këtë ditë të kobshme, në Reçak u vranë e u masakruan barbarisht 45 shqiptarë të paarmatosur, në mesin e të cilëve edhe gra.

Të ekzekutuarit-masakruarit:

1. Banush Azem Kamberi (1936-1999)
2. Ragip Jahir Bajrami (1964-1999)
3. Halim Rizah Beqiri (1985-1999)
4. Rizah Maliq Beqiri (1946-1999)
5. Zenel Shefqet Beqiri (1978-1999)
6. Lutfi Hasan Bilalli (1957-1999)
7. Ajet Minush Brahimi (1959-1999)
8. Bujar Hanifi Hajrizi (1979-1999)
9. Myfail Mehdi Hajrizi (1969-1999)

10. Skënder Sylejman Halili (1968-1999)
11. Haqif Shefki Hysenaj (1947-1999)
12. Hakip Imer Imeri (1966-1999)
13. Murtez Ramiz Imeri (1979-1999)
14. Nazmi Nuhë Imeri (1917-1999)
15. Muhamet Faik Smajli (1955-1999)
16. Ahmet Izet Jakupi (1942-1999)
17. Eshref Halim Jakupi (1945-1999)
18. Hajriz Brahim Brahimi (1937-1999)
19. Mehmet Qerim Jakupi (1955-1999)
20. Xheladin Ahmet Jakupi (1982-1999)
21. Sabri Murat Metushi (1939-1999)
22. Raif Milaim Salihu (1978-1999)
23. Shukri M. Salihu (1980-1999)
24. Fatmir Faik Ramadani (1961-1999)
25. Nexhat Faik Ramadani (1978-1999)
26. Salih Faik Ramadani (1974-1999)
27. Bajram Sokol Mehmeti (1945-1999)
28. Hanumshahe Bajram Mehmeti (1979-1999)
29. Arif Murat Metushi (1946-1999)
30. Haki Murat Metushi (1937-1999)
31. Ahmet Zenun Mustafa (1930-1999)
32. Mustafë Beqë Asllani (1965-1999)
33. Muhamet Hafiz Mustafa (1978-1999)
34. Sadik Xhemë Osmani (1954-1999)
35. Jashar Milaim Salihu (1974-1999)
36. Shukri Milaim Salihu (1982-1999)
37. Bajrush Nusret Shabani (1976-1999)
38. Sahide Hysen Sylja-Metushi (1938-1999)
39. Hanumshahe Sadik Mujota (1983-1999)
40. Sheremet Shyqeri Sylja (1962-1999)

41. Shyqëri Smajl Syla (1938-1999)
42. Bajram Haki Xheladini (1964-1999) dhe
43. Njazi Sherif Zymeri (1954-1999).



Burimi:

-Raportet e KMDLNJ-së, Prishtinë 1998/1999

-Instituti për hulumtimin e krimeve të luftës, /Masakra e Reçakut-Krim kundër njerëzimit/
f.58,147,148, Prishtinë 2017

RAPORTI IVILIAM VOKER

„Nga ajo që pashë, nuk ngurroj të përshkruaj ndodhinë si masakër dhe krim kundër njerëzimit (!)“

Të nesërmen, më 16 janar, aty rreth orës 13:30, në Reçak do të shkojë ish-shefi i Misionit të Verifikuesve të OSBE-së, z. Voker për të parë nga afër këtë ngjarje të tmerrshme kriminale. Z.Voker pasi vizitoi fshatin, u ngjiti lart te “Gropa e Bebushit” dhe derisa po i afrohej luginës së ngushtë, u tmerrua kur i pa kufomat e tre meshkujve të moshuar dhe në këto momente deklaroi: *“Për nga pamja duket si ekzekutim. Duket se njerëzit pa kurrfarë vlere për jetët e njerëzve kanë vrarë këta njerëz, që mua me duken si bujq, si punëtorë, si fshatarë, që nuk kanë merituar të vdesin kështu..”*

Më pastaj z. Voker vazhdoi rrugën drejt luginës së vdekjes, ku po qëndronin të shtrirë me duar të shtangura e trupa të sakatosur kufomat tjera të civilëve të ekzekutuar barbarisht. *„T’i shohësh kufomat kështu me fytyra të shkatërruara, që si duket janë bërë nga armët që janë mbajtur afër kokave të tyre, t’i shohësh 15 në një gropë, dhe në një mënyrë të ekzekutuar, mendoj se më nevojiten disa minuta para se të përcaktohem se çka dua të them“*.

Dhe, menjëherë në konferencën me gazetarë, pa hezituar ai deklaroi: *“Nga ajo që pashë, nuk ngurroj të përshkruaj ndodhinë si masakër dhe krim kundër njerëzimit (!) ...kjo është ngjarja më trishtuese në jetën time...”*¹⁹

¹⁹ Nga raporti i Viliam Vokerit, janar 1999

KRIMI SERB NË RAKOVINË (24.01.1999)

Në postbllokun policor në Kramovik, më 24 janar të vitit 1999, rreth orës 19:00, afër Urës së Rakovinës, policia serbe pa paralajmërim kishte gjuajtur në një rimorkio të traktorit ku i vrasin 5 civilë shqiptarë, të cilët po udhëtonin prej Kramovikut për Cermjan, në përpjekje mbinjerëzore për të mbijetuar luftën.

Vezhguesit e OSBE-së që kishin dalur në vendin e krimit, konstatuan se mbi 200 plumba të kalibrave të rëndë 12.7mm dhe 7.62mm, ishin zbratur mbi trupat e 5 civilëve shqiptarë, por me këtë nuk ishin mjaftuar kriminelët serbë. Përveç kësaj, trupat e të vrarëve i kishin goditur edhe me mjete të mprehta nga afërsia.

E vërteta për ekzekutimin klasik nga forcat policore serbe të këtyre 5 shqiptarëve mori botën. ^{10}

Të ekzekutuarit-masakruarit:

1. Shaban Tafë Kelmendi (1953), Rakovinë
2. Besim Shaban Kelmendi (12 vjeç), Rakovinë
3. Haxhi Shaban Kelmendi (11 vjeç), Rakovinë
4. Hysen Kurti (1959), Cermjan dhe
5. Sanije Kurti (1964), Cermjan.

“Nuk kam besuar se njeriu mund t'i bëjë diçka të tillë njeriut, derisa vizitova Kosovën”... kishte deklaruar ish-senatori amerikan, Bob Dole, më 6 shtator 1998, para gazetarëve në Prishtinë, duke shfaqur trishtimin për përmasat e krimeve serbe në Kosovë. ^{11}

{10 /Kundër harresës-Gjenocidi i Serbisë në Kosovë/, f.110, Prishtinë 2017

{11 Bob Dole, 6 shtator 1998, Prishtinë

MASAKRA NË ROGOVË TË HASIT (27-29.01.1999)

Më 27, 28 dhe 29 janar të vitit 1999, në Rugovë të Hasit, Kosovës iu shtuan edhe 21 heronj, dëshmorë të kombit. Aty heroikisht ranë për të mos vdekur:

Agim B. Zeneli (1962), Luan A. Smajli (1978), Agron O. Rama (1972), Sejdi A. Rama (1965), Pren Z. Lleshi (1964), Memë Z. Lleshi (1973), Agush A. Gjocaj (1971), Valon M. Gashi (1977), Bahtjar A. Morina (1975), Daut I. Zagragaj-Kelmendi (1971), Emrush Ç. Çetaj (1972), Kasim R. Shala (1981), Hamdi I. Berisha (1977), Gëzim Q. Ademaj (1961), Haxhi H. Kleçka (1976), Gaspër N. Karaçi (1961), Ilir R. Merturi (1970), Naim Xh. Gashi (1978), Naim H. Dreshaj (1970), Sahit A. Krasniqi (1975) dhe Vesel S. Avdyli (1978).

Kriminelët serbë nuk kursyen as civilët e këtij fshati. Në mëngjesin e 29 janarit, forcat kriminale serbe në Rogovë, në shtëpitë e tyre masakrojnë këta banorë:

Të ekzekutuarit:

1. Rustem S. Morina (1939-1999),
2. Selman Rr. Morina (1976-1999),
3. Nusret Rr. Morina (1982-1999),
4. Muhamet Rr. Morina (1979-1999),
5. Ibrahim S. Kryeziu (1973-1999),
6. Xhevdet B. Berisha (1965-1999),
7. Rifat H. Shala (1974-1999),
8. Zyber D. Shala (1939-1999) dhe
9. Adem Xh. Shala (1955-1999)

Burimi:

-Raporti i KMDLNJ-së, Prishtinë, 1999

-/Kundër harresës-Gjenocidi i Serbisë në Kosovë/, f.112, Prishtinë 2017

Dëshmi të krimeve serbe



KRIMET SERBE NË SKËNDERAJ (20.03.1999)

Më datë 20 mars të vitit 1999, në Skënderaj, forca të mëdha ushtarake, policore e paramilitare serbe, këta të fundit serb vendor të kësaj komune, keqtrajtuuan mizorisht civilë shqiptarë, duke palqitur, djegur e ekzekutuar pamëshirshëm nëpër oborre të shtëpive dhe në lagjen dy të pishat.

Të ekzekutuarit sipër qytetit, të pishat:

1. Januz Kalleci (1938-1999), Skënderaj
2. Xhavit J. Kalleci (1971-1999), Skënderaj
3. Musli D. Shala (1970-1999), Skenderaj
4. Sabit Veliu (1960-1999), Palac
5. Nebih H. Vojvoda (1951-1999), Llaushë
6. Lavdim Vojvoda (1979-1999), Llaushë
7. Sadri Z. Gashi (1954-1999), Kryshec
8. Ramiz R. Geci (1968-1999), Skënderaj

Të ekzekutuarit nëpër oborre të shtëpive:

9. Milazim S. Rexha (1976-1999), Skënderaj
10. Veli H. Mustafa, Skënderja
11. Ilaz Oruqi, Skënderaj
12. Shaban Teraku, Vitak
13. Idriz Kameri, Skënderaj
14. Ilaz Asllani
15. Xhavit Syljemani
16. Salih B. Vojvoda (1960-1999), Llaushë
17. Habib Vojvoda, Llaushë
18. Isuf Gashi (1943-1999), Skënderaj
19. Blerim I. Gashi (1975-1999), Skënderaj

20. Xhevdet Z. Zenuni (1976-1999), Mikushnicë
21. Xhavit Sylejmani (1960-1999), Abri e Poshtme
22. Hazir Kuliqi (1978-1999), Abri e Poshtme
23. Hasan Asllani (1937-1999), Abri e Poshtme
24. Veli Asllani, Abri e Poshtme
25. Hajdin M. Aruqi (1981-1999), Rezallë
26. Sejdi Z. Zeqiri, Vajnik
27. Refki Z. Zeqiri, Vajnik
28. Nebih H. Vojvoda (1951-1999),
29. Gani A. Azemi (1951-1999),
30. Shaip G. Azemi (1973-1999),
31. Faton G. Azemi (1977-1999),
32. Halim Gucati, Abri
33. Muhamet Sh. Fazliu (1970-1999), Prekaz I Epërm
34. Musli Z. Fazliu (1971-1999),
35. Qemajl Xh. Neziri (1986-1999) dhe
36. Emrullah S. Azemi (1979-1999), Mikushnicë

Tetë civil shqiptarë të Skënderajt u morën nga shtëpitë e tyre atë ditë nga forcat serbe, ushtarë me uniforma të bardha dhe u vranë në një vend të njohur si Te Pishat.

Të njëjtën ditë në Skënderaj, 29 civilë të tjerë shqiptarë etnikë u vranë dhe një pjesë e tyre u zhdukën pa gjurmë, 16 prej të cilëve nuk janë gjetur ende.

Vrasjet dhe zhdukjet e civilëve në Skenderaj u kryen nga Brigada e 125-të e Motorizuar e Korpusit të Prishtinës të Ushtrisë Jugosllave. Pavarësisht provave të krimeve të kryera në Skenderaj, asnjë anëtar i kësaj Brigade nuk është ndjekur penalisht për krimet, përkundrazi, kreu i brigadës u dekorua pas luftës në Serbi!

Burimi:

-Raporti i KMDLNJ-së, Prishtinë, 1999

-Jahir Bejta, Prefekt i Lagjes Nr.2, Skënderaj, 1999

KRIMET SERBE NË GJILAN, DARDANË E VITI (Mars-Qershor 1999)

Gjatë muajve mars - qershor të vitit 1999, në komunat; Gjilan, Dardanë dhe Viti, nga forcat ushtarake, policore e paramilitare serbe ndodhen shumë vrasje, djegie dhe plaçkitje.

Rrëfimet nga dëshmitarët e librit “Vrasje dhe dëshmi”, të Musa Sabedinit, flasin për;

-147 të vrarë e të masakruar nga forcat serbe,

-75 të plagosur,

-950 shtëpi të djegura tërësisht,

-452 shtëpi të djegura pjesërisht,

-7321 shtëpi të plaçkitura po nga forcat serbe dhe

-Qindra gra e vajza të dhunuara, nga Ushtria serbe, policia dhe paramilitarët e saj...

Duart e përgjakura të kriminelëve serb, mbi shqiptarët kundërshtues të regjimit të gjenocidistëve, (ende të pa dënuar) janë të pafalshme. Gjenocidi i bërë serb mbi shqiptarët (i lënë në heshtje qe 20 vjet) është për alarm, dhe për t’i rënë të gjitha kambanave, që Gjyqet e Kosovës më në fund të dalin nga heshtja dhe të fillojnë ngritjen e akuzave kundër kryesve të këtij krimi.

Vrasjet e qëllimshme ndaj shqiptarëve, nga serbët vendor, të ndihmuar nga Ushtria serbe, dhe policia, gjatë bombardimit të NATO-s, dhe më herët, përbën gjenocid të pastër të serbëve mbi shqiptarët. Gjenocidi serb, në komunat; Gjilan, Dardanë dhe Viti, edhe pas 20 vjetësh, vazhdon të jetë i padënuar. Heshtjet e Prokurorisë së Kosovës, dhe e Gjykatave të Kosovës, janë të pa falshme. Prokuroria dhe Gjykatat e Kosovës, ende bëjnë gjumë, mbi dosje të gjenocidit serb ndaj shqiptarëve në Kosovë...

Burimi: -Musa Sabedini, /Vrasje dhe dëshmi/, KMDLNJ.

-Atdhe Geci, /Gjenocidi serb në Gjilan, Dardanë dhe Viti/, Dortmund 2019

KRIMET SERBE NË GJAKOVË (24-26.03.1999)

Në natën e 24-25 marsit 1999, filluan bombardimet e NATO-s mbi caqet ushtarake serbe në Kosovë e Serbi dhe po atë natë makineria serbe filloi vallen e saj makabre në Gjakovë. Atë natë u vranë gjashtë qytetarë të Gjakovës, në mesin e tyre edhe kirurgu dhe humanisti i shquar, Dr. Izet Hima, si dhe u dogj e tërë Çarshia e Madhe. Në natën e 25-26 marsit 1999, u dogj e tërë gjysma perëndimore e Mahallës së Qylit dhe u vranë në shtëpitë e tyre qytetarë të pafajshëm.

Të ekzekutuarit:

1. Dr. Izet Hima (?)
 2. Remzie Radoniqi Bejtullahu (61),
 3. Sulejman Bejtullah Bejtullahu (62),
 4. Rajmond Agim Ibrahimimi (15),
 5. Skënder Sadri Gashi (Ibrahimimi) (43),
 6. Ali Ibrahim Islami (26),
 7. Bali Ibrahim Islami (34),
 8. Afrim Idriz Koci (29),
 9. Besim Idriz Koci (27),
 10. Fadil Beqir Krasniqi (29),
 11. Qazim Selim Osmanaj (56),
 12. Bekim Osmanaj (25),
 13. Musa Osmanaj (30),
 14. Xhevdet Sadik Rakoci (55),
 15. Naser Qamil Thaçi (29),
 16. Asllan Osman Halilaj (87)
- Në mesin e tyre u ekzekutuan edhe dy piktorë akademikë,
17. Shefqet Nasir Pruthi (53) dhe
 18. Avni Osman Ferizi (63).

Në të ngrysur të së njëjtës ditë, më 26 mars 1999, në Mahallën e Gecës, në shtëpinë e Zenel Abedin Dervishdanës u bë edhe një masakër;

Të masakruarit:

1. Zenel Abedin Dervishdana (59- vjeçar),
2. Fahri Z. Dervishdana (37-vjeçar),
3. Emin Z. Dervishdana (32- vjeçar) dhe mysafirët e tij:
4. Sulejman Malik Begolli (48- vjeçar),
5. Arif Jakup Bytyçi (73- vjeçar) dhe
6. Urim Arif Bytyçi (33- vjeçar). *f17*



Krimet e forcave serbe në Gjakovë (1999)

Burimi:

-Mr. Kadrush Radogoshi, /Gjakova në shtratin e Prokrustit serb/

MASAKRA NË KOTLINË TË KAÇANIKUT (24.03.1999)

Më 24 mars të vitit 1999, forcat pushtuese ushtarake e policore serbe, e sulmuan fshatin Kotlinë të Kaçanikut. Forcat serbe me të hyrë në fshat i zunë robë 350 banorë të fshatit, të gjithë civilë të pambrojtur. Pasi i zunë robë, ata i ndanë në dy grupe; gratë e fëmijët në një anë, kurse burra e të rinj në anën tjetër dhe 3 prej tyre i ekzekutuan në fshat, ndërsa 22 tjerë duke i keqtrajtuar për orë të tëra në mënyrën më çnjerëzore, edhe të gjallë i hodhën në dy puse (bunare) në vendin e quajtur “Shulla”. Disa orë më pas, ushtria serbe, me urdhër të eprorëve të lartë, i minoi pusët dhe i shkatërroi me eksploziv për t'i zhdukur gjurmët e krimit.¹²

Trupat e pajetë e të gjymtuar të 22 banorëve të Kotlinës u nxorën nga këto puse-varreza masive, në shtator të vitit 1999, nën udhëheqjen e norvegjezit Josef Martines, i ngarkuar nga UNHCR (Komisioni i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë) dhe NCA (Kisha Norvegjeze) për të koordinuar programin për pastrimin e puseve nga trupat e pajetë të njerëzve në Kosovë.

Të ekzekutuarit-masakruarit:

1. Ismet Zenel Loku (1978-1999),
2. Ismail Nazmi Loku (1971-1999),
3. Agim Nazmi Loku (1968-1999),
4. Vesel Ramadan Vlashi (1944-1999),
5. Ibush Rexhep Loku (1976-1999),
6. Naser Fazli Loku (1975-1999),
7. Idriz Xhemail Kuçi (1944-1999),
8. Sherif Sylejman Kuçi (1971-1999),

{12 Besim Koci, dëshmitar që i shpëtoi masakrës në Kotlinë

9. Izja Ismet Loku (1976-1999),
10. Naser Rexhep Loku (1982-1999),
11. Bajram Qani Loku (1971-1999),
12. Sabit Garip Loku (1979-1999),
13. Garip Ilaz Loku (1952-1999),
14. Zymer Xhemal Loku (1932-1999),
15. Minah Baki Kuçi (1982-1999),
16. Ismail Ismet Kuçi (1978-1999),
17. Emërllah Mexhid Kuçi (1976-1999),

Atë ditë, më 24 mars të vitit 1999, në përpjekje për t'i penguar forcat ushtarake e policore serbe që të hyjnë në fshat dhe për ta mbrojtur popullatën civile, ranë dëshmorë pjesëtarët e UÇK-së, trupat e pa jetë të të cilëve, forcat kriminale i gjymtuan së bashku me trupat e civilëve të fshatit Kotlinë.

18. Xhemajl Nuredin Kuçi (1977-1999),
19. Neshat Ferid Rexha (1976-1999),
20. Danush Idriz Kuçi (1982-1999),
21. Sabri Hamit Loku (1971-1999),
22. Nuhi Shabedin Loku (1971-1999),
23. Nexhadi Ferid Kuçi (1968-1999),
24. Cenë Ekrem Loku (1964-1999),
25. Sali Bajram Vlasi (1957-1999),
26. Adnan Refik Loku (1978-1999),
27. Milaim Gani Loku (1965-1999) si dhe
28. Amrush Liman Loku (1978-1999), (bie në Koshare).

MASAKRA NË BELLACERKË (25.03.1999)

Masakra e forcave serbe në Bellacerkë ndodhi më 25 mars të vitit 1999, vetëm një ditë pasi filluan bombardimet e Aleancës së NATO-s mbi caqet ushtarake e policore të Serbisë.

Kjo zgjati jo më shumë se tre minuta, tre minuta egërsi dhe shkrepje automatikësh dhe më nuk u dëgjua asgjë. *"Ata filluan të shtiejnë në ne dhe unë u plagosa në shpatull. Unë isha me fat, sepse të gjitha kufomat ranë mbi mua."* ^{13}

Më 25 mars, rreth orës 3:30, në natën e parë të bombave të NATO-s në Jugosllavi, forcat serbe kishin filluar operacionin e tyre. Një duzinë e tankeve serbe u pozicionuan në Belacerkë, për t'iu mënjeluar cakut të avionëve të NATO-s. Isufi ishte i vetmi, i cili dëshmoi, sepse i pa vrasjet atë ditë tragjike. Njerëz nga i tërë fshati kishin filluar të tuboheshin afër lumit. Ata shkuan në vendin e quajtur Ura e Bellasë. Rreth 800 fshatarë u përpoqën për t'u fshehur nën urë. Rreth orës 9 e 30të mëngjesit, 16 policë të njësisë speciale filluan të shtënat me armë automatike. Mbi dy familje që ishin ndarë nga grupi, serbët hapën zjarr, duke vrarë të gjithë anëtarët e tyre, me përjashtim të një çuni 2-vjeçar, i cili shpëtoi duke e mbrojtur nëna e tij. Të gjithë i ndaluan të platforma e hekurudhës. Burrat i ndanë nga gratë e fëmijët, pastaj i urdhëruan burrat që të zhvisheshin. Çetnikët serbë ua morën të gjitha gjësendet që kishin, pastaj gratë e fëmijët i urdhëruan që të shkonin në drejtim të Xërxes. Burrat i urdhëruan të shkonin të bregu i lumit, ku i ekzekutuan e i masakruan pamëshirshëm.

{13 Isuf Zheniqi, i mbijetuari i masakrës, /Dëshmi të publikuara/

Të ekzekutuarit-masakruarit:

1. Hajrullah Begaj (29 vjeçar)
2. Murat Berisha (62 vjeçar), (*Imam i fshatit*)
3. Adem Berisha (33 vjeçar)
4. Hysni Fetoshi (50 vjeçar)
5. Halim Fetoshi (70 vjeçar)
6. Fatmir Fetoshi (30 vjeçar)
7. Ardian Fetoshi (16 vjeçar)
8. Fadil Gashi (47 vjeçar)
9. Musat Morina (60 vjeçar)
10. Zyraje Morina (55 vjeçar)
11. Nesim Popaj (36 vjeçar), (*doktor*)
12. Shendet Popaj (17 vjeçar)
13. Etihem Popaj (40 vjeçar)
14. Krashnik Popaj (48 vjeçar)
15. Isuf Popaj (65 vjeçar)
16. Mehmet Popaj (46 vjeçar)
17. Vehap Popaj (60 vjeçar)
18. Bedrush Popaj (50 vjeçar)
19. Avdullah Popaj (16 vjeçar)
20. Sedat Popaj (50 vjeçar)
21. Ifan Popaj (40 vjeçar)
22. Rustem Popaj (63 vjeçar)
23. Mursel Popaj (50 vjeçar)
24. Sahit Popaj (42 vjeçar)
25. Behlul Popaj (14 vjeçar)
26. Nazmija Popaj (45 vjeçar)
27. Albani Popaj (20 vjeçar)
28. Agon Popaj (14 vjeçar)
29. Hysni Popaj (38 vjeçar)
30. Lendrit Popaj (17 vjeçar)

- 31.Xhemajl Spahiu (70 vjeçar), nga fshati Opterushë, i cili bashkë me 6 anëtarë të familjes ishte vrarë bashkë me Çlirim Zhuniqin në grupin e parë prej 12 vetave.
- 32.Eshref Zhuniqi (60 vjeçar)
- 33.Fatos Zhuniqi (42 vjeçar)
- 34.Labinot Zhuniqi (17 vjeçar)
- 35.Mahamet Zhuniqi (65 vjeçar)
- 36.Reshit Zhuniqi (25 vjeçar)
- 37.Qamil Zhuniqi (72 vjeçar)
- 38.Ibrahim Zhuniqi (70 vjeçar)
- 39.Abedin Zhuniqi (36 vjeçar)
- 40.Bajram Zhuniqi (50 vjeçar)
- 41.Qemajl Zhuniqi (57 vjeçar)
- 42.Hysni Zhuniqi (62 vjeçar)
- 43.Kasim Zhuniqi (30 vjeçar)
- 44.Mehdi Zhuniqi (60 vjeçar)
- 45.Ahmed Zhuniqi (?)
- 46.Agim Zhuniqi (55 vjeçar)
- 47.Destan Zhuniqi (65 vjeçar)
- 48.Bilal Zhuniqi (75 vjeçar)
- 49.Shemsi Zhuniqi (52 vjeçar)
- 50.Muharem Zhuniqi (28 vjeçar)
- 51.Çlirim Zhuniqi (40 vjeçar)
- 52.Lumnije Zhuniqi (39 vjeçare)
- 53.Dhurata Zhuniqi (10 vjeçare)
- 54.Dardana Zhuniqi (8 vjeçare)
- 55.Dardan Zhuniqi (5 vjeçar) dhe
- 56.Hysen Zhuniqi(22 vjeçar).

KRIMET SERBE NË OPTERUSHË (25.03.1999)

Në fshatin Opterushë, gjatë kohës së luftës më 25 mars 1999, forcat okupuese ushtarake-policore serbe, pasi kishin rrethuar fshatin, i zunë robë, i plaçkitën, i keqtrajtuat e më pas i ekzekutuan e masakruan 27 civilë shqiptarë, shumica prej tyre fëmijë, gra e të moshuar, 13 prej tyre anëtarë të familjes Spahiu, të cilët kishin ikur nga barbaria serbe. Ata duke menduar se ishin strehuar në vend më të sigurt, gjetën vdekjen nga terrori serb. Deri më tani askush nuk është nxjerrë para drejtësisë për këto krime.

Të ekzekutuarit-masakruarit:

- 1.Xhemajl Spahiu (1920-1999), Bellacerkë
- 2.Qamile Spahiu (1930-1999), Bellacerkë
- 3.Fiqirie Spahiu (1963-1999), Bellacerkë
- 4.Ilirjana Spahiu (1956-1999), Bellacerkë
- 5.Marigona Spahiu (1992-1999), Bellacerkë
- 6.Lirim Spahiu (1995-1999), Bellacerkë
- 7.Labinot Spahiu (1996-1999), Bellacerkë
- 8.Magbule Spahiu (1972-1999), Rahovec
- 9.Allber Dulaku (1975-1999), Suharekë
- 10.Shaban Kabashi (1922-1999), Piranë
- 11.Rexhep Spahiu (1953-1999), Samadraxhë
- 12.Agron Krasniqi (1980-1999), Krushë e Madhe
- 13.Bademe Mazreku (1913-1999), Krushë e Madhe
- 14.Hamit Bytyçi (1963-1999), Krushë e Vogël
- 15.Sadri Kabashi (191908-1999), Nagavc
- 16.Mihrije Kabashi (1934-1999), Nagavc
- 17.Haxhi Krasniqi (1946-1999), Hoqë e Vogël
18. Isak Mazreku (1929-1999), Hoqë e Vogël

19. Daim Bytyçi (1920-1999), Reqan
20. Hamëz Mazreku (1939-1998), Opterushë
21. Bexhet Mazreku (1946-1998), Opterushë
22. Shyrete Mazreku (1949-1998), Opterushë
23. Arton Spahiu (1984-1999), Opterushë

Të zhdukurit:

24. Ruzhdi Spahiu (1946-1999), Krushë e Madhe
25. Daut Spahiu (1981-1999), Krushë e Madhe
26. Xheladin Kabashi (1969-1999), Krushë e Madhe
27. Hysni Spahiu (1975-1999), Krushë e Madhe



Pllaka përkujtimore në Opterushë

Burimi:

-Fetnete Ramosaj, /Kundër harresës-Gjenocidi i Serbisë në Kosovë/, f.138, Prishtinë 2017

MASAKRA NË CELINË (25-26.03.1999)

Ishte mëngjesi i 25 marsit të vitit 1999, kur forca të mëdha ushtarake-policore serbe me makineri luftarake, përfshirë edhe tanke, kishin rrethuar fshatin Celinë. Ajo ditë ishte vërtet tragjike dhe shumë e vështirë për banorët e këtij fshati. Katrahura serbe në fshatin Celinë ka zgjatur 2 ditë, ku ishin masakruar 75 civilë shqiptarë.

Ushtria dhe policia serbe, pas sulmeve të NATO-s, mllëfin e tyre e kanë shfryrë te banorët e fshatit Celinë.

Të ekzekutuarit:

1. Miftar Selman Zeqiri (1938- 1999), Celinë
2. Sanie Nezir Zeqiri (1939-1999),
3. Sebahate Sherif Zeqiri (1966-1999),
4. Altin Selman Zeqiri (1989-1999),
5. Bledar Selman Zeqiri (1991-1999),
6. Bajram Miftar Zeqiri (1969-1999),
7. Myrvete Ukë Zeqiri (1966-1999),
8. Albulena Bajram Zeqiri (1989-1999),
9. Alban Bajram Zeqiri (1994-1999),
10. Alma Bajram Zeqiri (1996-1999),
11. Myrvete Mehmet Zeqiri (1957-1999),
12. Suzana Agim Zeqiri (1978-1999),
13. Elbasane Agim Zeqiri (1980-1999),
14. Nazlie Agim Zeqiri (1983-1999),
15. Burbuqe Agim Zeqiri (1986-1999),
16. Besart Agim Zeqiri (1988-1999),
17. Sabedin Ramadan Hasani (1953-1999),
18. Feride Bajram Hasani (1956-1999),
19. Ylber Sabedin Hasani (1979-1999),

20. Bedrush Sabedin Hasani (1984-1999),
21. Afrim Hajredin Hasani (1977-1999),
22. Hasan Muhamet Sinani (1893-1999),
23. Dinë Destan Sinani (1943- 1999),
24. Shyqri Destan Sinani (1950-1999),
25. Muhamet Hajdar Rexhepi (1926- 1999),
26. Hajdar Muhamet Rexhepi (1958-1999),
27. Vefai Muhamet Rexhepi (1962-1999),
28. Haki Mehmet Rexhepi (1932-1999),
29. Isamedin Mehmet Rexhepi (1939-1999),
30. Dërgut Haziz Rexhepi (1956-1999),
31. Naim Haziz Rexhepi (1961-1999),
32. Alban Nehat Rexhepi (1985-1999),
33. Sakip Jetullah Rexhepi (1964-1999),
34. Nasim Nuredin Rexhepi (1929-1999),
35. Muharrem Nuredin Rexhepi (1935-1999),
36. Nijazi Nuredin Rexhepi (1939-1999),
37. Shani Nuredin Rexhepi (1945-1999),
38. Dever Manush Rexhepi (1951-1999),
39. Teki Muharrem Rexhepi (1959-1999),
40. Bejtullah Hajrullah Fetahu (1938-1999),
41. Xhemile Mustafë Dina (1906-1999),
42. Selver Sylejman Dina (1931-1999),
43. Shaqir Sylejman Dina (1934-1999),
44. Rrahman Sylejman Dina (1948-1999),
45. Hamëz Shaqir Dina (1958-1999),
46. Skënder Selver Dina (1968-1999),
47. Driton Selver Dina (1978-1999),
48. Rifat Ramadan Dina (1939-1999),
49. Hyda Hajdin Dina (1927-1999),
50. Isa Hajdin Dina (1929-1999),

- 51.Xhafer Sherif Dina (1972-1999),
- 52.Fadil Sefer Abazi (1979-1999),
- 53.Haki Amrush Ramadani (1934-1999),
- 54.Ismet Dervish Ramadani (1927-1999),
- 55.Rasim Nuredin Ramadani (1962-1999),
- 56.Shyqeri Hajrush Ramadani (1945-1999),
- 57.Agim Destan Ramadani (1976-1999),
- 58.Ahmet Malush Bajrami (1937-1999),
- 59.Hysni Pajazit Ibrahimimi (1956-1999),
- 60.Sadri Iusuf Jemini (1921-1999)
- 61.Sinavere Sadik Jemini (1935-1999),
- 62.Shaip Isuf Jemini (1925-1999),
- 63.Muharrem Hysen Jemini (1941-1999),
- 64.Zade Qerim Jemini (1943-1999),
- 65.Ibrahim Hamëz Fazliu (1947-1999),
- 66.Nahit Shaqir Fazliu (1973-1999),
- 67.Fetie Shaban Kadriu (1928-1999),
- 68.Bajram Hasan Salihu (1933-1999),
- 69.Faik Hasan Salihu (1953-1999),
- 70.Mire Selim Salihu (1958-1999),
- 71.Dashurie Faik Salihu (1979-1999),
- 72.Gëzim Faik Salihu (1982-1999),
- 73.Mejreme Faik Salihu (1984-1999),
- 74.Servete Faik Salihu (1987-1999) dhe
- 75.Ramazan Faik Salihu (1992-1999).

Burimi:

-Mr.Ibrahim Gashi dhe Mr. Hamdi Fazliu, /Masakra e Celinës-Masacre in Celina/, f.78-182,

MASAKRA NË FSHATIN TËRNJE TË THERANDËS (25-28.03.1999)

Më datë 25 deri 28 mars të vitit 1999, forca të mëdha të ushtrisë dhe policisë serbe, me urdhër të eprorëve të lartë, kishin rrethuar fshatin Tërnje, kinse për pastrimin e terrenit nga pjesëtarë të UÇK-së, “terroristët” siç i quanin ata, dhe, urdhëresa ishte e prerë; “sot këtu askush s’duhet të mbetet i gjallë”. Meqë në fshat nuk kishte pjesëtarë të UÇK-së, këtë e dinin mirë urdhërdhënësit si; Komandanti i batalionit Pvlë Gavriloviç, Zëvendësi i tij Gligoreviç, Kapiteni Jaqimoviç si dhe Kozlina Rajko, ata e kishin qëllimin të vrasin civil të pafajshëm shqiptarë. Këtë e ka dëshmuar në Gjykatën ndërkombëtare dëshmitari K-41, pjesëtar i këtij operacioni shfarosës, i cili thotë se kemi masakruar edhe fëmijë!.

Të ekzekutuarit-masakruarit:

1. Haki Misin Gashi (1927-1999), Tërnje
2. Musli Shaban Gashi (1927-1999), Tërnje
3. Shefkije Xhamajli Gashi (1927-1999), Zojzë
4. Shyqeri Musli Gashi (1949-1999), Tërnje
5. Arben Shyqeri Gashi (1983-1999), Tërnje
6. Sedat Shyqeri Gashi (1986-1999), Tërnje (i zhdukur)
7. Habibe Hasan Gashi (1968-1999), Grejkoc
8. Fisnik Hysen Gashi (1989-1999), Tërnje (nxënës)
9. Natyra Hysen Gashi (1991-1999), Tërnje (nxënëse)
10. Emir Hysen Gashi (1994-1999), Tërnje (fëmijë)
11. Hyra Ali Gashi (1942-1999), Gjinoc-Tërnje
12. Luljeta Latif Gashi (1965-1999), Tërnje
13. Selvete Latif Gashi (1968-1999), Tërnje
14. Lumturie Latif Gashi (1981-1999), Tërnje (nxënëse)
15. Blerta latif Gashi (1984-1999), Tërnje (nxënëse)

16. Shemsije Nebih Gashi (1958-1999), Gjinoc-Tërrnje
17. Votim Murat Gashi (1991-1999), Tërrnje (nxënës)
18. Bahrije Isuf Gashi (1939-1999), Studençan
19. Shaban Nuhi Gashi (1961-1999), Tërrnje
20. Hamzi Nuhi Gashi (1964-1999), Tërrnje
21. Ajmane Nuhi Gashi (1966-1999), Tërrnje
22. Besarta Shaban Gashi (1986-1999), Tërrnje (nxënëse)
23. Refki Qemajl Rexhaj (1950-1999), (mësues)
24. Rexhep Hysen Voci (1926), (i zhdukur më 10/04/1999)
25. Musli Hysen Voci (1935-1999), Tërrnje
26. Ali Hysen Voci (1939-1999), Tërrnje
27. Rahime Voci (1949-1999), Vraniq
28. Alltane Krasniqi (1943-1999), Potoqan
29. Kasum Shaqir Muhaxheri (1950-1999), Tërrnje
30. Besnik Kasum Muhaxheri (1969-1999),
31. Hajrije Muhaxheri (1915-1999), Medvec (e zhdukur)
32. Azize Vranovci (1911-1999), Samadrazh
33. Xhemajli Mehmet Vranoci (1920-1999), Tërrnje
34. Mirsad Liman Llapatinca (1969-1999), Tërrnje
35. Qazim Mustaf Llapatinca (1950-1999), Topliqan
36. Muhamet Jetullah Balaj (1955-1999), Bukosh
37. Jeton Muhamet Balaj (1980-1999), (nxënës)
38. Ramadan Isuf Krasniqi (1928-1999), Studençan
(i zhdukur më 25/03/1999)
39. Muhamet Isuf Krasniqi (1936-1999),
40. Refije Kurtish Krasniqi (1950-1999), Studençan
41. Behare Hylki Krasniqi (1977-1999),
42. Mehmet Qazim Limani (1944-1999),
43. Xhyzide Bytyqi (1940-1999), Zaqisht (e zhdukur)
44. Shqipe Bajram Bytyqi (1972-1999), Korishë

45. Altin Lulzim Bytyqi, Studençan (18 fëmijë muajsh)
46. Nuhi Bexhet Rexhepi, Randobravë (nxënës 17-vjeç).

Pas ekzaminimit të kufomave mësohet, se këto femra të masakruara ishin prej fshatrave; Studençan dhe Tërnje të komunës së Therandës (ish-Suharekës).

Femra të masakruara:

1. Rafije Krasniqi - nga Studençani (49 vjeç),
2. Behare Krasniqi - nga Studençani (22 vjeç),
3. Bahrije Gashi (1938-1999) - nga Tërnja,
4. Rahime Voci (1947-1999) - nga Tërnja,
5. Ajmone Gashi (1966-1999) - nga Tërnja dhe
6. Besarta Gashi (1985-1999) - nga Tërnja.



Pamje tmerruese e popullatës civile (1999)

Burimi:

-Forumi shqiptar, /Fshati Tërnje-Një masakër e treguar më ndryshe/

KRIMET SERBE NË AÇAREVË (1998/1999) (26.03.1999)

Forcat ushtarake policore serbe, të ndihmuara edhe nga paramilitarë vendës kishin në shënjestër fshatin Açarevë, i cili ndodhej afër fshatit Jellovc, asokohe i banuar kryesisht me serbë. Këto forca të armatosura, gjatë viteve 1998/1999 ndërmorën disa ofensiva shfarosëse ndaj popullatës civile në Açarevë, duke plaçkitur, djegur, vrarë e ekzekutuar shumë civilë të paarmatosur.

Të vrarët:

1. Arben Nura (1980-1999), Açarevë
2. Zenë Veseli (1963-1999),
3. Rafet Haxha (1989-1999),
4. Nexhat Haxha (1987-1999),
5. Shehide Haxha (1935-1999),
6. Islam Hamiti (1932-1999),
7. Qamil Jakupi (1963-1999),
8. Hanife Jashari (1953-1999),
9. Azem Beqiri (1958-1999),
10. Hajzer Veseli (1944-1999),
11. Xhemë Azemi (1972-1999),
12. Asllan Hasani (1942-1999),
13. Sahit Idrizi (1922-1999),
14. Hasan Dani (1930-1999),
15. Miftar Rama (1967-1999), Açarevë dhe
16. Mujë Tafilaj (1968-1999), i vrarë në Burgun e Dubravës,
Duke luftuar për çlirimin e vendit dhe në mbrojtje të popullatës civile, nga radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ranë dëshmorët:

Xhavit Uka (1948-1998),
Zymer Tahiri (1946-1998),

Ismet Rrahmani (1962-1998),
Shaban Shabani (1949-1998) dhe
Xhafer Avdullahu (1962-1999), AçaREVË.^{14}

Edhe pse forcat ushtarake policore serbe dhe komanda e tyre të strehuara dhe të maskuara nëpër malet e AçaREVËS, për t'iu ikur caqeve te aviacionit të NATO-s, pikërisht nëpër rrugën nga Zabeli i Fyllave deri të Kodra e Ujmirit, në vendin e quajtur Konopnishtë, e dinin mirë se mes tuneleve ishin të strehuar mbi 10.000 veta, popullatë civile, gra, fëmijë e të moshuar. Forcat e shfrenuara ushtarake policore serbe, në pasditën e datës 26 mars 1999, në ora 17:15, prej vendit të quajtur Konopishtë kishin filluar granatimin në drejtim të popullatës civile, që kishte ikur nga barbaria serbe dhe ishte strehuar mes Tuneleve të AçaREVËS. Të strehuarit ishin nga fshatrat AçaREVË, Plluzhinë, Likofc, Abri, Ujmirë, Dobërdol, Qabiq, Cerovikë e fshatra tjera.

Atje, në mes të tuneleve, si pasojë e granatimeve mbi popullatën civile janë vrarë e plagosur rëndë shumë civili.

Të vrarët më 26.03.1999:

17. Sejdi Sokol Beqiri (1938-1999), AçaREVË
18. Fazli Binak Beqiri (1952-1999),
19. Qazim Nura (1927-1999),
20. Zyrafete Nura (1978-1999),
21. Ganimete Beqiri (1976-1999), AçaREVË dhe
22. Fadil Boja (?-1999) nga Kërrnica.

Derisa gjatë luftimeve të paraditës, te Zabeli i Fyllajve, në mbrojtje të popullatës civile u plagosën 4 pjesëtarë të Brigadës 113: Besim Shaban Hasani, Bekim Shala, Xhavit Sokol Selimi dhe Selman Shaban Selimi.^{15}

{14 Musli Haxha, Shënime dhe dëshmi për krimet serbe në AçaREVË 1998/1999

{15 Dibran Fylli, Shënime nga ditari i luftës, fletore nr.1,f.32, AçaREVË-Drenicë, 1998/1999

MASAKRA E FAMILJES BERISHA NË THERANDË (26.03.1999) ¹⁶

Njëri nga tre të mbijetuarit në masakrën e Familjes Berisha në Suharekë ishte Gramoz Berisha, i cili në atë kohë ishte 8 vjeçar kur pa nga afër të masakrohen të afërmit e tij. Ai nuk e harron kurrë 26 marsin 1999. Ditën kur forcat policore, ushtarake e paramilitare serbe ekzekutuan anëtarët e kësaj familje.

Gjithçka filloi kur forcat serbe nisën një operacion për dëbimin e shqiptarëve nga pronat e tyre. Shumë u vranë në prag të shtëpive, shumë të tjerë u grumbulluan në një lokal, ku më vonë u krye njëri nga krimet më të rënda të regjimit serb. Shumica e të masakruarve ishin në moshë të re. Fatin e tyre, nuk e pati djaloshi Gramoz Berisha, i cili mbijetoi bashkë me nënën e tij Vjollca Berisha dhe një të afërme tjetër.

Kur ky kishte dëgjuar krismat kishte kuptuar se diçka është duke ndodhur dhe se familjarët e tij ishin ekzekutuar. Pas ekzekutimit të burrave, gratë dhe fëmijët ishin bërë bashkë në lagje, duke menduar se do të liheshin të lirë të largohen për në Shqipëri. Por nuk ndodhi ashtu. Shumë fëmijë, gra shtatzëna e të moshuar, u detyruan të futen në lokalin e tmerrit. Ata nuk e dinin se çka i priste!.

Në atë lokal ishin 40 anëtarë, duke përfshirë familjarët e Gramozit, të cilët mendonin se do të shpëtonin, dhe kur forcat serbe kishin shtënë në drejtim të tyre, ai ishte plagosur. Në atë vend forcat serbe kishin përdorur armë të ndryshme, madje edhe granata dore që kishin hedhur në lokalin ku i kishin mbyllur 40 veta. Këtë e bënë që të mos shpëtojë asnjë dëshmitarë, por Gramozi ashtu i plagosur e me dhembje të mëdha ishte paraqitur si i vdekur. Çetnikët e fusin në një qese dhe e vendosin në kamion. Serbët po planifikonin që të gjithë të vranë t'i fusin në një varrezë masive.

Të ekzekutuarit:

1. Have Berisha (?-1999)
2. Sedat Berisha (1954-1999)
3. Bujar Berisha (1959-1999)
4. Nexhmedin Berisha (1962-1999)
5. Florie Berisha (1961-1999)
6. Vlorian Berisha (1982-1999)
7. Edon Berisha (1986-1999)
8. Doruntina Berisha (1996-1999)
9. Lirije Berisha (1973-1999)
10. Dafina Berisha (1983-1999)
11. Drilon Berisha (1986-1999)
12. Fatime Berisha (1950-1999)
13. Faton Berisha (1971-1999)
14. Sherine Berisha (1982-1999)
15. Sebahate Berisha (1973-1999)
16. Ismet Berisha (1996-1999)
17. Eron Berisha (1998-1999)
18. Nexhat Berisha (1955-1999)
19. Majlinda Berisha (1983-1999)
20. Herolinda Berisha (1985-1999)
21. Altin Berisha (1986-1999)
22. Redon Berisha (1997-1999)
23. Hatixhe Berisha (1900-1999)
24. Vesel Berisha (1938-1999)
25. Hajdin Berisha (1962-1999)
26. Mihrije Berisha (1973-1999)
27. Sofije Berisha (1941-1999)
28. Besim Berisha (1966-1999)
29. Mevlyde Berisha (1973-1999)
30. Genc Besim Berisha (1996-1999)

{16 Gramoz Berisha, i mbijetuari nga masakra e Suharekës, 26.03.1999

KRIMET SERBE NË RESNIK-KLINË (26.03.1999)

Forcat ushtarake policore serbe, në bashkëveprim me paramilitarë vendës, të fshatit Jellovc dhe serbë të armatosur të lagjes së 12 shtëpive, kishin vu në shënjestër fshatin Resnik të komunës së Klinës, fshat i afërt me Açarevën e qëndodhej shumëafër fshatit Jellovc dhe me 12 shtëpitë, në atë kohë të banuar kryesisht me serbë. Këto forca të armatosura, më 26 mars 1999 ndërmorën një aksion shfarosës kundër popullatës civile shqiptare të këtij fshati me pak banorë, por që deri atëherë nuk kishin pasur as edhe një problem me komshinjtë e tyre serbë. Forcat e armatosura serbe fillimisht kishin rrethuar fshatin, më pas i grumbulluan të gjithë banorët afër një përroske, i ndan burrat dhe pamëshirshëm i ekzekutuan.

Të ekzekutuarit:

1. Murat Bajram Bajraktari (1932-1999), Resnik
2. Ismajl Bajram Bajraktari (1934-1999),
3. Daut Hazir Bajraktari (1936-1999),
4. Ramadan S. Bajraktari (1937-1999),
5. Jakup Ramë Bajraktari (1938-1999),
6. Hajzer Hazir Bajraktari (1956-1999),
7. Bislim H. Bajraktari (1957-1999), Resnik, (i vrarë më 28 mars 1999, në masakrën e Izbicës).

Burimi:

-Valdet Berisha, /Shënime të grumbulluara në terren/, Klinë 1999/2000

MASAKRA NË FAMILJEN IMERAJ (26.03.1999)

Në fshatin Pemishtë (ish-Padalishtë), më 26 mars 1999, vetëm dy ditë pas fillimit të bombardimeve të NATO-s, forcat ushtarako-police e paramilitare serbe, në mesin e të cilëve kishte edhe serbë lokalë të fshatit Cërkolez dhe disa tjerë të fshatrave të komunës së Burimit (ish-Istogut), mizorisht vranë e masakruan 19 anëtarë të familjes Imeraj, prej moshës 2 deri në 80 vjeç, si dhe i plagosën shumë të tjerë. Rasti i Padalishtës është ngritur edhe në Tribunalin e Hagës, por deri më tani nuk është dënuar askush për masakrën e bërë mbi familjen Imeraj. ^{17}

Në orët e hershme të mëngjesit të datës 31 maj 1999, forcat ushtarake, policore e paramilitare serbe dhe serbë lokalë të Vushtrrisë, pahetueshëm hyjnë në lagjen Gërxhaliu dhe në shtëpinë e Selatinit, ku i ekzekutojnë pamëshirshëm 13 anëtarë e familjes Gërxhaliu.

Të ekzekutuarit:

1. Selatin Gërxhaliu (50vjeç),
2. Fexhrije Veseli-Gërxhaliu (40vjeç),
3. Shaban S. Gërxhaliu (16vjeç),
4. Shahin S. Gërxhaliu (15vjeç),
5. Muharrem S. Gërxhaliu (13vjeç),
6. Mexhid S. Gërxhaliu (12vjeç),
7. Abdurrahman S. Gërxhaliu (9vjeç),
8. Mubere S. Gërxhaliu (6vjeç),
9. Sabahudin S. Gërxhaliu (5vjeç),
10. Sahide Aliu-Gërxhaliu (85vjeç),
11. Sofije Gërxhaliu (30vjeç),
12. Safet N. Gërxhaliu (6vjeç) dhe
13. Xhemajl Gërxhaliu (63vjeç).

Burimi:

-/Kundër harresës-Gjenocidi i Serbisë në Kosovë/, f.127, Prishtinë 2017

-Raporti i KMDLNJ-së, Prishtinë

KRIMET SERBE NË FAMILJEN BALA NË PEJË (12.06.1999)

Më 12 qershor 1999, vetëm tri ditë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Kumanovës, kur forcat e NATO-s kishin hyrë në Prishtinë, në Pejë, forcat ushtarake policore serbe, pasi i kishin zënë robër anëtarët e Familjes Bala, i kishin plaçkitur e keqtrajtuar në mënyrën më çnjerëzore, 7 prej tyre i kishin ekzekutuar, kurse 5 tjerë kishin shpëtuar në saje të fatit. Edhe pse kriminelët janë të identifikuar, deri më tani askush nuk është nxjerrë para drejtësisë.

Të ekzekutuarit:

1. Musa Bala (31vjeç),
2. Vjollca Bala (28vjeç),
3. Rina Musa Bala (7vjeç),
4. Nita Musa Bala (5vjeç),
5. Hajri Isa Bala (13vjeç),
6. Dardane Isa Bala (11vjeç) dhe
7. Agon Isa Bala (6vjeç).



Formacionet paraushtarake dhe policore serb që vepruan në Kosovë gjatë viteve 1998/1999

Burimi:

-/Kundër harresës-Gjenocidi i Serbisë në Kosovë/, f.221, Prishtinë 2017

KRIMET SERBE NË KOMUNËN E ZVEÇANIT (1998-1999)

Të ekzekutuarit:

1. Sami Nazif Kelmendi (1968-29.03.1999),
2. Nusret Ahmet Peci (1971-19.04.1999),
3. Fidan Bajram Peci (1982-29.04.1999),
4. Flurim Isa Peci (1969-29.04.1999),
5. Selman Nazif Peci (1955-29.04.1999),
6. Adem Rifat Peci (1954-29.04.1999),
7. Gani Xhevat Peci (1961-29.04.1999),
8. Bashkim Tahir Peci (1971-09.05.1999),
9. Fahri Ahmet Kelmendi (1956-15.05.1999),
10. Xhevdet Sali Kelmendi (1956-25.05.1999)
11. Sadat Kamer Peci (1979-25.05.1999).
12. Gani Kelmendi (1950-02.06.1999).

Të zhdukurit:

1. Azem Deli Deliu (1950-1998),
2. Shpresa Azem Deliu (1961-1998),
3. Irena Adem Deliu (1979-1999),
4. Halim Z. Kelmendi (1960-1999),
5. Fazile Fetah Sahiti (1904-1999),
6. Shaqir Isuf Peci (1934-1999),
7. Xhevdet Bajram Peci (1951-1999).

Burimi:

-Agjencia shtetërore e Arkivave të Kosovës, Prishtinë, 2010

-Prof. Dr. Jusuf Osmani, /Krimet e Serbisë në Kosovë/, f.464, Prishtinë, 2010

KRIMET E STRUKTURAVE KRIMINALE SERBE NË
MITROVICË
(03-04.02.2000)

Në natën mes datës 03 dhe 04 shkurt të vitit 2000, në veriun e Mitrovicës u ekzekutuan 10 qytetarë shqiptarë, në mesin e të cilëve kishte fëmijë, gra dhe pleq. Këtë natë ishin plagosur 25 shqiptarë, në përpjekje për të shpëtuar nga dora e strukturave kriminale e serbëve të veriut. Ndërkaq brenda atij muaji u dëbuan me dhunë nga shtëpitë e tyre 1564 familje me gjithsej 11.364 anëtarë. Po në këto ditë tmerri filloi spastrimi etnik i pjesës veriore të qytetit të Mitrovicës nga strukturat kriminale të serbëve të veriut, të ndihmuara nga forca tjera policore serbe, që po e formonin një lloj paralelizmi shtetëror brenda Republikës së Kosovës. Operacionin e vrasjeve e kishin udhëhequr forcat policore të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, të drejtuara nga Dragan Delibashiç, Oliver Ivanoviç dhe të tjerë.

Të ekzekutuarit:

1. Muharrem Sokoli,
2. Bashkim Rrukeci,
3. Nezir Voca,
4. Shqipe Voca,
5. Remzije Canhasi,
6. Nderim Ajeti,
7. Selime Berisha,
8. Sebaha Abrashi,
9. Niman Sejdiu dhe
10. Nexhmije Xhaka.

Burimi:

-Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, /Nata e tmerrit/, Mitrovicë

**RAPORTE-DËSHMI
PËR KRIMET SERBE NË KOSOVË**



KMDLNJ
Prishtinë

**Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive
të Njeriut**

**Council for the Defense of Human Rights
and Freedoms**

**HUMAN
RIGHTS
WATCH**

WORLD REPORT

1998/1999

QIK

**QENDRA PËR INFORMIM
E KOSOVËS**

VRASJET, EKZEKUTIMET, MASAKRAT DHE DËMET E SHKAKTUARA GJATË LUFTËS NË KOMUNËN E DRENASIT

(Janar 1998 – Qershor 1999)

Në bazë të dëshmive të grumbulluara nga burime të sakta dhe nga të dhënat e KMDLNJ-së, në periudhën janar 1998-12 qershor 1999, nga forcat ushtarako-policore dhe paramilitare serbe, në komunën e Drenasit; *"U vranë 707 shqiptarë, prej tyre 503 meshkuj dhe 114 femra dhe kanë rënë 199 dëshmorë, prej tyre 5 femra". U bënë 7 masakra kolektive dhe u gjetën mbi 16 varreza masive. Janë evidencuar 75 të zhdukur, 320 të plagosur dhe 252 të burgosur. Pa njërin prind kanë mbetur 187 fëmijë, ndërsa pa të dy prindërit 89 fëmijë. Gjithashtu, janë dëmtuar dhe shkatërruar 8.142 shtëpi (prej tyre 2.643 tërësisht), ndërsa prej 32 objekteve shkollore, që ishin para luftës, vetëm një ka shpëtuar pa u shkatërruar. Janë djegur 7 biblioteka me 1.220 000 tituj librash. Janë shkatërruar shumë objekte shëndetësore dhe fetare, si dhe mijëra objekte të tjera tregtare, në sektorin privat dhe në atë shoqëror".*

Në komunën e Drenasit, forcat kriminale serbe (gjatë viteve 1998-1999) kryen masakrat më të tmerrshme, të cilat tronditën opinionin publik. U vranë, u masakruan dhe u dogjën pa mëshirë shumë civilë shqiptarë të paarmatosur, kryesisht pleq, gra e fëmijë. Me këtë rast po i veçojmë disa masakra:

Më 28 shkurt dhe 1 mars 1998 në Likoshan, janë vrarë e masakruar 10 anëtarë të familjes Ahmeti dhe një mysafir. Ndërkaq, gjatë viteve 1998-1999 janë vrarë 34 banorë civilë dhe kanë rënë dëshmorë katër ushtarë të UÇK-së, ndërsa janë të zhdukur tre banorë të tjerë.

Më 26 shtator 1998, në Abri të Epërme (në lagjen Deliu), forcat

kriminale serbe kryen një nga masakrat më të tmerrshme gjatë luftës në Kosovë. Masakruan 23 anëtarë të familjes Deliu, në mesin e tyre gra, fëmijë e pleq (nga moshë 6-muajshe - 94 vjeç)

Në prill 1999, forcat ushtarako-policore dhe paramilitare serbe vranë e masakruan qindra shqiptarë të kësaj komune.

Më 12 prill 1999, në fshatin Negroc u vranë 20 civilë shqiptarë. Më 14 prill 1999 në Vasilevë, dhe më 16 prill në Gllanasellë dhe në fshatrat e Qyqavicës, u vranë e masakruan shumë civilë shqiptarë, kryesisht të moshuar.

Më 17 prill 1999 në Çikatovë të Vjetër janë vranë e masakruar 128 shqiptarë të këtij fshati dhe të fshatrave të tjera. Po atë ditë në fshatin Poklek, në shtëpinë e Sinan Muçollit (në dhomën prej 20 m²), u vranë me breshëri automatiku, u masakruan dhe në fund u dogjën 53 shqiptarë, (në mesin e tyre 23 fëmijë të moshës 6 muaj deri në 14 vjeç), pastaj 12 vajza, 14 gra, 2 burra dhe 2 djem. Në këtë masakër u vranë 33 anëtarë të familjes Muçolli, 4 anëtarë të familjes Caraku nga Dobrasheci, 1 anëtar i familjes Hoxha nga Korrotica e Epërme etj. Pas dy ditëve, forcat kriminale serbe u kthyen në vendin e krimit dhe sërish ua japin zjarrin kufomave me goma, plastikë dhe lëndë djegëse, me qëllim të zhdukjes së gjurmëve të krimit të kryer.

Më 18 prill 1999, forca të shumta serbe sulmuan malet e Berishës, ku ishin strehuar mbi 70.000 civilë shqiptarë dhe ku gjendej SHP i UÇK-së dhe Radio "Kosova e Lirë".

Më 30 prill 1999, forcat kriminale serbe gjatë një sulmi në fshatrat Vërboc e Shtuticë vranë e masakruan mizorisht mbi 166 civilë shqiptarë. Atë ditë në Vërboc u vranë 96 civilë (65 nga Vërboci dhe 31 veta nga fshatrat e tjera), kurse në Shtuticë u vranë mbi 70 civilë shqiptarë (prej tyre 33 ishin nga Shtutica).

Burimi:

-Shënimet nga raportet e KMDLNJ-së, Prishtinë 1998/1999/2000

KRIMET SERBE NË DRENICË (Shtator 1998)

Më 26 shtator, në afërsi të Tunelit të Murgës, në mes të Açarevës dhe Cerovikut, forcat policore dhe ushtarake serbe i ndanë nga turma e të ikurve dhe i ekzekutuan, Smajl Millakun, 72 vjeç dhe djalin e tij, Sefer Millakun, 49 vjeç, nga Ujmiri i Klinës. Në të njëjtën ditë, po këto forca serbe, në fshatin Gollubovc ekzekutuan 8 shqiptarë të pafajshëm.

-Më 26 shtator 1998, në lagjen Deliu, të fshatit Abri e Epërme u gjetën të vrarë dhe të masakruar 23 anëtarë të familjes Deliu, në mesin e tyre gra, fëmijë e pleq (prej moshës 6 muaj deri në 94 vjeç).

-Më 27 shtator në lokalet e shkollës fillore në Krajkovë të Gillogovcit, forcat serbe mbajtën të arrestuar mbi 300 civilë shqiptarë nga fshatrat e ndryshme të Drenicës.

-Sipas informatave të këshillit thuhet se vetëm në ofensivën e fundit të forcave serbe në komunën e Gillogovcit janë identifikuar 87 shqiptarë të vrarë, kurse gjatë muajit shtator ka regjistruar 492 të vrarë, të masakruar dhe të dënuar pa gjyq; 159 të plagosur; 12 tentime vrasjeje; 198 persona të zhdukur, 8 persona të kidnapuar; 519 shqiptarë të arrestuar; 1885 shqiptarë të keqtrajtuar në mënyra të ndryshme; 98 shqiptarëve iu është hapur procedura hetimore; 18 të ftuar në biseda të ashtuquajtura informative; 260 persona të rrahur brutalisht, në rrugë, shtëpi, apo në stacione të policisë, që kanë marrë lëndime të rënda; dy raste të dënimit për kundërvajtje; 12 raste të dënimit për vepër penale; 65 familje të bastisura; 135 femra të keqtrajtuara në mënyra të ndryshme; 108 fëmijë të keqtrajtuar; 133 pleq të keqtrajtuar prej moshës 65-98 vjeç, ndër këta edhe shtatë anëtarë të KMDLNJ-së.

Burimi:

-Shënimet nga raportet e KMDLNJ-së, Prishtinë 1998/1999/2000

RAPORTI KMDLNJ-së (1998-1999)

Sipas Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut me seli në Prishtinë, që nga data 28 shkurt 1998 deri më 22 maj 1999, forcat ushtarake, policore dhe paraushtarake të Serbisë kanë bërë 274 vrasje në masë, në të cilat janë vrarë 3721 civilë të paarmatosur dhe këto vrasje dhe masakra kanë pasur shtrirje në tërë territorin e Kosovës.

Në këtë periudhë kohore, sipas KMDLNJ-së, janë identifikuar dhe hapur 142 varreza masive në Kosovë, nga të cilat janë zhvarrosur 2031 persona të ekzekutuar. Janë identifikuar edhe disa varreza masive në Serbi, si në Peruqac, Petrovo Sello dhe Batajnica 1, 2 dhe 3 etj., në të cilat janë gjetur mbetjet mortore të afër 1000 shqiptarëve të vrarë e të masakruar gjatë luftës 1998 - 1999 në Kosovë.

Në raportet e KMDLNJ-së rezulton se vrasjet dhe masakrat në masë të shqiptarëve, më së shumti janë bërë në komunën e Gjakovës, gjithsejt 40 raste me 693 persona.

-Në komunën e Pejës janë regjistruar 39 raste të vrasjeve në masë me 451 të vrarë dhe të masakruar.

-Komuna e Klinës ka 144 të vrarë në 23 raste të vrasjeve në masë.

-Në komunën e Rahovecit janë evidentuar 22 raste të vrasjeve në masë me 391 të vrarë e tjera.

RAPORTI I KMDL NJ-së PËR KRIMET SERBE (26.04 - 31.05.1998)

Më 26 prill 1998, nga sulmet artilerike mbi Baballoq dhe rrethinë shkatërrohen 20 shtëpi dhe vriten 10 shqiptarë (10 nga Gjakova dhe 6 nga Deçani).

Më 27 prill 1998 granatohen fshatrat Hulaj dhe Voksh dhe në këtë sulm vriten 3 shqiptarë dhe 4 ushtarë serbë.

Më 03 maj 1998, sulmohen fshatrat e Rekës së Keqe: Ponosheci, Brovina, Batusha e Morina. Luftimet për një kohë zgjerohen në Komoran, Sllatinë dhe në komunën e Rahovecit. Granatohen fshatrat Ratkoc, Radostë, Bratotin dhe Brestoc.

Më 13 maj 1998, në Ponoshec e Smolicë vriten 10 civilë shqiptarë. Derisa ato ditë po zhvilloheshin luftime të përgjakshme.

Më 15 maj 1998, Ibrahim Rugova takohet me Sllobodan Millosheviqin në Beograd.

Gjatë sulmeve në rajonin e Klinës dhe të Drenicës vriten 2 shqiptarë në Çitak dhe 4 në Stapanicë, ndërsa shkatërrohen fshatrat Zajm e Grabanicë.

Më 18 maj 1998, Serbia bllokoi depërtimin e mallrave dhe të ushqimit për popullatën civile në Kosovë.

Më 25 maj 1998, në Shushticë të Poshtme të Istogut u masakruan 9 anëtarë të familjes Salihaj.

Më 31 maj 1998, rreth orës 13.30, në afërsi të fshatit Poklek i Ri, policia dhe ushtarë e paramilitarët serbë ndërморën një sulm mbi banorët e këtyre fshatrave dhe masakruan 11 persona, 3 prej tyre nuk janë identifikuar. Përveç Ardian Haxhi Deliut (18), që është varrosur, trupat e tjerë janë bartur me një kamion policie dhe që nga ajo ditë nuk dihet asgjë për vendndodhjen e tyre. Dyshohet se personat e vrarë e të masakruar janë varrosur në ndonjë varr masiv ose janë asgjësuar, me qëllim të fshehjes së krimit.

JANAR-SHTATOR 1998

Nga janari i vitit 1998, forcat policore serbe ushtruan të gjitha format e dhunës kundër veprimtarëve shqiptarë. Rexhep Bislimi, veprimtar i NKMDLNJ në Ferizaj, dhe Cen Dugolli, vdiqën nga pasojat e përdorimit të shfrenuar të torturës nga policia gjatë hetimeve.

-Dr. Hafir Shala, aktivist i SHBH "Nëna Tereze", u arrestua nga forcat serbe më 10 prill dhe që nga ajo ditë nuk dihet asgjë për fatin e tij.

-Xhavit Haziri, veprimtar në zyrën e KMDLNJ'së në Prishtinë, është kidnapuar në Prishtinë, më 17 shtator, dhe që nga ajo ditë nuk dihet asgjë për të.

-Derisa po shpërndanin ndihma në disa fshatra të Malishevës, nga granatimet, u vranë dy veprimtarë të SHBH "Nëna Tereze": Hajriz dhe Adem Morina.

-Më 25.09.1998 Dr. Lec B. Uka u masakrua nga forcat serbe. Më 1 tetor, afër fshatit Likoc, vetura KNKK hasi në një minë me ç'rast humbi jetën dr. Shpëtim Robaj, veprimtar humanitar, ndërkaq u plagosën 3 veprimtarë të tjerë.

-Më 16 shtator, pasi ishin kthyer në shtëpitë e tyre në Dragobil dhe derisa po lëshonin bagëtinë, u rrëmbyen nga forcat serbe Osman M. Paçarizi (60) dhe Fehmi M. Paçarizi (45), u dërguan në Malishevë dhe u ekzekutuan.

-Më 25 shtator, në fshatin Galicë të komunës së Vushtrrisë, forcat serbe hynë në fshat dhe ekzekutuan 14 meshkuj, kryesisht të rinj, dhe një grua.

-Më 26 shtator, në afërsi të tunelit të Magurës, në komunën e Klinës, forcat serbe ndanë nga masa e të përndjekurve disa shqiptarë dhe, aty për aty, i ekzekutuan Smajl Millakun (72) dhe djalin e tij, Seferin (49), nga Ujmiri.

- Po atë ditë në Golluboc forcat serbe ekzekutuan 8 të rinj shqiptarë.
- Më 26 shtator 1998, në lagjen e Deliajve, në Abri të Epërme, të Glllogocit, një kilometër larg shtëpisë së tyre, forcat speciale policore serbe masakruan 23 anëtarë të familjes Deliaj, në mesin e tyre gra, fëmijë e pleq (prej moshës 1.5 vjeç deri në 94 vjeç): Sikurse mijëra shqiptarë të tjerë, që nga 25 shtatori, familja Deliaj ishte strehuar në mal, për t'u shpëtuar sulmeve shfarosëse serbe.
- Një ditë më vonë (më 26 shtator, rreth orës 10 paradite), aty kishte depërtuar këmbësoria serbe. Të shtëna armësh e britma njerëzish ishin dëgjuar pastaj... të gjithë ishin qëlluar në kokë nga afërsia dhe ishin masakruar derisa po përpiqeshin të iknin nga sulmi. Trupat e të ekzekutuarve tregonin dëshmi të qarta të një kasaphane. Luljetë Deliaj, që kishte dy muaj shtatzënë, barkun e kishte të prerë plotësisht. Pajazit Deliaj është gjetur me fyt të prerë dhe një pjesë të trurit të nxjerrë jashtë dhe të vendosur pranë tij.
- Foshnja gjashtë javëshe, Diturie Imer Deliaj, u gjet e gjallë, e tëra e mbuluar në gjak në kraharonin e së ëmës së masakruar. Kjo foshnje, që i mbijetoi masakrës, vdiq më 19 nëntor '98, si pasojë e kushteve të rënda.
- Ndërsa, më 4 tetor, pak më larg vendit të masakrës, u gjetën dy viktima të masakruara të kësaj familjeje: Antigona Hysen Deliaj (14-vjeç) dhe Mihane Hysen Deliaj (16-vjeç), të cilat para se të masakroheshin ishin dhunuar.

Burimi:

-Raporti i KMDLNJ-së, Prishtinë 1998

-Dibran Fylli, /Shënime nga ditari i luftës/, Likofc-Drenicë 1998-1999,

-“Koha ditore”, shtator 1998

QERSHOR 1998

Gjatë verës së vitit 1998 kur Forcat serbe ndëmorën një ofensivë me përmasa të gjera u vranë e u masakruan edhe qindra shqiptarë: gra, burra, pleq e fëmijë të paarmatosur.

Më 4 qershor 1998 në Poberxhë të Deçanit janë vrarë 13 shqiptarë. Më 13 korrik 1998, në Tërpezë të Ulët, Drenoc dhe Senik të Malishevës janë vrarë 11 shqiptarë. Më 18 korrik, në brezin kufitar Shqipëri-Kosovë, forcat policore e ushtarake serbe masakruan dhjetëra shqiptarë, ndër ta gra, fëmijë dhe pleq, derisa po përpiqeshin të kalonin kufirin për në Shqipëri. Ngjarja ka ndodhur përtej Rrasës së Zogut, afër tëbanave të Junikut, ku supozohet të kenë qenë afër 60 shqiptarë, ndërkaq mediat serbe, të mbështetura në burimet e armatës serbe, kanë pohuar të jenë vrarë mbi 100 shqiptarë. Numri i të plagosurve në këtë masakër ka qenë po ashtu i madh.

KORRIK 1998

Më 19 korrik, si pasojë e një sulmi të paramenduar të forcave serbe, në Rahovec pati shumë të vrarë e të plagosur. Në Teqen e Sheh Myhedinit në Rahovec janë masakruar shumë gra, fëmijë dhe pleq që kishin kërkuar strehim në këtë institucion fetar. Te vendi i quajtur “Tuba” u gjetën të masakruar dy profesorë si dhe gjashtë trupa të karbonizuar, identiteti i të cilëve nuk u mësua. KMDLNJ ka regjistruar 150 persona të vrarë. Dëshmitarët që kanë arritur t'i shpëtojnë këtij krimi tregojnë se ushtria, policia dhe paramilitarët serb kanë ekzekutuar civilë shqiptarë arbitrarisht. Gjatë kësaj ofensive u morën peng u zhdukën e u kidnapuan shumë shqiptarë, për fatin e të cilëve nuk dihet asgjë. Organet e pushtetit serb në Prizren, më 22 korrik, në varrezat e këtij qyteti hapën dy gropa të mëdha dhe varrosën shumë shqiptarë të vrarë gjatë

ofensivës në Rahovec. Më 16 gusht, derisa po iknin 13 anëtarët e familjes Asllani me traktor nga Ranca e Shtimes, u godit nga një tank serb, me ç'rast u vranë 11 anëtarë të kësaj familjeje, prej tyre 7 fëmijë të moshës 6 muaj deri 13 vjet dhe 3 gra, ndërsa 3 meshkuj të tjerë janë plagosur.

29 JANAR 1999

Masakra tjetër ndodhi më 29 janar në fshatin Rogovë të Gjakovës, ku forcat ushtarako-policore serbe vranë 26 shqiptarë. Sipas dëshmitarëve, që i kishin shpëtuar kësaj masakre, atë ditë, rreth orës 05.30, ushtarët, policët e paramilitarët serbë, pasi e kishin futur në rrethim të hekurt tërë fshatin, kanë hyrë nëpër shtëpitë e fshatit, i kanë bastisur e demoluar. Popullata, e gjendur para kësaj katrohure, kishte filluar të arratisesh në drejtime të ndryshme ose të strehohej ku mundej. Atëherë ushtarakët e paraushatarakët dhe policët serbë vranë e masakruan ata që zunë - kë mundën dhe ku mundën. Atë ditë u vranë e masakruan:

Agron dhe Sejdi Rama nga Smolica e Gjakovës,

Gëzim Ademaj nga Ratisha e Deçanit,

Agush Gjoci nga Raushiqi i Pejës,

Agim Zeneli dhe Luan Islami nga Shqiponja e Dushkajës,

Sahit Krasniqi nga Ratkoci i Përdrinit,

Daut Zagraxha nga Banja e Burimit,

Haxhi Lipjani nga Kleçka e Malishevës,

Valon Gashi nga Buçani i Pejës,

Vesel Avdyli nga Drenoci i Klinës,

Emrush Çeta nga Turbovci i Burimit,

Bahtjar Morina nga Lubizhda e Malishevës dhe

Naim Dreshaj nga Vrella e Burimit. Që të gjithë ishin uishtarë nga Zona Operative e Dukagjinit dhe ajo e Pashtrikut.

JANAR-MARS 1999

Eskalimi i dhunës serbe me përmasa më të gjera në Kosovë filloi menjëherë pas marrëveshjes së të deleguarit special të Presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës Riçard Holbruk e presidentit të Jugosllavisë së mbetur - Serbi e Mali i Zi Slllobodan Millosheviq, në tetor të vitit 1998 dhe ardhjes në Kosovë të Komisionit Verifikues të Organizatës për Siguri e Bashkëpunim në Evropë. Që në fillim të vitit 1999 forcat ushtarako-policore serbe hapën një front të gjerë 25 km në rajonin e Llapit - prej Lupçit të Poshtëm e deri në Peran të Podujevës. Këto fshatra sulmoheshin për çdo ditë me tanke, artileri të rëndë, raketa tokë-tokë e armë të tjera. Si pasojë e këtyre sulmeve të forcave serbe 45 mijë qytetarë shqiptarë janë detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre.

Gjatë muajve janar - mars 1999 nga Serbia në Kosovë kanë hyrë forca të shumta të ushtrisë, të policisë e të paramilitarëve serbë dhe armatim i rëndë i luftës. Në shumë rajone të Kosovës është bërë mobilizimi i përgjithshëm dhe armatosja në masë e civilëve serbë, të cilët kanë marrë pjesë aktive në veprimet ushtarako-policore kundër shqiptarëve dhe vendbanimeve të tyre. Njësitet e ushtrisë jugosllave kanë minuar rrugë dhe ura kaluese, siç ishte ajo Prishtinë - Shkup, afër Kaçanikut, në drejtim të Hanit të Elezit, kurse në tërë Kosovën kanë provokuar incidente për të ndërmarrë aksione terroriste kundër popullsisë civile shqiptare për ta detyruar atë t'i braktisë shtëpitë e veta, të cilat paramilitarët serbë, por edhe forcat policore e ushtarake serbe e serbët dhe romët civilë pastaj i kanë plaçkitur, rrënuar e djegur. Kështu, më 19 janar, pas incidentit që kishte ndodhur afër "Urës së Gjakut" në Mitrovicë, forcat serbe kanë filluar një sulm përmasash të gjera ndaj lagjeve të Mitrovicës "Ura e Gjakut" dhe "Bair", paralagjes Shipol dhe fshatrave Vaganicë e Poshtme dhe Vaganicë e Epërme.

Gjatë këtij aksioni janë vrarë dy shqiptarë, ndërsa janë arrestuar e keqtrajtuar në forma të ndryshme e zhdukur qindra të tjerë.

Në muajin Janar 1999 janë kryer tri raste të ekzekutimit në masë të shqiptarëve nga eskadronët e vdekjes të varmihësit Sllobodan Millosheviq, në Reçak, Rakovinë dhe në Rogovë të Hasit. Më 15 janar 1999 në Reçak të Shtimjes u vranë e u masakruan mizorisht 45 shqiptarë. Masakra e Rakovinës ndodhi më 24 janar, rreth orës 21.00, në afërsi të urës së Rakovinës në rrugën magjistrale Prishtinë - Gjakovë. Policia serbe, pa asnjë pretekst, shtiu me armë automatike nga autobllinda dhe vrau Shaban T. Kelmendin (45) dhe fëmijët e tij Haxhiun (11) e Besimin (12) nga Rakovina dhe Hysen e Sanije Kurtin (30) nga Cërmjani, që ishin mysafirë të Shabanit dhe po ktheheshin me traktor në Cërmjan.



Burimi:

-Human Rights Watch / Trupat e viktimave - dëshmi të qarta të kasaphanës /
Gazeta "Koha Ditore", 30.9.1998,

-QIK - Qendra për Informim e Kosovës, Informatori ditor nr. 2198 D, Prishtinë, 1 tetor 1998,

-Human Rights Watch / Një javë e terrorit në Drenicë / shkurt 1999,

-Human RightsWatch / Nën pushtetin e urdhrave /- Krimet e luftës në Kosovë, tetor 2002,

-KMLDNJ, Raport mbi shkeljen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Kosovë gjatë muajit shtator 1998,

RAPORT I KMDLNJ-së
(25.03-21.05.1999)

- Më 25 mars 1999, në Goden të Gjakovës u vranë 20 shqiptarë.
- Më 25 mars 1999, në Milloshevë të Prishtinës u vranë 4 shqiptarë.
- Më 26 mars 1999, në Padalishtë të Burimit (ish-Istogut) u vranë 19 shqiptarë.
- Më 26 mars 1999, në Landovicë të Prizrenit u vranë 17 shqiptarë,
- Më 27 mars 1999, në Lagjen Dardania të Pejës u vranë 44 shqiptarë.
- Më 27 mars 1999, 7 shqiptarë janë vrarë e masakruar në Mamushë të Prizrenit.
- Më 27 mars 1999, në Dardhishtë të Obiliqit u vranë 10 shqiptarë.
- Më 28 mars 1999, në fshatin Izbicë të Skënderajt forcat serbe kanë vrarë e masakruar 158 shqiptarë. Njëri nga burrat e këtij fshati, që i kishte shpëtuar kësaj masakre, ka deklaruar se ushtarët serbë janë futur në fshat, i kanë ndarë burrat nga gratë e fëmijët dhe i kanë detyruar të rreshtohen për tre, pastaj kanë filluar t'i gjuajnë me pushkë automatike.
“Kur serbët filluan të shtien, - tregon i tronditur ky fshatar - rashë në tokë duke u shtirë se jam i vdekur. Kur janë larguar serbët, ngadalë jam zvarritur barkas drejt malit dhe jam lëshuar poshtë nëpër shkurre. Të gjithë fshatarët e mi, që kishin mbetur në atë luginë, ishin vrarë e masakruar”.
- Më 28 mars 1999, forcat serbe në Besianë (ish- Podujevë) masakruan anëtarët e familjes Bogujevci (6 anëtarë); të familjes Duriqi (9 anëtarë), prej tyre 4 fëmijë.
- Një ditë më vonë, më 29 mars, në Potërq të Klinës janë vrarë dhe masakruar 14 shqiptarë, ndërsa më 29 e 30 mars 1999, në Beleg të Deçanit u vranë 27 shqiptarë.
- Më 31 mars 1999, në Pastasellë të Rahovecit janë vrarë dhe

masakruar 106 shqiptarë.

-Më 31 mars 1999, në Burim të Malishevës janë vranë 33 shqiptarë.

-Më 1 prill 1999, në fshatin Lybeniq të Pejës janë vranë dhe masakruar 59 shqiptarë. Të ekzekutuarve, para se të ekzekutoheshin, u janë hequr rrobat.


-Më 2 prill 1999, në Kçiq të Madh të Mitrovicës u vranë 7 shqiptarë.

-Më 7 prill 1999, në Bjeshkët e Lybeniqit u vranë dhe u masakruan 21 shqiptarë.

-Më 24 prill 1999, në Nagavc të Rahovecit u vranë 24 civilë shqiptarë të paarmatosur.

-Më 6 maj 1999, në fshatin Shtupel të Klinës, në familjen Zhabota e Qallapeku, keqtrajtohen të gjithë anëtarët e këtyre familjeve, ku kishte edhe dhunime e më pas i vrasin 6 civil dhe i plagosin 7.

-Më 14 maj 1999, në tri fshatra të Pejës: Qyshk, Zahaq dhe Pavlan janë vranë, masakruar dhe djegur 72 shqiptarë.



Kallëzim penal

Trupi i karbonizuar i Fetijë Zhabotes 9Maj 1999)

Burimi:

- KMLDNJ, Raport mbi shkeljen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Kosovë gjatë muajit mars-maj 1999,
- CIK-Informatori ditor nr. 2198 D, Prishtinë,

MARS 1999

Eskalimi eklatant i terrorit shtetëror serb arriti kulminacionin e vet gjatë ditëve kur lufta çlirimtare e popullit të Kosovës, të prirë nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, po çonte drejt zgjidhjes së çështjes së Kosovës dhe në prag e gjatë ndërhyrjes së drejtpërdrejtë ndërkombëtare për zgjidhjen e krizës në Kosovë në shkurt dhe në mars të vitit 1999, sidomos me largimin e Misionit Verifikues të Organizatës për Siguri e Bashkëpunim në Evropë dhe të institucioneve të tjera ndërkombëtare që, në një numër të konsiderueshëm, ishin prezentë në Kosovë deri më 20 mars 1999. Atëherë regjimi serb e tregoi haptazi fytyrën e vet të vërtetë dhe qëllimin e qartë gjenocidal për spastrimin etnik të Kosovës dhe për zhdukjen e shqiptarëve nga këto troje. Ditën e largimit definitiv të përfaqësuesve ndërkombëtarë nga Kosova, më 20 mars 1999, vetëm në Skënderaj forcat paramilitare dhe ushtarako-policore serbe arrestuan me qindra dhe ekzekutuan 30 shqiptarë të Drenicës. Ndërkaq, më 24 mars 1999, rreth orës 17.15, kur tashmë ishte shpallur ndërhyrja e NATO's, por ende pa filluar bombardimet e caqeve në Jugosllavi e në Kosovë, forcat serbe, në Kolinë të Kaçanikut, ekzekutuan 22 shqiptarë dhe i hodhën në një gropë të thellë, për t'i fshehur gjurmët e krimit.

Menjëherë pas fillimit të bombardimeve të NATO's dhuna dhe terrori i forcave serbe ndaj shqiptarëve të paarmatosur u intensifikua, duke marrë përmasa të një gjenocidi. Natën midis 24 e 25 marsit 1999, kur bombardimet e NATO-s tashmë kishin filluar, pjesëtarët e njësisë speciale të policisë serbe në Prishtinë arrestuan në shtëpinë e tij avokatin Bajram Kelmendi, anëtar i Kryesisë së Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut në Prishtinë, dhe dy djemtë e tij - Kastriotin student dhe Kushtrimin nxënës, të cilët po atë natë i vranë dhe i masakruan.

Midis 24 e 25 marsit 1999, kriminelët serbë vranë e masakruan në Mitrovicë edhe poetin Latif Berisha, profesor i Universitetit të Prishtinës dhe kryetar i Degës së Lidhjes Demokratike të Kosovës në Mitrovicë, veprimtarin e shquar Agim Hajrizi, kryetar i Kuvendit të Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës me të birin dhe të ëmën, dhe veprimtarin Enver Haliti.

Më 25 mars 1999, forcat Serbe rrethuan dhe sulmuan fshatin Bellacërkë në komunën e Rahovecit. Shumë banorë të Bellacërkës ikën gjatë lumit Belaja jashtë fshatit dhe u detyruan të kërkonin strehim afër një ure hekurudhore. Derisa forcat serbe i afroheshin urës, ata hapën zjarr kundër një numri fshatarësh, duke vrarë 12 veta, 10 prej tyre gra dhe fëmijë. Një fëmijë dyvjeçare mbeti gjallë pas këtij incidenti. Forcat e shumta serbe pastaj urdhëruan fshatarët e tjerë të dilnin nga shtrati i përroit. Në këtë moment burrat dhe djemtë më të mëdhenj u ndanë nga pleqtë, gratë dhe fëmijët e vegjël. Grave dhe fëmijëve pastaj u dhanë urdhër për t'u larguar drejt një fshati të afërt, të quajtur Xërxë. Një mjek nga Bellacërka u përpoq të fliste me një komandant të forcave sulmuese, por ai u vra me armë zjarri, si edhe nipi i tij. Burrave dhe djemve më të mëdhenj të tjerë pastaj u është dhënë urdhri të ktheheshin në shtratin e përroit. Pasi zbatuan urdhrin, u hap zjarr kundër këtyre burrave dhe djemve më të mëdhenj, duke vrarë rreth 65 prej tyre. Për më tepër, forcat serbe vranë edhe gjashtë burra të cilët i gjetën, të fshehur në një kanal vaditës.

Burimi:

-KMLDNJ, Raport mbi shkeljen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Kosovë gjatë muajit mars 1999,
-Human Rights Watch, /Nën pushtetin e urdhrave/- Krimet e luftës në Kosovë,

MARS 1999

Më 25-27 mars 1999 në Krushë të Madhe të Rahovecit u vranë dhe u masakruan 241 shqiptarë, ndërkaq më 26 mars 1999, në Krushë të Vogël, janë vranë dhe masakruar 116 shqiptarë. Në fshatin Celinë të Rahovecit, më 25 e 26 mars 1999, forcat serbe vranë dhe u masakruan 82 banorë të këtij fshati - 11 fëmijë të moshës 2-4 vjeçare, 6 vajza të rritura, 7 gra dhe 58 burra.

Më 26 mars 1999, në orët e hershme të mëngjesit, forcat serbe e rrethuan afërsinë e oborrit të familjes Berisha në Suharekë.

U vunë në pozitë tanket, të drejtuara kundër shtëpive. U urdhëruan banorët të dilnin nga shtëpitë. U ndanë burrat nga gratë dhe fëmijët dhe u vranë gjashtë anëtarë të familjes. Forcat serbe përçuan anëtarët e tjerë në drejtim të një kafeneje. Këta anëtarë u futën në kafene, bashkë me tri grupe të familjes së gjerë të Berishëve. Pastaj forcat serbe hynë në kafene dhe hapën zjarr kundër njerëzve aty brenda. U hodhën edhe eksplozive në kafene. Me këtë rast 35 civilë u vranë në këtë aksion dhe u plagosën rëndë edhe të tjerë. Kufomat e viktimave u tërhoqën zvarrë prej kafenesë dhe u vendosën në platformën e një kamioni, i cili pastaj u nis në drejtim të Prizrenit. Tre individë të plagosur, të cilët u hodhën në kamion bashkë me kufomat, kërcyen prej kamionit gjatë rrugës për në Prizren. Plaçka që u takonin së paku gjashtë prej personave të vranë në kafene janë gjetur në një vendvarrim masiv të fshehur në një poligon të UJ-së afër Korishës. Për më tepër, dokumentet personale që u takonin së paku pesë prej personave që u vranë në kafene janë gjetur në kufomat që u zhvarrosën prej një varri masiv të fshehur në Batajnicë afër Beogradit në Serbi

Burimi:

-KMLDNJ, Raport Pë krimet serbe në Kosovë gjatë muajit mars 1999,

-Human Rights Watch, /Nën pushtetin e urdhrave/- Krimet e luftës në Kosovë,

PRILL 1999

Më 2-4 prill 1999 në Volljakë të Klinës u vranë dhe u masakruan 16 shqiptarë, ndërkaq më 4 prill në Kralan u vranë 20 shqiptarë të tjerë. Nga familja Bobi e Devës u vranë e u masakruan 7 anëtarë, 6 anëtarë të familjes Dinaj nga Hereçi, 3 familje me mbiemrin Osmanaj nga Godeni me 8 anëtarë, familja Morina 6, Feraj 6 dhe familja Thaçi nga Demjani 3 anëtarë.

-Më 5 prill 1999 në Llapçevë të Malishevës janë vranë 7 shqiptarë. Po këtë ditë në Rrezallë të Skënderajt u vranë pa mëshirë 80 shqiptarë.

-Më 7 prill 1999 në Çabiq të Klinës u vranë 10 shqiptarë.

-Më 9 prill 1999 në Kaçanik të Vjetër u vranë 25 shqiptarë të tjerë.

-Më 12 prill 1999 në fshatrat Negroc e Tërstenik të Drenasit u vranë 21 shqiptarë civil.

-Më 13 prill 1999, forcat serbe rrethuan fshatin Sllatinë dhe lagjen e Vatës. Pasi granatuan fshatin, trupat e këmbësorisë dhe ato policore hynë në fshat dhe plaçkitën dhe dogjën shtëpitë. Gjatë këtij aksioni, 13 civilë janë vranë me armë zjarri.

-Njësi i policisë serbe kishte hyrë në fshatin Kodrali, sipas dëshmitarëve okularë, më 13 prill të vitit 1999, në mes të orës 13 dhe 14, në fshatin Kodrali, ka pasuar një ndërhyrje brutale e policisë serbe të MUP-it të Deçanit, përkatësisht e policëve serbë të punktimit policor të Irzniqit, me ç'rast janë rrëmbyer nga forcat serbe tetë burra të fshatit Kodrali:

Nijazi (Avdi) Ferizaj (1935), profesor i gjuhës angleze, njëherit drejtor i Gjimnazit “Vëllezërit Frashëri” në Deçan, Shaqë (Avdi) Ferizaj (1930), rapsod i njohur i kësaj treve, Ismet (Zekë) Ferizaj (1955), Bylbyl (Jahë) Ferizaj (1962), Bashkim (Ibish) Ferizaj (1964), Skënder (Haxhi) Ferizaj (1956), Ramadan Ferizaj, Halit Ferizaj dhe Isë (Kadri) Hasaj.

Diku rreth orës 13, sipas dëshmitarëve, policia serbe kishte hyrë në shtëpinë e Isë Kadrisë (Hasaj), të cilin e marrin me vete dhe e nisin në drejtim të lagjes Pepaj, duke i rënë për mjedis fshatit. Njëri nga dëshmitarët okularë, Muhamet Ferizaj, të cilit me këtë rast i janë rrëmbyer nga policia serbe vëllai Ismeti dhe djali i axhës Bylyli, kishte shpëtuar vetëm në saje të fatit. Vetëm pesë minuta e kishin ndarë nga vëllezërit e kushërinjtë që më pas u rrëmbyen dhe u masakruan, kur kishte shkuar në shtëpi për të marrë një palë pantallona. *“Në orën 13.05 minuta, unë kam qenë në fshat, isha në oborrin e Ali Ademit (Ferizaj), kurse policia serbe kishin hyrë në oborr të Hajdar Pepajt. Së pari ka ardhur “Landroveri” dhe është ndalur në oborrin e shtëpisë së Hazir Pepajt. Në “Landrover” ka pasë policë serbë të uniformuar. Rreth njëzet policë kanë ardhur me tri makina, një “Landrover”, një “Nivë” dhe një kamion të tipit “Zastava” me mbulojë të lul's (të verdhë) me regjistrim të Gjakovës. Kamioni është ndalur në rrugën para shtëpisë së Bajram Pepajt, ndërsa “landroveri” dhe “niva” kanë hyrë në oborr të Hajdarit. “Landroveri” i ka ra “zastojës” dhe e ka thyer pa problem. Pas kësaj kanë dalë policët. Isë Kadria, 70-vjeç, ka qenë i lidhur me duar lartë në kamion. Personat që më pas janë rrëmbyer (në momentin e rrëmbimit të gjithë ishin të pauniformuar e të paarmatosur) i ka rrethuar policia serbe prapa shtëpisë së Rexhep Pepajt. Këta kanë nisë të ikin teposhtë fshatit, por në atë moment policët serbë kanë gjuajtur me një mjet shpërthyes në ajër. Aty kanë qenë telat me xhembra të rrethojës dhe nuk kanë mundur të kalojnë prej tyre. Kanë mbetur në tela, nuk kanë mundur të ikin. Aty të gjithë i ka zënë të gjallë policia serbe”, rrëfen Muhameti.*

Burimi:

-Shënimet dhe dëshmitë e Muhamet Ferizajt, dëshmitar i ngjarjes tragjike në fshatin Kodrali
-Fitnete Ramosaj - /Krimet serbe në Kosovë, Pa apologji-2/, Prishtinë,

PRILL 1999

- Nga 14 - 16 prill 1999 në Mitrovicë janë ekzekutuar 10 shqiptarë.
- Më 15 prill 1999, në Sllovi të Lipjanit, janë masakruar 18 civilë shqiptarë, kurse më 16 prill te vendi i quajtur “Lugu i Demës”, janë masakruar edhe 17 shqiptarë të tjerë, kryesisht nga fshati Sllovi. Dëshmitarët thonë se këta civilë shqiptarë janë ekzekutuar nga formacioni ushtarak dhe paramilitar i kriminelit Toshiq.
- Më 15 e 16 prill në Zhegovc të Gjilanit janë vranë 8 shqiptarë.
- Më 16 prill në Skënderaj janë vranë 13 shqiptarë. Po atë ditë në Gllanasellë të Drenasit u vranë 22 shqiptarë.
- Prej 17 prillit deri më 2 maj 1999, në Çikatovë të Vjetër dhe Poklek të Vjetër u vranë 132 shqiptarë.
- Më 18 prill 1999, nga forcat serbe në familjen e Rexhep Vishe-sellës së Ribarit të Vogël u vranë e u masakruan 13 anëtarë.
- Në Hallaç ishin masakruar së paku 23 shqiptarë, kurse në Ribar të Vogël 19. Të vranë kishte edhe në Kraishtë e në fshatrat e tjera të sulmuara. Kurse mbi 10 mijë shqiptarë të këtyre fshatrave kishin ikur e ishin strehuar nëpër malet e Varigocit e të Zborcit, ku për disa kohë mbetën nën qiellin e hapët - pa ushqime dhe gjëra tjera.
- Më 18 prill 1999, në Bërnice të Epërme të Prishtinës, është masakruar familja 7 anëtarësh Reka, ndërsa po të njëjtën ditë në fshatin Hade të Obiliqit, janë vranë 5 shqiptarë.
- Nga 18 - 25 prill 1999 në Prishtinë në masakrën e Makocit janë vranë 55 shqiptarë, ndërkaq më 18 - 19 prill 1999 në Marec të Prishtinës u vranë 16 shqiptarë.
- Më 25 prill 1999 në fshatin Mazrek të Hasit (Prizren) janë vranë 10 shqiptarë.
- Më 26 prill u vranë 12 shqiptarë në fshatrat Planejë e Gorozhup të kësaj treve të Prizrenit.
- Më 27 prill 1999 në fshatin Mejë të Gjakovës janë masakruar

pamëshirshëm 377 shqiptarë. Në komunën e Gjakovës janë të rrëmbyer 756 persona civil, prej tyre 586 janë të komunës së Gjakovës, gjersa 179 janë të komunave tjera.

-Ndërsa gjatë viteve 1998-1999 në komunën e Gjakovës janë vranë 752 shqiptarë.

-Më 29 prill 1999 në Dardhishtë të Obiliqit u vranë 4 shqiptarë.

-Më 30 prill 1999 në Llashticë të Gjilanit u vranë 13 shqiptarë, ndërsa nga 30 prilli deri më 3 maj 1999 në Vërbovc të Drenasit u vranë 90 shqiptarë.

-Më 30 prill 1999 në fshatin Shtuticë të Drenasit u vranë 30 civil shqiptarë, ndërsa në fshatin Baks 11 shiptarë të tjerë.

MARS-QERSHOR 1999

Më 27 mars 1999, forcat ushtarake serbe filluan të digjinin shtëpi në qytetin e Vushtrrisë.

-Më 2 maj 1999 këto forca serbe sulmuan një numër fshatrash në verilindje të qytetit të Vushtrrisë, duke përfshirë fshatrat Skromë, Sllakofc, Ceceli dhe Studime e Epërme. Me këtë rast fshatarët u dëbuan nga shtëpitë e tyre dhe shumë shtëpi, dyqane dhe objekte fetare u dogjën plotësisht. Fshatarët, bashkë me njerëz të zhvendosur më parë nga vendbanime të tjera në komunën e Vushtrrisë, u detyruan të formonin një kolonë prej rreth 20,000 njerëzish që udhëtonin në rrugën e Grykës së Studimes, në drejtim të qytetit të Vushtrrisë.

-Gjatë natës së datave 2-3 maj 1999, forcat serbe përndoqën, rrahën dhe vranë afërsisht 104 shqiptarë dhe u vodhën artikuj me vlerë shumë të tjerëve. Mijëra shqiptarë në këtë kolonë u ndaluan

Burimi:

-Human Rights Watch / Nën pushtetin e urdhrave /- Krimet e luftës në Kosovë,

-KMLDNJ, Raport mbi shkëlqjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Kosovë 1998-1999

-Zëri, /Krimet serbe në Kosovë/, e premte, 31 maj 2002

në kooperativën bujqësore afër qytetit të Vushtrrisë, dhe më 3 maj 1999 në kooperativën bujqësore i ndanë burrat të moshës madhore nga gratë, fëmijët dhe pleqtë. Gratë, fëmijët dhe pleqtë u udhëzuan të shkonin në Shqipëri dhe një numër burrash u detyruan të ngitnin automjete nga kooperativa bujqësore në një burg në fshatin Smrekonicë. Pas disa javësh burgimi në kushte çnjerëzore, ku iu nënshtruan rrahjeve, torturës dhe vrasjeve, shumë nga këta burra u transportuan në fshatin Zhur, afër kufirit me Shqipërinë dhe u detyruan të kalonin në Shqipëri.

-Më 3 maj 1999 në fshatin Bukosh të Therandës janë vranë 23 shqiptarë.

-Më 4 maj 1999 në Damanek të Malishevës u vranë 5 shqiptarë.

-Më 13 maj 1999 në Fushë të Pejës u vranë 12 shqiptarë, ndërsa 77 në Korishë të Prizrenit (nga bombardimet e NATO's).

-Nga 16 maji 1999, nuk dihet për fatin dhe vendndodhjen e aktivistit, atdhetarit Ukshin Hoti.

-Më 16 e 17 maj 1999 në Ticë të Skënderajt janë vranë 10 shqiptarë.

-Më 17 maj 1999 u vranë 18 shqiptarë në Carallukë të Malishevës.

-Më 19 - 22 maj 1999, në Burgun e Dubravës nga forcat policore, gardianët dhe kriminelët serbë ish të burgosur, u vranë mbi 177 të burgosur shqiptarë.

-Më 21 maj 1999, fshati Stagovë u rrethua nga forcat serbe, derisa popullata u përpoq të ikte drejt maleve në lindje të fshatit. Gjatë këtij aksioni, 12 persona u vranë. Pjesa më e madhe e fshatit u plaçkit dhe u dogj.

-Më 22 maj 1999, në Vushtri janë vranë dhe masakruar 68 civil shqiptarë.

-Më 25 maj 1999, forcat serbe rrethuan fshatin Lisnajë. Derisa forcat hynin në fshat, popullatës i është dhënë urdhri që të mblidhej në shkollë dhe të largohej nga fshati me traktorë. Pastaj u ndanë burrat nga gratë dhe fëmijët. Gjatë këtij aksioni, janë vranë katër

burra. Katër anëtarë të familjes Qorri u vranë në përpjekje për të ikur drejt pyjeve.

-Më 26 maj 1999, në lagjen Tusus të Prizrenit u vranë 26 shqiptarë.

-Në qershor 1999, KMDLNJ ka evidentuar tri raste në të cilat janë vranë nga 12 shqiptarë.

-Më 1 qershor 1999, në Javor të Malishevës u vranë 4 shqiptarë.

-Më 8 qershor 1999 në Zhabar të Mitrovicës u vranë 4 shqiptarë.

-Më 9 qershor në Mitrovicë gjithashtu u vranë 4 civil shqiptarë.



Formacionet luftarake policore serbe gjatë një aksioni shfarosës kundër popullatës civile shqiptare në Kosovë

Burimi:

-Human Rights Watch / Nën pushtetin e urdhrave /- Krimet e luftës në Kosovë,

-KMDLNJ, Raport mbi shkeljen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Kosovë 1998/1999/2000

-KMDLNJ - Monografi 1, /Krimet e Luftës në Kosovë 1998 - 1999/

**ORGANIZATAT E HUAJA
PËR KRIMET SERBE NË KOSOVË**



**United Nations
Human Rights**

OSCE

Organization for Security and
Co-operation in Europe
OSCE Mission in Kosovo



American Association for the
Advancement of Science



**HUMAN
RIGHTS
WATCH**

WORLD REPORT

1998/1999



**United Nations
Nations Unies**



**International Criminal Tribunal
for the former Yugoslavia**

BURGOSJET DHE KIDNAPIMET

As Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (10 qershor 1999) e as Marrëveshja Ushtarako-Teknike e përfaqësuesve të forcave të NATO-s dhe të Ushtrisë Jugosllave më 9 qershor 1999 nuk kanë paraparë asgjë për fatin e të burgosurve shqiptarë në burgjet serbe. Kjo i mundësoi regjimit të Beogradit të mbajë peng në kazamatet e veta rreth 7000 shqiptarë të burgosur e të kidnapuar në mënyra të ndryshme. Ndërkohë, gjendja e shqiptarëve të burgosur në burgjet e Serbisë është shumë e rëndë.

Të burgosurit shqiptarë në këto burgje në Nish, Pozharevc, Leskovc, Prokuplc, Vranjë, Mitrovicë të Sremit etj., çdo ditë u nënshtrohen torturave më të rënda dhe ballafaqohen me vdekjen. Ata në këto burgje ju jepnin shumë pak ushqim të dobët, nuk merrnin ilaçe më të nevojshme e nuk kishin as përkujdesje minimale mjekësore. Ata keqtrajtoheshin në mënyra të ndryshme jo vetëm nga gardianët e burgut e policët, por edhe nga të burgosurit serbë dezertorë e kriminelë ordinarë.

Më 11 gusht 1999 janë sjellë në Kosovë trupat e të burgosurve shqiptarë Sali Kurtaj (48) nga Gjilani e Tefik Saliu (1926) nga Ferizaj - të vrarë ditë më parë në Burgun e Beogradit. Në burgun e Prokuples (Serbi) ka vdekur Muhamet Basha (66) nga Vraniqi, e nga burgu i Mitrovicës së Sremit është sjellë i vdekur Sadik Jahir Agushi (1958) nga Drenoci i Klinës. Nga pasojat e torturave në burgjet serbe vdiq Zeqë Adem Hasaj (1953) nga Kodralia e Deçanit i liruar nga burgu i Zajëçarit (Serbi).

Burimi:

-Patrick Ball, AAAS, "Arratia e shqiptarëve etnikë nga Kosova, mars-maj 1999"

SPASTRIMI ETNIK

Populli i Kosovës, krahas torturave, vrasjeve, ekzekutimeve, masakrave, rrëtimeve, djegieve e plaçkitjeve të shtëpive e të pasurisë së tij, përjetoj edhe dëbimin me dhunë, zhvendosjen dhe depërtimin masiv nga vatrat e veta dhe pastrimin etnik të Kosovës - masën më të rreptë të gjenocidit serb mbi shqiptarët. Sipas një studimi "Arratia e Shqiptarëve Etnikë nga Kosova Mars - Maj 1999" të bërë nga Shoqata Amerikane për Përparimin e Shkencës AAAS që drejtonte zëvendësdrejtori Patrick Ball, vërshimi i refugjatëve nga Kosova u krye në tri faza krejt të dallueshme.

Në fillim të çdo faze, rrjedha e refugjatëve ishte relativisht e pakët. Më pas numri i refugjatëve që largoheshin nga Kosova gjatë mesit të fazës arrinte një pikë relativisht të lartë (*një kulm, një grup kulm ose një nivel të lartë konstant*), para se të zvogëlohej në fund të fazës.

Gjatë fazës së parë (24 mars-6 prill 1999) shumica e refugjatëve erdhën nga Kosova perëndimore dhe jugperëndimore.

Në fazën e dytë (7-23 prill) shumica e refugjatëve lanë shtëpitë e tyre në bashkitë në veri dhe në qendër të Kosovës.

Gjatë fazës së fundit (24 prill - 11 maj), refugjatët erdhën kryesisht nga bashkitë e Kosovës perëndimore dhe jugore.

Burimi:

-Patrick Ball, AAAS, "Arratia e shqiptarëve etnikë nga Kosova, mars-maj 1999"

-Gazeta e përditshme shqiptare "Fakti", Shkup, 12 maj 1999,

DHUNIMET

Gjatë luftës së përgjakshme në Kosovë 1998 - 1999, janë dhunuar e vrarë mizorisht mijëra femra shqiptare. Në një raport për krimet dhe gjenocidin serb në Kosovë, të publikuar nga OSBE në maj të vitit 1999, thuhet se janë grumbulluar mbi 1400 dëshmi për krime lufte e dhunime në Kosovë. Dëshmitë janë grumbulluar nga gratë dhe vajzat e reja shqiptare, të cilat rrëfejnë për veten e tyre (anonime) apo për shoqet e tyre dhe të afërmet që kanë përjetuar dhunimin nga pjesëtarët e forcave serbe. Rrëfimet janë shumë tronditëse dhe skajshmërisht të dhimbshme. Ndërkaq, në një raport të Fondit Ndërkombëtar të OKB-së për Popujt e Rrezikuar (FNUAP) i publikuar më 25 maj 1999, në Gjenevë, ndër të tjera thuhet: “Ushtarët serbë për çdo ditë ngarkonin me kamionë nga 30-50 femra të reja shqiptare, të cilat i dërgonin në drejtime të panjohura, ku i dhunonin për disa ditë me radhë në ndërtesa ushtarake apo vendbanime të tjera të ushtarëve serbë. - Nëse ato refuzonin marrëdhëniet seksuale me ushtarët dhe eprorët serbë, i vrisnin ose i digjin në prezencën e të tjerave, për t'i frikësuar dhe nënshtruar më lehtë femrat tjera”. Komisionerja e OKB për të Drejtat e Njeriut, Mery Robinson, në raportin e saj përkitazi me dhunimet që kanë kryer forcat serbe gjatë luftës në Kosovë thotë: *“Dhunimet e femrave shqiptare në shumë qendra të Kosovës janë kryer kryesisht nga paramilitarët e Arkanit dhe nga policët shtetërorë serbë”*.

Ekspertja e Human Rights Watch-it, Martina Vandenberg, në raportin prej 37 faqesh të HRW-së, të publikuar më 21 mars 2000, ku përshkruhen rastet e dhunimeve të femrave në Kosovë, në bazë të dëshmive të shumta konstaton se “forcat e armatosura të Jugosllavisë dhe të Serbisë janë përgjegjëse direkte për dhunimin sistematik të grave dhe të vajzave shqiptare në Kosovë gjatë

sulmeve ajrore të NATO-s". Në shumicën dërmuese të rasteve, viktimat, para se të ekzekutoheshin, ishin objekt i shfrimit shtazarak, i rrahjeve, i torturave nga më të egrat, i dhunimit seksual, i fyerjeve dhe i poshtërimit moral e pastaj edhe i ekzekutimit e masakrimit në format më barbare. Përveç femrave të dhunuara dhe atyre të vrara ekziston edhe një numër i madh i atyre që konsiderohen të zhdukura.

Viktimat e dhunimit kanë të përbashkët një histori të njëjtë tronditëse dhe shumë të dhimbshme dhe të gjitha së bashku përbëjnë një kategori shumë fatkeqe të viktimave. Të mbijetuarat dëshmojnë se një numër i vajzave shqiptare që konsiderohen të zhdukura, pas përdhunimit janë dërguar në Serbi. Pas dhunimit, vajzat e reja i transferonin në Serbi.

Ushtarakët serbë kishin ngritur një infrastrukturë të tërë për të siguruar gjahun e seksit për taborët e Arkanit. Kjo e vërtetë tronditëse që vjen nga rrëfimet e viktimave të barbarisë së shfrenuar serbe në Kosovë është një tragjedi më vete. Në të gjitha dëshmitë e viktimave të dhunës seksuale në Kosovë, veçohet fakti që asnjë prej vajzave të çuara forcërisht në Serbi gjatë ditëve të luftës në Kosovës, nuk është rikthyer pranë familjes. Ka të dhëna se bashkë me përfundimin e operacioneve të NATO-s, që gjunjëzoi përfundimisht ushtrinë kriminale të Millosheviqit, pjesa më e madhe e tyre u zhdukën e u vranë në kushte misterioze.

Gjithsesi, deri më sot, asnjë organizëm ndërkombëtar nuk është interesuar për të nisur hulumtimin rreth fatit të këtyre vajzave që kanë humbur pa adresë. Janë vetëm familjarët e tyre që rendin e rendin pa shpresë për të mësuar diçka për atë që ka ndodhur me to. Rrëfimet e atyre që përjetuan tmerrin janë tronditëse: *Ne që jemi dhunuar dhe sot vuajmë jemi morali dhe pamorali i të gjithë kosovarëve! Edhe kur jemi në mesin e të gjallëve, ne, sërish ndjehemi të vdekura! Edhe kur ecim rrugës, e ndjejmë peshën e*

dhunimit, e shohim atë në sytë e njerëzve, të cilët, ndoshta, kurrë nuk do të mund ta imagjinojnë se çfarë kemi përjetuar. Ne jemi plaga e çdo njeriu, vuajtja dhe mungesa e çdo fëmije. Edhe kur njerëzit qeshin, pa kujtuar fare se ne ekzistojmë, ne mendojmë se ata qeshin dhe tallen me tragjedinë tonë. Edhe kur lotojnë, shajnë e pështyjnë edhe atëherë ne jemi pjesa më e dhembshme dhe më tragjike... Ne sot jemi të braktisura, dhe pesha e çdo gjëje që po ndërtohet në Kosovë rëndon mbi ne! Ne jemi gjaku, pluhuri dhe pështyma e djeshme, e sotme dhe e nesërme e Kosovës andaj dikush duhet ta ngre zërin për ne... Deri në vitin 2004, janë evidentuar 46 vetëvrasje të femrave të përdhunuar gjatë luftës, që kanë ndodhur si pasojë e krizave nervore e psikike.

Ekspertët e Tribunalit të Hagës qysh gjatë ditëve të luftës u prononcuan se aktet e dhunës seksuale trajtohen në kuadër të juridiksionit të ICTY-së (Tribunali Ndërkombëtar për Krime Luftë në ish-Jugosllavi) dhe se aktet e dhunimit specifikohen si krime kundër njerëzimit, gjenocid, shkelje të ligjeve të luftës, torturë, etj., duke potencuar se Tribunali i Hagës e ka zgjeruar juridiksionin e vet për hetimin e abuzimeve seksuale të kryera nga forcat e armatosura serbe mbi popullatën civile shqiptare gjatë luftës në Kosovë. Por, ashtu siç nuk u trajtuan në mënyrën e duhur gjenocidi e krimet e tmerrshme që kryen forcat shtetërore ushtarake policore e paramilitare serbe në mënyrë të organizuar kundër popullsisë shqiptare në Kosovë, edhe për dhunimet e mijëra femrave shqiptare, ndonëse konsiderohen krime kundër njerëzimit, deri më tani askush nuk është përgjigjur para drejtësisë.

Burimi:

- Gazeta e përditshme shqiptare "Fakti", Shkup, 12 maj 1999,
- KMDLNJ: /Dhunimi plagë që vështirë shërohet/ Prishtinë, 20 prill 2000,
- Jehona Shyti, /Dhunimet si krime kundër njerëzimit/.
- "Flaka" Shkup, datë 24 maj 1999
- Luljeta Selimi, Rrëfime tronditës, / Femrat e dhunuara gjatë luftës/...,
- Luljeta Selimi, Dosja e dhunimit: /Vajzat e reja, pas aktit barbar i çonin në Serbi/,

SUPERSTRUKTURA KRIMINALE SERBE

Në vrasjen dhe masakrimin e popullsisë shqiptare është përfshirë një superstrukturë e forcave ushtarake e policore serbe. Këto forca përbënin një kombinim kompleks të strukturave policore speciale të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, njësisive ushtarake speciale të ushtrisë serbe dhe njësisive të shumta paramilitare, siç ishin: "Shkorpionët", "Tigrat e Arkanit", "Beli Orlovi" (Shqiponjat e Bardha) të Voislav Sheshelit, Formacioni "Frenki", një njësit komando i emëruar sipas udhëheqësit të tij Franko Simatoviq - "Frenki", "Operativna Grupa" ose "OPG" (grupi operativ), një njësit elitë i policisë serbe, pjesëtarët e të cilit e kanë quajtur veten "Magla" (mjegulla), "vullnetarë të ardhur nga Republika serbe e Bosnjes dhe shumë vullnetarë dhe mercenarë të ardhur nga ish-vendet sovjetike.

Për më tepër në njësitë paramilitare serbe janë rekrutuar vullnetarisht edhe serbë e malazezë lokal - vendës, ku kishte edhe njësi të veçanta kriminale siç ishte grupi paramilitarë i ashtuquajtur "Munja" (vetëtima) që mori pjesë në masakrën e fshatit Qyshk të Pejës e tjera formacione ushtarake e policore.

Burimi:

-Human Rights Watch / Nën pushtetin e urdhrave /- Krimet e luftës në Kosovë,
-KMLDNJ, Raport mbi shkeljen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Kosovë 1998-1999

KUSH ISHIN KRIMINELËT?



EMRAT E KRIMINELËVE SERBË QË KRYEN MASAKRA NË KOSOVË

Në vazhdim do t'i gjeni emrat e ushtarakëve, policëve apo personave të armatosur, për të cilët ka shënime që kanë marrë pjesë në kryerjen e krimeve të rënda si masakrimi, pushkatimi, therje të popullsisë civile shqiptare dhe dhunimin e femrave. Lista është ndërtuar sipas rasteve shumica e të cilave është shqyrtuar nga hetuesia ndërkombëtare dhe hetuesi i OKB-së për krime të luftës, Dennis Milner i cili thotë se; “...*Puna e ekipit të tij do të vazhdojë të fokusohet thuaja tërësisht në rangun e lartë të regjimit të krye akuzuarit për krime lufte, kryetarit jugosllavë Slobodan Millosheviq*”. Ndriçimi i të gjitha rasteve ende nuk është bërë. Për këtë është e udhës edhe mbledhja e të dhënave nga vetë të prekurit nga kriminelët, sidomos femrat të cilat për shkaqe të ndryshme nuk i kanë paraqitur rastet personale e që do të duhej t'i paraqesin pranë shoqatave që përkujdesen për këto raste. Vlerësohet, se gjatë luftës në Kosovë (1998-1999), forcat policore, ushtarake e paramilitare serbe kanë vrarë, ekzekutuar apo masakruar në forma më mizore, rreth 15 mijë shqiptarë, ku 90% prej tyre ishin civilë të pa armatosur. Në këtë periudhë kohore janë përdhunuar afër 20 mijë femra shqiptare. Gjithashtu, për rrëmbimin e mbi 3 mijë shqiptarëve, ku pas luftës një pjesë e tyre u gjetën nëpër varrezat masive në Serbi, ndërsa akoma nuk dihet për fatin e 1648 të tjerëve. Sipas një përlllogaritje, lufta e fundit në Kosovë solli vrasjen e mbi 13.000 civilëve, djegien e rreth 1.100 vendbanimeve, shkatërrimin e tërësishtëm të mbi 104.000 shtëpive dhe të mbi 214.000 të tjerave të shkatërruara e të plaçkitura, mbi 2000 dëshmorë të UÇK-së, dëbimi me dhunë i rreth 1.000.000 qytetarëve nga shtëpitë e tyre si dhe humbje të tjera të ekonomive familjare e kombëtare...

NË REÇAK

Kriminelët serbë që morën pjesë në Masakrën e Reçakut!

Sipas dëshmitarëve që mbijetuan krimin, në vrasjen e bashkëfshatarëve të tyre, përveç njësisve policore ushtarake e paramilitare serbe morën pjesë edhe serbët lokalë, që punonin në postë, në Kuvendin Komunal të Shtimes e tjerë.

Emrat e kriminelëve janë të publikuar më 10 qershor 2005 dhe janë të njohur për drejtësinë ndërkombëtare e vendore:

1. Bizhidar Markoviç,
2. Çedomir Aksiç,
3. Zhivorad Stojçetoviç,
4. Bogdan Nojiç,
5. Jovica Stojkoviç,
6. Momir Ristiç,
7. Zvonko Ristiç,
8. Ljubomir Nojiç,
9. Nenad Marinkoviç,
10. Pavle Marinkoviç,
11. Zoran Nedelkoviç,
12. Sllavisha Marinkoviç,
13. Vojislav Janiçijeviç,
14. Milivoje Çanoviç,
15. Jovica Jovanoviç,
16. Stojan Aksiç,
17. Millorad Kostić,
18. Dragisha Kostić,
19. Dragan Tasiç.

-Dëshmitë e dëshmitarëve që mbijetuan krimin
-Raporti i KMDLNJ-së, datë 6 prill 2000
-Revista Ekskluzive Nr.1, janar 2000, f.101,
-Revista Ekskluzive Nr.4, prill 2000, f.52,

NË GJAKOVË

Kriminelët serbë që morën pjesë në ekzekutimin dhe masakrimin e 750 civilëve shqiptarë dhe rrëmbimin e 680 të tjerëve nga Gjakova!

Emrat e këtyre kriminelëve janë publikuar më 7 maj 2005 dhe janë të njohur për drejtësinë ndërkombëtare e vendore:

- | | |
|------------------------|--------------------------|
| 1. Stanojeviç Momçilo, | 18. Steviç Bojan, |
| 2. Çamoviç Sreten, | 19. Obradoviç Ljubisha, |
| 3. Stanojeviç Milan, | 20. Pantoviç Radovan, |
| 4. Çoliç Rade, | 21. Pantoviç Miliç, |
| 5. Slavkoviç Milan, | 22. Jovanoviç Aca, |
| 6. Stanojeviç Sava, | 23. Bozhoviç Çedomir, |
| 7. Kovaç Slobodan, | 24. Jovanoviç Sava, |
| 8. Stojanoviç Sava, | 25. Ristiç Predrag, |
| 9. Dekiç Milan, | 26. Jovanoviç Goran, |
| 10. Dekiç Momçilo, | 27. Shqepanoviç Millosh, |
| 11. Raçiç Dragan, | 28. Krstiç Srgjan, |
| 12. Mirkoviç Vuk, | 29. Dimiç Zvezdan, |
| 13. Vujoviç Vaso, | 30. Jovanoviç Sinisha, |
| 14. Vujoviç Nikotin, | 31. Rajkoviç Gojko, |
| 15. Ragiç Darko, | 32. Drashkoviç Laza, |
| 16. Simiç Bozhidar, | 33. Lazareviç Doka. |
| 17. Steviç Nikola, | |

Burimi:

- Dëshmitë e dëshmitarëve që mbijetuan krimin
- Raporti i KMDLNJ-së, datë 6 prill 2000
- Revista Ekskluzive Nr.1, janar 2000, f.101,
- Revista Ekskluzive Nr.4, prill 2000, f.52,

NË PADALISHTË

Në një raport të KMDLNJ-së me seli në Prishtinë, të lëshuar më 6 prill 2000 thuhet: *“Në Skenderaj janë identifikuar emrat e të gjithë kriminelëve që më 26/27 mars 1999 në Padalishtë masakruan 19 anëtarë të familjes Imeraj (në mesin e të cilëve 11 femra dhe 5 fëmijë të moshës 2-16 vjeçare)”*.

Emrat e këtyre kriminelëve janë publikuar më 7 maj 2005 dhe janë të njohur për drejtësinë ndërkombëtare e vendore:

1. Predrag Belosheviq (Pjesëmarrës i luftërave në Kroaci dhe BeH).
- 2-3. Vëllezërit Grujica e Lubisha Belojeviq,
4. Zharko Belosheviq,
Zhika Belosheviq,
- 5-6. Vëllezërit Malisha e Çeda Tijaniq,
7. Goran Tijaniq,
8. Dejan Tijaniq,
9. Vedran Tijaniq,
10. Obrad Tijaniq,
11. Zhivan Vuçiq,
12. Mirolub Vuçiq,
13. Dushan Vuçiq,
- 14-15. Vëllezërit Rade e Milisav Ivanosheviq,
16. Igor Shapiq,
17. Gradibor Radunoviq,
- 18-19. Ivan Gajin dhe Zoran Shlaniq, (të gjithë nga fshati Cërkolez).
- 20-21. Dushan Shapiq e Zharko Shapiq (nga Belica)
22. Dragan Cvetkoviq (nga Uça) dhe
23. Sllobodan Petkoviq (nga Zhakova).

Burimi:

-Raporti i KMDLNJ-së, datë 6 prill 2000

-Revista Ekskluzive Nr.1, janar 2000, f.101,

NË IZBICË

Sipas raportit të KMDLNJ-së, të datës 6 prill 2000, në ekzekutimin e 157 shqiptarëve në Izbicë janë përfshirë edhe serbët lokalë të fshatrave të Drenicës dhe të Burimit (ish-Istogut). Në këtë masakër mizore kanë marrë pjesë: 42 pjesëtarë të familjeve Tomasheviç nga Syrigana.

Kriminelët serbë, që morën pjesë në ekzekutimin e 157 shqiptarëve në Izbicë, emrat e këtyre kriminelëve serb janë të njohur për drejtësinë ndërkombëtare e vendore:

NGA SYRIGANA

- | | |
|--------------------------|---------------------------|
| 1. Mihajlo Tomasheviç, | 21. Milan Tomasheviç |
| 2. Veselin Tomasheviç, | 22. Dragoljub Tomasheviç, |
| 3. Sllavko Tomasheviç, | 23. Gjoko Tomasheviç, |
| 4. Vujadin Tomasheviç, | 24. Boshko Tomasheviç, |
| 5. Nenad Tomasheviç, | 25. Zhivorad Tomasheviç, |
| 6. Stojadin Tomasheviç, | 26. Zhivojin Tomasheviç, |
| 7. Igor Tomasheviç, | 27. Najdan Tomasheviç, |
| 8. Miloje Tomasheviç, | 28. Nebojsa Tomasheviç, |
| 9. Vladan Tomasheviç | 29. Nenad Tomasheviç, |
| 10. Radoslav Tomasheviç, | 30. Branillav Tomasheviç, |
| 11. Vasilije Tomasheviç, | 31. Ratko Tomasheviç, |
| 12. Milosh Tomasheviç, | 32. Filip Tomasheviç, |
| 13. Radivoje Tomasheviç, | 33. Dejan Tomasheviç, |
| 14. Preda Tomasheviç, | 34. Gordan Tomasheviç, |
| 15. Srgjan Tomasheviç, | 35. Predrag Tomasheviç, |
| 16. Millorad Tomasheviç, | 36. Despot Tomasheviç, |
| 17. Mileta Tomasheviç, | 37. Tadisha Tomasheviç, |
| 18. Radenko Tomasheviç, | 38. Sinisha Tomasheviç, |
| 19. Mile Tomasheviç, | 39. Tomisllav Tomasheviç, |
| 20. Stojadin Tomasheviç, | 40. Zoran Tomasheviç dhe |
| | 41. Goran Tomasheviç, |

42. Branislav Kragoviç,
43. Ratko Kragoviç.
 NGA BANJA
44. Marko Ristiç,
45. Marko Damjanoviç,
46. Dragoljub Rajkoviç,
47. Jovica Rajkoviç,
48. Rade Kovaçeviç-Zec,
49. Dika Kovaçeviç,
50. Ognjan Kovaçeviç,
51. Gjorgje Mojsiç,
52. Nebojsa Kovaçeviç,
53. Radosav Kovaçeviç,
54. Mile Jokiç,
55. Sinisha Jokiç,
56. Svetozar Ristiç,
57. Zoran Kovaçeviç-Princ.
 NGA RUNIKU
58. Momir Milentijeviç,
59. Zoran Jovanoviç,
60. Milutin Arisiç,
61. Milan Todoroviç,
62. Dejan Spasiç,
63. Nebojsa Nikçiç,
64. Miodrag Komatina,
65. Niçifor Kovaçeviç,
66. Dragan Dimitrijeviç,
67. Vukmiq Lazareviç.
 NGA LEÇINA
68. Todor Devergjiç,
69. Rade Devergjiç,
70. Dragisha Deverxhiç,
71. Milan Shteviç,
72. Dragomir Shteviç,
73. Miliç Petroviç,
74. Ognjan Petroviç,
 NGA RADISHEVA
75. Nenad Shmigiç,
76. Radoje Shmigiç,
77. Cvetko Shmigiç,
78. Dragan Shmigiç
79. Gollub Shmigiç.
 NGA KUÇIÇA
80. Dadosha Iliq,
81. Zhivoïn Iliq dhe
82. Momçillo Radovanoviç.
 NGA KOTORRI
83. Zhivko Jokoviç,
84. Radosllav Kandiç.
 NGA SKËNDERAJ
85. Radivoje Rasha-Kalenoviç
86. Dejan Rasha dhe
87. Dushan Rasha,
88. Zvonko Jovanoviç,
89. Zoran Jovanoviç,
90. Bllagoje Çolakoviç,
91. Nenad Çolakoviç,
92. Radosh Lajoviç,
93. Ilija Trajkoviç,
94. Rajko Rajçiç,
95. Vllado Bakraçeviç,
96. Lubisha Iliq,

97. Momo Peleviq,
98. Sllagjani (*polici i komunikacionit*),
99. Sadudin Rexhepagiç.

NGA ISTOGU
100. Goran Shapiq,
101. Rade Shapiq dhe
102. Dushan Shapiq,

Këtë listë me emra të këtyre kriminelëve serbë e kishte në duar UNMIK dhe institucionet e Kosovës dhe pavarësisht gjithë këtyre dëshmive, ata as u dënuan e as u morën në pyetje.



Pamje të varrezave në Izbicë, ku forcat serbe ekzekutuan dhe masakruan 147 civil shqiptarë

Burimi:

- Dëshmitë e dëshmitarëve që mbijetuan krimin
- Raporti i KMDLNJ-së, datë 6 prill 2000
- Revista Ekskluzive Nr.1, janar 2000, f.101,
- Revista Ekskluzive Nr.4, prill 2000, f.52,

NË SANKOC - DRENICË

Kriminelët serbë që kanë kryer krime në Sankoc të Drenicës. Në tetor të vitit 1999 në fshatin Sankoc të Drenicës, gjatë pastrimit të terrenit nga njësitë i TMK-së, të Batalionit I-rë „Ymer Alushani“ të Brigadës 121 „Kumanova“, në njërën nga ish-bazat e shtabit komandues të bandave kriminale serbe, është gjetur një listë me emra të formacioneve ushtarake që vepronin në Drenicë. Aty janë gjetur edhe numra të telefonave dhe fotografi të ndryshme si dhe ditarë që këta kriminelë kanë mbajtur gjatë luftës në Kosovë. (lexo: Revista Ekskluzive, Nr. 1. Janar 2000, f.101).

- | | |
|----------------------------------|---------------------------|
| 1. Llazareviq Dragisha, nëntoger | 14. Momqilloviq Miroslav |
| 2. Gjorgjeviq Sinisha, rreshter | 15. Ivanoviq Milivoje |
| 3. Blanusha Mile, rreshter | 16. Dejanoviq Verolub |
| 4. Korçag Goran, rreshter | 17. Janjusheviq Zhivorad |
| 5. Millanoviq Predrag, dhjetar | 18. Nedelkoviq Bratisllav |
| 6. Radulloviq Nebojsa | 19. Petkoviq Bogolub |
| 7. Simiq Goran | 20. Gjoriq Sllavolub |
| 8. Kostiq Sasha | 21. Vaniq Rasha |
| 9. Daniq Sllobodan | 22. Dimiq Dushan |
| 10. Gjorgjeviq Zoran | 23. Bajrami Igor |
| 11. Shabiq Zvonko | 24. Aliq Zoran dhe |
| 12. Qausheviq Nenad | 25. Branko Jançiq |
| 13. Jovanoviq Dragi | |

Burimi:

-Raporti i Njësitit të TMK-së, Bat. I-rë të Brigadës 121, tetor 1999

-Revista Ekskluzive Nr.1, janar 2000, f.101

-Revista Ekskluzive Nr.4, prill 2000, f.52,

NË SLLATINË

Kriminelët serbë, që u përfshinë në vrasjen e shqiptarëve në Sllatinë të Fushë-Kosovës.

Pas përfundimit të luftës në Kosovë, në garazhin e shtëpisë së Rrahim Imerit në fshatin Sllatinë të Fushë-Kosovës është gjetur një listë me emra të pjesëtarëve të forcave ushtarake e policore serbe që morën pjesë në vrasjen e shqiptarëve në Sllatinë dhe në plaçkitjen e djegien e shtëpive të shqiptarëve në këtë fshatë. Emrat e këtyre kriminelëve serb janë të njohur për drejtësinë ndërkombëtare e vendore:

- | | |
|------------------------------|--------------------------|
| 1. Zoran Vukdragoviç - toger | 15. Bulatoviç Mile |
| 2. Lubisha Simiç - rreshter | 16. Rangjeloviç Cvetko |
| 3. Zoran Ristovski | 17. Boshkiç Radoslav |
| 4. Dushan Jevriç | 18. Ristia Slobodan |
| 5. Zoran Joviç | 19. Gjurgjeviç Darko |
| 6. Mladen Peshiç | 20. Miloviç Dragisha |
| 7. Milosh Mihajloviç | 21. Ivanoviç Ivan |
| 8. Marko Zhivojnoviç | 22. Steviç Vladeta |
| 9. Slavisha Gjorgjeviç | 23. Stojanoviç Sasha |
| 10. Miodrag Pejatoviç | 24. Aksiç Nenad |
| 11. Dejan Mikiç Igor | 25. Jovanoviç Nenad |
| 12. Gurkoviç Ivan | 26. Zhivkoviç Slaviç dhe |
| 13. Stanojeviç Zoran | 27. Dejan Slaviç. |
| 14. Mimiç Radoje | |

(Dejan Saviç mësohet se ishte pjesëmarrës edhe në masakrat ndaj civilëve shqiptarë në Opojë)

Burimi:

-Raporti i KMDLNJ-së

-Revista Ekskluzive Nr.1, janar 2000, f 101

-Revista Ekskluzive Nr.4, prill 2000, f.52, .

NË QYSHK

Njësitet barbare serbe që vranë e masakruan 42 shqiptarë në fshatin Qyshk dhe 35 të tjerë në fshatrat fqinje Pavlan dhe Zahaq të Pejës. Më 14 maj 1999 në fshatin Qyshk (2-3 km afër Pejës) u vranë e u masakruan barbarisht 42 meshkuj, gjatë një sulmi të furishëm nga forcat e kombinuara elite serbe. Në masakrimin e civilëve shqiptarë kanë marrë pjesë:

Formacioni “Frenki”, një njësit komando i emëruar sipas udhëheqësit të tij Franko Simatoviq - “Frenki”, e cila ka qenë pjesë e forcave speciale të sigurimit shtetëror të Serbisë, të njohur edhe si “Beretat e kuqe” (Crvene berete).

“Operativna Grupa” ose “OPG” (Grupi Operativ), një njësit elitë i policisë serbe, pjesëtarët e të cilit me krenari kanë quajtur veten “Magla” (Mjegulla), sepse pas aksioneve të ndërmarra ata nuk kanë lënë ndonjë gjurmë. “OPG-ja” mësohet të ketë marrë urdhrat nga gjeneralë të lartë në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Serbisë. Bazuar në dëshmitë e disa burimeve serbe, pjesëtarët e OPG-s kanë marrë pjesë edhe në disa masakra tjera famëkeqe në Kosovë...

Njësitë snajperist i Armatës së Tretë “Jugosllave”, grup që theksohet të ketë qenë nën komandën e drejtpërdrejtë të krye gjeneralit të Armatës së Tretë serbe.

Pastaj, grupet paramilitare të ashtuquajtur “Vetëtima” (Munja)

Këta të fundit, në një raport të organizatës “Human Rights Watch-it” (HRW), përshkruhen se; *“ka qenë një mishërim i çuditshëm i policëve, kriminelëve dhe të vetëquajturve patriotë, (plotësisht nën kontrollin e armatës dhe policisë), të cilët nga serbët ishin konsideruar si legjendarë...”*

-Raporti i KMDLNJ-së, datë 6 prill 2000

-Raporti i “Human Rights Watch”- HRW.

NË KISHNICË

Kriminelët serbë, që kryen krime në Kishnicë dhe në disa vende tjera të Kosovës.

Në nëntor të vitit 1999, në fshatin Kishnicë (afër Prishtinës), në shtëpinë e Sabit Krasniqit, u gjet një listë me 20 emra kriminelësh serbë. Ata kishin vendosur shtabin operativ paraushtarak dhe nga shumë burime dëshmohet se nga kjo bazë shkonin e bënin krime ndaj popullatës civile shqiptare nëpër shumë pjesë të Kosovës. Bazuar në listën me emra e mbiemra dhe në adresat e tyre, rezulton se këta kriminelë serbë janë nga Kosova, me përjashtim të njërit që ishte nga Kurshumlia. Për këto krime kanë dëshmuar Musa Gashi dhe Bajram Gashi, që kanë shpëtuar nga thikat e këtyre kriminelëve.

Emrat e këtyre kriminelëve serbë janë të njohur për drejtësinë ndërkombëtare e vendore:

1. Berisha Ruzhdi - Bekim, rom
2. Iliq Stalin, Prelloc i Prishtinës
3. Velko Paniq, Prelloc i Prishtinës
4. Pavli - Sinisha, Prelloc i Prishtinës
5. Cvejiq Lubisha - Lan, Hallaq i Madh, Lipjan
6. Vukadinoviq Jovan - Njegosh, Kurshumli
7. Andriq Mirko - Drashko, Prishtinë
8. Dikiq Branko - Nebojsa, Prilluzhë
9. Krastiq Rade - Svetislav, Skullan i Lipjanit
10. Selishnik Jelica - Tomislav, Kishnicë
11. Sinisha Jovanoviq, Kishnicë
12. Jovan Karaxhiq, Kishnicë
13. Goran Trajkoviq, Kishnicë
14. Boban Trajkoviq, Kishnicë

15. Dejan Trajković, Kishnicë
16. Predrag Gjorgjević, Kishnicë
17. Petar Savelić, Kishnicë
18. Mile Bulajić, Kishnicë
19. Gjorgje Bulajić, Kishnicë
20. Zhivorad Mitić - Zhiko, Kishnicë
21. Dragan Mitić - Burdo, Kishnicë
22. Dragan Milić, Kishnicë
23. Zoran Trajković, Kishnicë
24. Mike Ilić, Graçanicë
25. Dushan Ilić, Graçanicë



*Një grup kriminelësh serbë të luftës që kryen masakrat në Kosovë
(1998-1999)*

Burimi:

- Raporti i KMDLNJ-së
- Revista Ekskluzive Nr.1, janar 2000, f.101,
- Dëshmi e të mbijetuarve Musa Gashi dhe Bajram Gashi

NË KLINË

Më 12 nëntor 1999, është gjetur edhe një listë me emra të kriminelëve serbë, që kanë vrarë, ekzekutuar e masakruar mizorisht qindra civilë Shqiptarë në komunë të Klinës. Në mesin e barbarëve figuron edhe një barbar shqipfolës. Dihet mirëfilli se në komunën e Klinës janë përfshirë më së shumti serbë lokalë në vrasjen e Shqiptarëve.

Emrat e këtyre kriminelëve janë të njohur për drejtësinë ndërkombëtare e vendore:

- | | |
|-----------------------|-------------------------|
| 1. Danë Balaj | 14. Zhivkoviç Radosllav |
| 2. Zoran Dobriç | 15. Zhivkoviç Llazar |
| 3. Zharko Stepiç | 16. Vushtiç Radoje |
| 4. Vitomir Saviç | 17. Zariç Sreqko |
| 5. Millorad Stepiç | 18. Kiziç Gollub |
| 6. Gollub Stashiç | 19. Kiziç Gjoko |
| 7. Dragomir Stashiç | 20. Dashiç Nevica |
| 8. Bado Bogiqeviç | 21. Krstiç Millan |
| 9. Zaiç Vojo | 22. Dobriç Dushan |
| 10. Dobishleviç Sreta | 23. Kiziç Radovan |
| 11. Dançiç Vojo | 24. Kiziç Ranko |
| 12. Popi Zoran | 25. Gollub Llazareviç |
| 13. Pavlloviç Dragan | 26. Borko Radojeviç |

Kriminelët serbë që vranë, masakruan dhe i dëbuan me dhunë popullatën civile nga Shtupeli dhe fshatrave përreth të Komunës së Klinës:

Shutiç Sllobodan Vuçko, Shtupel me nr. të lejes 54076,
Qakolli Milaim Muhamet, me nr. 66699,
Donçiç Millosh Savo, Bingjë, më nr. 8183,
Stepiç Aleksa Nedelko, Drenovc, me nr. 37095,

Zhivković Radosav Danilo, Krushevë me nr. 8254,
Vuçiqević Ranko Lazar, Klinac, me nr. 37719,
Pavlović Dragomir Mirko, Klinë me nr. 38710,
Garić Dragan Radovan, Dellovë me nr. 52895,
Donjić Dragan Danilo, Bingjë, me nr. 62796 (pjesëmarrës
direkt në masakra kundër shqiptarëve),
Orlović Savo Spasoje, Poterq të Epërm, me nr. 59998,
Krajić Milić Milosh, Gremnik, me nr. 25128,
Gjurgjević Milenko Stevan, Grabanicë me nr. 66323,
Gjurgjević Zhivan Jeremija, Grabanicë me nr. 45063,
Garić Rangje Zhivota, Dellovë me nr. 25864,
Donjić Vojislav Dragić, Bingjë me nr. 50628 (udhëheqës i
forcave paramilitare serbe),
Boro Jaksimović Petar, Gjurgjevik të Vogël me nr. 45653,
Banjac Danilo Vaso, Bërkovë me nr. 41705,
Berisha Emin Alil, Maglaj me nr. 35535,
Kurosh Ramadan Salih, Kijevë me nr. 62590,
Radosavlević Rdomir Ilija, Klinë me nr. 55357,
Balaj Ramadan Beqir, Gllarevë me nr. 66921,
Stepić Zharko Radomir, Drenovc me nr. 66640,
Zhivković Jablan Spasoje,
Zhivković Jagosh Spasoje,
Zhivković Sasha Gollub,
Garić Zhivan Pero,
Garić Stanoje Bojko,
Garić Bogić Kersto,
Mikić Borislav Dragoljub,
Magić Vesko Milutin, (polic famëkeq),
Banjac Bozhidar Spaso,
Garić Čedomir Zhivota,
Raqić Ljubomir Milorad,

Dabizhljeviq Zhivko Simjon,
Qakolli Naim Selim,
Maroshiq Radojica Radenko,
Cvetkoviq Zhivan Zarija,
Zhivkoviq Nenad Tomislav,
Balaj Pajazit Beqir,
Balaj Naim Ramadan,
Gariq Miliq Kersto,
Donqiq Ranko (udhëheqës i SPB në Pejë dhe Klinë
pjesëmarrës edhe në masakra),
Donqiq Stojan Jovan (udhëheqës i paramilitarëve për
komunën e Klinës),
Misirliq Jagosh Blagoje,
Misirliq Milko Radosh (polic famëkeq, ekzekutues i drejtë për
drejtë ndaj familjes Zhabota, 6 të vranë dhe 5 të plagosur), dhe
Vukosavljeviq Dragan (paramilitar i njohur për krime lufte).

(Emrat si dhe të dhënat tjera janë marrë nga banorët e B.L. Shtupel, Komuna e Klinës lidhur me krimet e kryera nga serbet e këtij lokacioni. Dokumenti është i përpiluar në formë padie, të bashkëngjitura mbi 20 deklaratatë të personave të mbijetuar, i cili ka mbi 40 faqe dhe i është drejtuar: Prokurorit Publik, Gjykatës Komunale në Klinë, Qeverisë së Kosovës, Kreut Komunal të Klinës, Administratorit Komunal të Klinës, KMNDLJ-së, dhe të gjitha organeve tjera kompetente)

Burimi:

-Raporti i KMDLNJ-së

-Revista Ekskluzive Nr.1, janar 2000, f.101,

-Revista Ekskluzive Nr.4, prill 2000, f.52,

-Dëshmitë e të mbijetuarve nga masakra e fshatit Shtupel, Komuna e Klinës

NË VITI

Kriminelë serbë, që me emrin "Toga e tmerrit" vranë e masakruan civilët shqiptarë në Viti.

Më 2 dhjetor 1999, janë gjetur disa dokumente në Samakovë, Viti, Goshicë, Kabash, Binçë, Kllokot, Zhiti etj., në të cilat dëshmohet se kriminelët serbë, në këtë rajon kanë vepruar me emrin "Toga e tmerrit". Kjo togë është formuar më 19 maj 1999 dhe për një kohë të shkurtër ka vranë e masakruar 22 civilë pleq, plaka, fëmijë, gra dhe burra që i zunë nëpër shtëpitë e tyre.

Emrat e këtyre kriminelëve janë të njohur për drejtësinë ndërkombëtare e vendore:

- | | |
|--------------------------|----------------------------|
| 1. Miodrag Stanishiq | 14. Dragisha Dinçiq |
| 2. Sasha Jeriniq | 15. Novica Jakovleviq |
| 3. Stanislav Vukiq | 16. Lubisha Arsiq |
| 4. Sasha Vujiq | 17. Sinisha Jovanoviq |
| 5. Miroslav Mihajllloviq | 18. Aleksander Jovanoviq |
| 6. Millovan Ivkoviq | 19. Srgjan Ristiç |
| 7. Vidosllav Kojiq | 20. Arsiq Nebojsa |
| 8. Moma Vasoviç | 21. Goran Stanishiq Dragan |
| 9. Nenad Perzhiq | 22. Dragan Nojkiq |
| 10. Branko Arizonoviq | 23. Canko Spasiq |
| 11. Nebojsa Stanojoviq | 24. Bogoso Krqmareviq dhe |
| 12. Zoran Cvetkoviç | 25. Millosh Mitrovic |
| 13. Sllavisha Maksimoviq | |

Burimi:

-Raporti i KMDLNJ-së

-Revista Ekskluzive Nr.1, janar 2000, f.101,

-Revista Ekskluzive Nr.4, prill 2000, f.52,

NË FUSHË-KOSOVË

Kriminelët serbë, që kryen krime dhe spastrim etnik në Fushë-Kosovë. Kjo listë është gjetur me emra të kriminelëve serbë, që kanë vrarë, ekzekutuar e masakruar mizorisht dhe dëbuar me dhunë qindra mijëra civilë Shqiptarë në komunë të Fushë-Kosovës. Emrat e të cilëve tashmë janë të njohur për drejtësinë ndërkombëtare e vendore:

1. Sllavisha Andrijeviq - (njëri ndër organizatorët kryesorë për dëbimin me dhunë të shqiptarëve nga Fushë-Kosova),
2. Dragomir Popoviq
3. Boban Mitrovic
4. Dragan Dabizhlevic
5. Lazar Deniq
6. Radomir Dishiq
7. Radovan Petrovich
8. Dragan Mitrovic
9. Radojica Mitic
10. Dragan Ilic
11. Aca Stankovic
12. Zhika Begnellavic
13. Mlladen Lazic
14. Sllavisha Grujic
15. Sasha Mihajllovic
16. Sava Drashkovic
17. Miodrag Bangjur
18. Millan Milkovic
19. Boban Grujic
20. Sasha Maksimovic
21. Nebojsa Stefanovic
22. Vllastimir Jovanovic
23. Dushan Zharkovic
24. Dragan Zheqic
25. Dobri Artinovic
26. Stanko Milankovic
27. Sllobodan Mitrovic
28. Dobrivoje Gjorgjevic
29. Darko Miloshevic
30. Dragolub Lakaqevic
31. Lubisha Veliqkovic
32. Zharko Vasic

Burimi:

-Raporti i KMDLNJ-së

-Revista Ekskluzive Nr.1, janar 2000, f.101,

-Revista Ekskluzive Nr.4, prill 2000, f.52,

ASKUSH S'I NDJEK KRIMINELËT!

Pas përfundimit të luftës, kur popullata e shpërngulur shqiptare kthehet në Kosovë, ka gjetur dokumente ushtarake e madje edhe fotografi, në të cilat shihen qartë ushtarë, polic e paramilitarë serbë në aksione, duke buzëqeshur mistershëm me armë në dorë përpara shtëpive që i kishte kapluar zjarri. Edhe pse emrat e kriminelëve që kryen mijëra masakra, janë identifikuar nga njerëzit që mbijetuan krimin, deri më sot askush nga përgjegjësit e sigurisë në Kosovë, as policia apo prokuroria e EULEX-it, as policia e Kosovës apo prokuroria vendore, por as institucionet tjera ndërkombëtares dhe as ato vendore (Qeveria, Presidenca, Kuvendi apo shoqëria civile), nuk kanë treguar as më të voglin interesim, për t'i ndjekur e arrestuar këtë mori kriminelësh. Ndërkohë që EULEX-i po i ndjek e arreston luftëtarët e lirisë, të cilët me armë në dorë e mbrojtën popullatën nga gjenocidi dhe etnocidi serbë! Kur kihen parasysh të gjitha këto fakte dhe mijëra të tjera si këto, natyrshëm bëhen përgjegjës, gjithë lidershipi politikë e institucional i Kosovës, për neglizhencën totale rreth ngritjes së një Padie penale, kundër shtetit serbë, për gjenocidin dhe etnocidin e kryer në Kosovë.

Deri me tani janë botuar shumë libra nga autorë vendor e ndërkombëtar, ku pasqyronin krimin e forcave ushtarake e policore serbe në Kosovë. Janë mbajtur tubime e ngritur pllaka përkujtimore për të rënë, krimet, dëbimet e dhunimet nga këto forca, si dhe janë mbajtur disa tryeza shkencore, duke kërkuar që kriminelët të nxjerrën para drejtësisë, por, krejt kjo mbeti vetëm për t'i përkujtuar viktimat e luftës, derisa Organet e drejtësisë dhe Institucionet e Kosovës, në vend që t'i ndjekin e ndëshkojnë kriminelët, po formojnë edhe Gjykata speciale për t'i ndjekur e ndëshkuar çlirimtarët me formulën e tyre; kinse për ta pastruar

Luftën e drejtë dhe çlirimtare, duke mos dashur ta kujtojnë së UÇK-ja ishte dhe shërbeu edhe si çlirimtare edhe si këmbësori e NATO-së gjatë kohës se bombardimeve.

Shifrat zyrtare mbi pasojat e represionit të përgjakshëm serb në Kosovë, të botuara në librin “Krimet e Serbisë në Kosovë 1998-1999”, “Krimet e Serbisë ndaj fëmijëve në Kosovë 1998-1999”, të publikuara nga Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës dhe Instituti i Historisë tregojnë për masakrat serbe në Kosovë, vrasjet, dhunimet, shkatërrimet dhe dëbimet me dhunë.

**Bilanci i luftës në Kosovë botuar në
“Krimet e Serbisë në Kosovë 1998-1999”**

- Shtëpi të shkatërruara të popullatës shqiptare: 100.589
- Shkolla të shkatërruara me dokumentacion: 358
- Zyra të vendit: 71
- Shtëpi kulture: 30
- Biblioteka publike dhe shkollore: 93
- Objekte shëndetësore: 123
- Objekte fetare (xhami, teqe, tyrbe): 215
- Kisha katolike: 5
- Objekte ndihmëse - përcjellëse: 88.101.

Pasojat e luftës në njerëz, masakra të mëdha, vrasje e organizuar, madje edhe të familjeve të tëra gjatë periudhës janar 1998 - 12 qershor 1999:

- Të vrarë: 11.840 viktima nga Kosova,
- 1.392 fëmijë deri në 18 vjeç.
- 296 fëmijë deri në 5 vjeç.
- 1.739 femra
- 1.882 të moshuar mbi moshën 65-vjeçare.
- 1.450 banorë ende janë të pagjetur.
- Janë dhunuar 20.400 femra shqiptare.

Sipas të dhënave të UNCHR, në fillim të qershorit 1999, nga Kosova ka pasur afro 1 milion refugjatët të dëbuar prej Kosove, gjatë periudhës së bombardimeve të NATO-së. Vendosja e refugjatëve sipas shteteve ishte:

-443.300 ishin vendosur në Shqipëri;

-247.800 në Maqedoni,

-69.300 në Mal të Zi;

-21.700 në Bosnjë dhe Hercegovinë. Pra, sipas të dhënave të sakta ishte një total prej 782.100.

Në vendet e tjera të botës u vendosën gjithsej 76.475 refugjatë, duke përfshirë:

-13.639 në Gjermani,

-7.581 në Turqi,

-5.829 në Itali,

-5.730 në SHBA, pastaj edhe në Francë, Norvegji, Suedi, Britani të Madhe, Poloni, Spanjë, Portugali, Finlandë, Zvicër, Izrael e vende tjera të botës...



Burimi:

-Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës

-Instituti i Historisë, Prishtinë

-Të dhëna zyrtare nga UNCHR

KANADEZI KUJTON:
VIKTIMA MË E RE ISHTE 2-VJEÇARE, MË E VJETRA 105

Dihet se policët shpesh përballen me skena të tmerrshme krimesh, por një oficer i pensionuar kanadez ka parë më shumë se që mund të imagjinojë dikush. Brian Honeybourn, rreshter i pensionuar i policisë në Vankuver, ka treguar se çfarë ka përjetuar si hetues i krimeve të luftës, 20 vjet më parë. Honeybourn ka punuar 33 vjet në policinë e Vankuverit, dhe ka qenë një prej anëtarëve themelues të njësitit të krimeve të pazbardhura. Më 1999, Honeybourn kishte ardhur në Kosovë, për të hetuar krimet që kishin ndodhur këtu gjatë luftës. Më 1999, Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO), në bazë të një mandati të Organizatës së Kombeve të Bashkuara intervenoi kundër forcave ushtarake e policore serbe në Kosovë, dhe kur trupat e tyre u futën brenda, zbuluan edhe varre masive.

Natyrisht, trupat e NATO-s nuk ishin të përgatitura për t'u ballafaquar me diçka të tillë, prandaj vendeve të NATO-s iu kërkuan që të dislokojnë një ekip mjekësh ligjorë në Kosovë. Pasi Kanadaja ishte kontaktuar, Honeybournit i kishin kërkuar të nisej drejt Kosovës, për të zhvilluar hetime për dy muaj. *“Më njoftuan dhe më kërkuan të vendosja brenda natës. Shkova në shtëpi, bisedova me gruan dhe me nënën time, dhe thash: Do të shkoj”*.

Brenda disa ditësh, Honeybourn do të vinte në Kosovë, si hetues në kuadër të ekipit, dhe si menaxher i logjistikës.

Honeybourn dhe ekipi i tij kanë qëndruar bashkë me trupat kanadeze gjatë hetimeve në Kosovë.

Gjatë kohës së tij në Kosovë, Honeybourn ka ndihmuar që të gjenden dhe të identifikohen kufoma në varreza masive. *“Në botë ndodhin shumë gjëra që s'raportohen fare”*, thotë Honeybourn.

Ai thotë se një prej sfidave më të mëdha gjatë hetimeve ka qenë kryerja e autopsive në terren. *“Viktima jonë më e re ishte rreth dyvjeçare, ndërsa më e vjetra 105-vjeçare. Kam pasur për detyrë të vërtetoj se viktimat nuk ishin luftëtarë”*.

Honeybourn kujton rastin kur Vlora, një vajzë shtatë-vjeçare në fshatin Llashticë, ishte qëlluar me plumb në fytyrë dhe kishte shpëtuar.

“Zoti do të ketë qenë me të, sepse plumbi ose s'ka pasur fuqi të mjaftueshme, ose ka dalë nga një tytë e prishur e kallashnikovit. Në vend se të kalonte nëpër dorën e saj, të cilën e kishte para fytyrës, dhe ta vriste atë, ai ka humbur fuqinë, ka goditur gishtërinjtë e saj, dhe ia ka prekur fytyrën. Disa njerëz e kanë të vështirë ta besojnë këtë, por unë kam fotografi të kësaj vajze”.^{57}



{57} Brian Honeybourn, hetues i krimeve të luftës në Kosovë, 1999

TOKË E MBJELLË ME VARRE
ËSHTË NJË TITULL I FUQISHËM FIKSIONAL E ARTISTIK

Ma. Sc. Fatmir Halimi

“Tokë e mbjellë me varre” është një titull shumë i fuqishëm fikcional e artistik, kurse përmbajtja e librit paraqet një realitet të tmerrshëm e shumë të hidhur për popullin shqiptar.

Autori Dibran Fylli në këtë libër publicistiko-historik, trajton ngjarjen më të lavdishme të popullit shqiptar të Kosovës prej që njih historia jonë, pra luftën e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për çlirimin e vendit, si dhe krimet makabre dhe më çnjerëzore që bëri pushtuesi serb.

Libri si nëntitull ka *krimet serbe në Kosovë 1998/1999* - argumente. Lexuesi në baze të kësaj shumë mirë mund ta konceptoj se libri përmban argumente të gjenocidit serb mbi popullatën e pafajshme civile në Kosovë. Agresori serb, në krye më kasapin dhe kriminelin e Ballkanit Sllobodan Millosheviqin ushtroi një dhunë dhe terror të paparë dhe të padëgjuar ndonjëherë në historinë e njerëzimit mbi popullatën shqiptare të Kosovës, vrau më shumë se 14.000 shqiptarë te pafajshëm, me kapacitetet e tij ushtarake, paramilitare dhe policore zhvilloi shumë masakra, ku ndër to sipas Dibran Fyllit janë; Masakra e Reçakut, Masakra e Izbicës, Masakra e Studimës së Vushtrrisë, Masakra e Rudinës në Rahovec, Masakra mbi familjen Deliu, Masakra mbi lagjen Tusus në Prizren, Masakra mbi familjen Duriqi e Bugujevci në Podujevë, Masakra e Mejës, e shumë e shumë masakra të tjera anë e kënd Kosovës. Këto masakra sipas autorit, armiku i përbetuar i shqiptarëve i zhvilloi kryesisht në ato lagje qytetesh e fshattrash dhe në ato familje shqiptare që ishin të pambrojtura, sepse siç thotë Fylli, aty ku ishte Ushtria Çlirimtare e Kosovës agresori serb kurrë nuk arriti ta vras e ta masakrojë popullatën civile, për arsye se burrat e gratë shqiptare që kishin rrokë armët për të mbrojtur

popullin e tij dhe për të çliruar vendin ishin viganë, ishin trima të pamposhtur, të cilët këtë e dëshmuuan në betejat e lavdishme që u zhvilluan në Prekazin Legjendar, në betejën e Koshares, të Kaçanollit, në betejën Te Tabet e Llapashticës, e në shumë beteja tjera.

Duke i bërë një analizë të përgjithshme të librit, vërej se Dibran Fylli në fokus të temës së trajtimit të tij nuk e ka luftën e lavdishme të UÇK-së, por temë e trajtimit dhe e shkrimit janë krimet serbe në Kosovë gjatë viteve 1998/99.

Ai në mënyrë kronologjike na i paraqet të gjitha ngjarjet, luftërat dhe masakrat që i zhvilloi armiku shovinist serb duke filluar nga masakra e Likoshanit dhe Çirezit, e cila ndodhi më 28.02.1998, që u masakruan dhe u vranë 24 viktimat civile, mandej na e paraqet ngjarjen e lavdishme të familjes Jashari në Prekaz, që u zhvillua ndërmjet datave 5, 6 e 7 mars të vitit 1989, ku bashkë me 58 të tjerë heroikisht ra edhe komandanti legjendar i UÇK-së, Adem Jashari. Mandej përgjatë viti 1998 me fakte, me argumente, me fotografi dhe me listën e emrave të viktimave na e paraqet masakrën e Qyqavicës, ku më 22 nëntor të vitit 1998, serbët vranë dhe masakruan më se 18 civilë të pafajshëm. Një tmerr dhe masakër serbët bënë edhe mbi popullatën civile të Abrisë së Drenicës më 26.09.1998, ku sipas Fyllit ata vranë 23 shqiptarë.

Kurse për ta arritë kulmin e gjenocidit mbi shqiptarët, ushtria kriminale serbe, më 15 janar 1999, në orët e hershme të mëngjesit, gjithmonë sipas autorit Fylli keqtrajtoi, terrorizoi familjet e pambrojtura të fshatit Reçak. Këta kriminel krejt në afërsi vranë 43 shqiptarë, që kryesisht ishin pleq, gra dhe fëmijë. Kjo ishte masakra më e tmerrshme në Kosovë, të cilën e lajmëruan të gjitha mediumet e botës. Reçaku ishte lajmi kryesor edhe në qarqet politike Evropiane dhe Amerikane. Kjo masakër dëshmoi se gjakpirësi serb po zhvillon një luftë të paparë në zemër të Evropës, se Millosheviqi po vret njerëz vetëm se janë shqiptarë

dhe se është duke bërë spastrim etnik. Sipas Dibran Fyllit, i pari që alarmoi botën e qytetëruar për krime serbe mbi popullatën civile në Kosovë dhe në Reçak ishte Villiam Voker, i cili pasi i pa me sytë e tij pleqtë, grat, fëmijët dhe foshnjat e masakruara të Reçakut, tha se këtu nuk ka luftë në mes të dy vendeve, por ka gjenocid, masakër, krim dhe spastrim etnik, sepse sipas veshjes këta njerëz nuk janë ushtar, por thjesht janë bujq, gra dhe fëmijë. Ai nga Reçaku bëri thirrje që bota e qytetëruar dhe forcat e NATO-s ta ndalin gjakpërësin Slllobodan Millosheviq.

Dibran Fylli duke qenë edhe vetë ushtarë i UÇK-ës në Zonën Operative të Drenicës dhe në Zonat tjera, do të jetë dëshmitar i shumë ngjarjeve dhe masakrave serbe në këtë zonë. Autorit nuk i mjafton vetëm kjo për të përgatitur librin e tij historik, por ai hulumton dokumente të organizatave të ndryshme që vepruan në Kosovë gjatë luftës dhe pas saj si: Organizatën Botërore për të Drejtat e Njeriut, KMDLNJ të Kosovës, OLV-në të UÇK-së, si dhe shumë medime të shkruara e filmike të kohës së luftës, gazetat vendore dhe të huajat e të tjera. Në bazë të këtyre autori sot sjell një libër të ndërtuar mbi fakte, dëshmi të personave që u shpëtuan masakrave dhe argumente, me lista të emrave të të gjithë atyre që u vranë, u masakruan në mënyrë më çnjerëzore dhe barbare nga forcat serbe gjatë viteve 1998-1999 në Kosovë.

Në lidhje me këtë mund të them se janë shkruar me dhjetëra libra për luftën e fundit në Kosovë, janë shkruar me mijëra vepra poetike e letrare për heronjtë dhe dëshmorët e UÇK-së, por libri *“Tokë e mbjellë me varre”* i Dibran Fyllit është libri, i cili më së miri e dëshmon gjenocidin serb mbi Kosovën, është libër i fuqishëm historik për luftën e fundit në Kosovë, i ndërtuar vetëm mbi faktin dhe argumentin.

KONTEKSTI HISTORIK E POLITIK

Sot kanë kaluar 20 vjet që kur ka përfunduar lufta, kurse Kosova përballet me shumë vështirësi, si ekonomike, politike, shoqërore e sociale. Kosova ende përballet me pasojat e kësaj lufte. Në Kosovë janë rreth 2.000 persona të zhdukur gjatë luftës, që edhe pas 20 vjetëve familjarët i kërkojnë eshtrat e tyre, e për këtë më së miri na dëshmon libri i Dibran Fyllit, ku ndër të tjera thotë se ushtria serbe pas çdo masakre mbi popullatën civile, aty ku ka mundur, kufomat i ka marrë me vete, vetëm që të zhduk gjurmët e krimet. Shteti i Kosovës me ndihmën e BE-së ka arrit që t'i identifikoi disa varreza masive në shtetin e Serbisë me kufomat e shqiptarëve, ku mbi to sot Serbia ka ndërtuar pompa benzine apo fabrika, por që ende nuk ka marrëveshje përfundimtare për kthimin e eshtrave të tyre në Kosovë. Edhe pas 20 viteve Kosova ka çështje të pazgjidhura me Serbinë siç janë: kthimi i të zhdukurve, kërkim falja nga ana e Serbisë, njohja e Serbisë shtetin e Kosove, mungesa e shtrirjes së pushteti të Kosovës në pjesët veriore të saj, si në Leposaviq, Zubin Potok e Zveqan, qytete këto që ende nuk i njohin institucionet tona shtetërore. Pra, me një fjalë ne ende jemi në luftë me Serbinë, por tash në luftë politike.

Kosova falëluftës titanike të UÇK-së e fitoi lirinë, por tash në këtë luftë paqësore me Serbinë është duke humbur shumë beteja politike. Gjykata e Hagës që ishte themeluar më herët për krimet në ish-Jugosllavi, gjatë viteve të nëntëdhjeta, arriti që menjëherë pas përfundimit të luftës në Kosovë të ngreh padi, ta arrestoi dhe ta burgos kasapin e Ballkanit, Millosheviqin, i cili për disa vite rresht u hetua për krimet në Kosovë, ku shumë shqiptar shkuan atje dhe dëshmuan kundër tij. Sipas autorit të këtij libri kundër Millosheviqit, në Hagë dëshmoi edhe Mustafë Dragaj - i mbijetuari i masakrës më të madhe në Kosovë, Izbicës, i cili në mënyrë të mrekulluar dhe vetëm me fuqinë e Zotit ka mundur të

jetë i gjallë nga pushkatimi. Gjykata Ndërkombëtare në Hagë dënoi krimin serb mbi Kosovë duke dënuar dy tre veta si Millisheviqin e Sheshelin, por kurrë deri më sot nuk u dënuan vrasësit e drejtpërdrejtë të shqiptarëve. Kriminelët e paramilitarët serbë, të cilët vranë shqiptarë, shkatërruan e plaçkiten shtëpitë tona, dhunuan e në fund i masakruan gratë e fëmijët tanë, ende nuk u dënuan as nga gjykatat tona në Kosovë. E për të gjitha këto nëse gjykatat tona nuk janë në dijeni dhe nuk kanë informacione, atëherë është libri *“Tokë e mbjell me varre”* i Dibran Fyllit, i cili edhe me emër e mbiemër i paraqet kriminelët serbë, të cilët janë gjallë dhe sot lëvizin të lirë në Serbi dhe në Kosovë.

Pra libri *“Tokë e mbjellë me varre”* do të jetë një argument i fuqishëm, një argument i gjallë sot dhe për të ardhmen, për të gjithë ata, apo edhe për të gjitha ato institucione që duan të vendosin drejtësi në Kosovë.

Kosova sot përballet edhe me një proces gjyqësor, që ndryshe do ta quaja *“Procei i Absurdit i shek. XXI”*. Njerëzimi, por edhe historia e qytetërimit evropian e botëror, ka njohur vetëm procese gjyqësore, ku është dënuar agresori, pushtuesi, apo sulmuesi, që pa të drejtë i ka privuar njerëzit nga jeta, ka bërë krime njerëzore dhe ekonomike. Kurse sot Kosovës pa të drejtë nga Bashkimi Evropian, vetëm për t'i plotësuar apetitet Serbisë, i është ngritur kallëzim penal, i është ngritur një proces gjyqësor *“Gjykata e Hagës”*, e cila tash donë të dënoi viktimën, donë ta dënoi Kosovën, pra Kosovën përmes ish-komandantëve dhe ish-ushtarëve të UÇK-së, të cilët na sollën lirinë. Sot shumë ish-komandantë të UÇK-së janë liderë partiak, janë liderë politik, janë udhëheqës të institucioneve tona, të cilët po thirren për të dëshmuar në Hagë.

Në këtë rast si botues dhe redaktor i librit *“Tokë e mbjellë me varre”*, se për ta dëshmuar pafajësinë tonë, për ta dëshmuar

edhe njëherë para botës, se kush është viktima dhe se kush bëri krim e gjenocid mbi Kosovën, të gjithë këta ish- komandantë dhe liderë politik, që po dyshohen sot nga Gjykata e Hagës ta kenë me vete këtë libër para trupit gjykues. Pra të mos flasin ata politikanë në Hagë, por të flet libri **“Tokë e mbjellë me varre”**, i Dibran Fyllit.

Dhe krejt në fund po e potencoi edhe njëherë se **“Tokë e mbjellë me varre”** është libri më i kompletuar me fakte, dëshmi e argumente, është libri më i përgatitur, më i fuqishëm, që njëherë e përgjithmonë ua mbyll gojën spekulimeve dhe i qet në pah vrasjet, masakrat dhe krimet, që i zhvilloi Serbia në Kosovë gjatë viteve 1998-1999.

*Ma. Sc. Fatmir Halimi,
Drejtor i Shtëpisë Botuese “ProkultPress”*

SINTEZA E DËSHMIVE

Dibran Fylli "Tokë e mbjellë në varre" (Krimet serbe në Kosovë 1998/1999) , një libër dëshmi e terrorizmit, masakrimit, traumatizmit dhe shfarosjes së popullit shqiptar në Kosovë.

Nga Flori Bruqi

Nëse Dante Aligieri na solli Ferrin e fantazuar me të gjitha labirintet e tij deri te rrethi i 12-të i perëndisë, në ditët tona doli një Dante i Ri, ai është shkrintari kosovar, Dibran Fylli.

Ky autor, në librin e tij me titull: "*Tokë e mbjellë në varre*" (*Krimet serbe në Kosovë 1998/1999*) na ka sjellë ferrin e vërtetë njerëzor, jo si dënese e perëndisë për të këqijat dhe mëkatet e botës njerëzore, por ferrin e shtetarëve e gjeneralëve të Serbisë, të strukturave të ushtrisë e policisë serbe, që e ushtruan mbi popullatën shqiptare.

Në këtë libër, nga faqja në faqe njihesh me skena të llahtarshme, jo të sajuara si te Dante Aligieri, por reale, ku artistët që luajnë, janë: plaka, pleq, gra, burra, madje edhe fëmijë, femra e meshkuj, është një popull i tërë i vënë në kalvarin e vuajtjes e të torturës, një popull i destinuar për t'u përzënë nga trojet etnike e për t'u qitur fare me gjithçka. Është një vend, i cili u bë shkumb e hi jo vetëm nga zjarri i predhave e bombardimeve, por edhe nga zjarri i vendosur me benzinë nga dora e shkjaut.

Kur lexon këto faqe të këtij libri nuk ka mendje që nuk luan, nuk ka sy që nuk loton, nuk ka trup që nuk rrëqethet, nuk ka qenie që nuk revoltohet, nuk ka njeri që nuk reagon dhe nuk besoj të ketë qenie njerëzore që të mos jetë e gatshme për t'u radhitur në skalionet e luftëtarëve për t'u thënë ndal këtyre kriminelëve të njerëzimit, arkitektëve të gjenocidit serb në Kosovë, apo atij çam në Greqi. Duke lexuar librin, lexuesi njihet në botën e kriminit dhe nuk është më njeri, por duket si një profet që vëzhgon çfarë ndodh

në atë labirint krimesh dhe i raporton zotit të tij. Lexuesi xhiron me kamerën e ndjesive, përjetimeve, fantazive dhe riprodhimeve të realiteteve monstruoze që Dibran Fylli, falë aftësive të tij psikologjike, por edhe atyre artistike i sjell mjeshtërisht në memorien tonë.

Përshfaqet aty Shën Bortolemeu i Gjakovës, objektet fetare qindravjeçare që digjen, nëna që dhunohen para fëmijëve, mure të përgjakura, bajoneta që presin kopsa, çjerrin gjokse, trupa që digjen me benzinë, makina që mbushen me kufoma dhe nuk dihet ku përfundojnë, prindër që çmenden para torturave të fëmijëve e dhunimeve të nuseve të djemve, gjurmë dhëmbësh nëpër trupësa, shenja plagësh e djegiesh nëpër trupësat e femrave kosovare, sisa të prera, sy të dalë, gishta të prerë etj. Pra, këtu mund të them se shëmbëlltyrat më të këqija të Evropës të sotme.

Është shumë tragjike, e paprecedentë dhe nuk mund të kapërdihet pa lënë gjurmë te çdo lexues e te çdo njeri që i thotë vetes njeri, vrasja e 22 fëmijëve të Familjes Vejsa, të Familjes Cana, Ramadani etj, masakrimi i kirurgut gjakovar Dr. Izet Himës. Këtu nuk mund të kapërdihet as dhunimi i 2019 femrave, që sot trajtohen nga shoqata “Jeta në Kastriot” nga të cilat, 124 prej tyre janë me gji të prerë e gishtërinj të këputur, 9 me sy të nxjerrë, 16 me plagë në fytyrë dhe që kanë lënë 4327 fëmijë jetimë, të cilët presin me padurim ta shohin e ta shijojnë kujdesin amësorë.

Pikërisht libri i autorit Dibran Fylli është sinteza më e mirë e dëshmisë së krimeve kundër njerëzimit dhe gjenocidit serb në Kosovë. Ai është një apel i hapur për EULEX, BE dhe për Kombet e Bashkuara për të nxjerrë mësimet e duhura, e për të vënë para përgjegjësisë çdo shtetar e shtet që kryen krime e gjenocid, për të prerë e parandaluar një herë e mirë dorën gjakatare të masakrimit, terrorizmit e shfarosjes së njerëzve të pafajshëm e të pambrojtur. Në këtë libër janë trajtuar me realizëm temat psikologjike. Në këtë sprovë prej disa faqesh, autori Dibran Fylli jo vetëm se paraqitet si

njuhës i thellë i psikologjisë, por paraqitet i veçantë edhe si prozator. Është veçori dalluese e këtij autori pasqyrimi i proceseve e gjendjeve psikologjike të personazheve të tij artistikisht.

Ky autor falë kompetencës në lëmin e regjisë, ka harmonizuar bukur me anë të fjalës artistike rrjedhën e përjetimeve dhe tablotë e mizoskenave psikologjike të qenieve njerëzore, veçanërisht kur ata janë nën presion e shantazhim, nën trysni të kanosjes me vdekje dhe shuarje jete. Autori në këtë plan mund të jetë ndër lauerantët e paktë edhe në botë të këtyre mizoskenave e të këtij areali psikologjik.

Dibran Fylli me këtë libër ka sjell një kinoditar me metrazh të gjatë të traumës psikologjike të njerëzve nën dhunim e torturë. Ai me mjeshtëri artistike dhe profesionale ka sjellë në faqet e librit traumën psikologjike të një populli martir, siç është populli kosovar, ka realizuar më së miri edhe një model të rrjedhës së proceseve e gjendjeve psikologjike në kushte të veçanta specifike, në kushtet e traumës e të shantazhimit, kur luhet me jetën dhe vdekjen. Ai nuk mbetet, thjeshtë një vëzhgues i këtyre proceseve e gjendjeve psikologjike të personazheve të të gjitha moshave, por i zhbiron thellë ato, i ndjek hap pas hapi, i analizon me detaje, përgjithësisht jep dhe mesazhe profilaktike për kapërcimin e rehabilitimin e tyre.

Pikërisht në këtë anë fokusohet shumë, pasi ajo çka ndodhi, nuk mund të ndalohet më as në Kosovë, as në Çamëri, por e rëndësishme është parandalimi i situatave të tilla kudo në botë dhe rehabilitimi i këtyre viktimave nga qeveria e Kosovës, Greqisë, Afganistanit, Libisë e gjetkë.

Autori Dibran Fylli si specialist i fushës së regjisë profilaktike fokusohet në mënyrë të veçantë në një dukuri që është shtuar shumë në Kosovë dhe në shumë vende të botës, vetëvrasjen. Jep dinamikën e këtij procesi, analizon në thellësi faktorët që i çojnë

njerëzit në këtë përfundim si dhe jep mesazhe shumë profilaktik për kujdesin dhe parandalimin e Suicidit...

Analizat dhe mesazhet që jep autori janë shumë kuptimplote për çdo shtetar e qeveri. Trajtesa e këtij akti nga autori si dhe mesazhi që jep janë sa humanë aq edhe të domosdoshëm për çdo qeveri e për çdo shtetar për ta kthyer fytyrën më mirë nga shtetasit e vet dhe për ta patur prioritet mirëqenien dhe lumturinë e tyre. Me këtë kuprojmë se autori, është një analist dinjitoz i situatave e proceseve rajonale e globale dhe duke qenë i tillë, me vizionin e tij shkencor e largpamës apelon përpara organizmave ndërkombëtare për parandalimin e gjenocidit e të traumatizmit psikologjik kudo në botë. Ai i fton partnerët ndërkombëtar për të mos i anashkaluar këto trauma njerëzore, përkundrazi për t'i zbuluar, vlerësuar, hetuar, parandaluar dhe duke dënuar cilin do që shkel të drejtat universale të njeriut, qofshin individë apo shtete.

Libri është një dëshmi e terrorizmit, masakrimit, traumatizmit dhe përpjekjes për shfarosje të popullit kosovar nga ana e okupatorit serb.

Me shqetësimin e një atdhetari të vërtetë, me përkushtimin e një hulumtuesi serioz dhe me vendosmëri të rrallë autori Dibran Fylli ka mundur të zhbirojë thellësisht strategjinë e spastrimit etnik të Kosovës dhe të zbulojë të vërtetën e funksionimit e të veprimit të strukturave policore të sigurimit serb. Ai ka arritur të zbulojë pseudonimet, ndërtimin, funksionimin, përbërjen, drejtuesit e tyre, aksionet terroriste, masakruese e shfarosëse të civilëve të pafajshëm e të pambrojtur në Kosovë.

Ky autor nëpërmjet hulumtimit, investigimit, intervistimit nga ai vetë apo të tjerë nga Europa e bota e jep të qartë tablonë e krimeve, por edhe të strukturave e autorëve të tyre. Ai ka mundur të japë një tablo të qartë për atë çka ndodhur në Kosovë para dhe gjatë ndërhyrjes së NATO-s, me synim mirë të përcaktuar nga

Milloseviqi dhe krerët e tjerë drejtues të shtetit Jugosllav.

Autori i librit zbulon lakuriq të vërtetën mbi masakrat në fshatrat Qyshk, Pavlan dhe Zahaq... etj. Midis tjerash shkruan: *“Të premtën, ditën e ngrohtë me diell, më 14 maj, të vitit 1999 në një kënd të Europës dhe nën bombat e NATO-s, 41 meshkuj nga fshati Qyshk, ishin vrarë nga forcat e kombinuara militare serbe. Moshë nga 19 deri në 69 vjeç. Në mëngjesin e së njëjtës datë, forcat serbe të sigurimit kishin sulmuar dhe dyfshatra të tjerë fqinj, Pavlan dhe Zahaq, ku kishin dëbuar nga shtëpitë gratë, fëmijët dhe pleqtë dhe kishin vrarë në tërësi 72 njerëz.”*

Një nga personazhet e librit e rrëqethur tregon: *“Me këto dy duar unë kam mbledhur eshtrat e dajave të mi, kushërinjve dhe të babait tim. Atë që kishte mbetur nga babai im, e gjeta fare në fund, por jo tërë kufomën. Vetëm disa pjesë nga trupi i tij. Nuk kam gjetur këmbët as kokën. Vetëm brinjët kam gjetur. Dhe me këto duar e kam kallur në dhe kurse, këta-serbët, këta që e kanë vrarë, ata i kanë duart e zhytura me gjak. Ata e kanë vendin në Hagë...”*

Duke lexuar librin e Dibran Fyllit lexuesi takon pseudonime të tillë si : “Frenki”, “OPG”, “Mogla”, “Munja”, “Brigada Cara Dushana” etj . Ata janë struktura të policisë, sigurimit e të Armatës Jugosllave që kanë kryer krimet më makabre që ka njohur njerëzimi, të cilët urdhrat i kanë marrë nga njerëzit e gjeneralët më të besuar të Milloseviçit. Gjithashtu emra të tillë si Dragani, Njebosha Miniq (Mirtvi), Vedamir Shalipuri, Miqo Martinoviq, Gjuro Kastratoviq, Milan Kaljeviq, Obrad Rajiqeviq etj. Kanë qenë pjesëtarë të “Munja” që kanë marrë pjesë në disa përleshje të mëdha me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës... Këta emra ishin më represivët e më të dhunshmit në terrorizimin, dhunimin, djegiet dhe vrasjet e civilëve të pafajshëm në Kosovë, veçanërisht në Pejë, Qyshk, Pavlan, Zahaq etj.

Pjesët me titujt: “Kush duhet të sjellë drejtësi në vend”, “Na

duhet drejtësia sikurse plagës ilaçi”, “Spastrimi etnik dhe ndërgjegjësimi”, “Spastrimi etnik - gjenezë e një ideologjie”, “Përvoja e re, një përvojë e hidhur” etj, tregojnë vizionin e këtij autori, i cili e lejon atë të nxjerri përfundime me vlerë si dhe të japë mesazhe paqe e lirie jo vetëm për Kosovën e kosovarët, por për të gjithë popujt e vendet e botës. Përvoja e fituar dhe ndërgjegjësimi i plotë për krimet dhe gjenocidin serb në Kosovë e atë Çam në Greqi përbëjnë pika kyçe orientimi, por edhe bazamente të forta përvoja për parandalimin e këtyre krimeve e gjenocidi kudo në botë.

Për nga larmia e tematikës, galeria e personazheve, mënyra e pasqyrit, analizat e holla e të thella, hulumtimi serioz, të dhënat e njohuritë si dhe deduktimet e mesazhet që jep libri i autorit Dibran Fylli, përbën një nga librat më të arrirë e shumë interesant, nga i cili kushdo mëson. Ai mbetet një thesar krijimtarie dhe meriton të zë një vend nderi në bibliotekat e gjithë shqiptarëve kudo që punojnë e jetojnë, e më gjerë.

Ky libër shtroi “trasenë” e krijimtarisë së regjisorit, letrarit, poetit Dibran Fylli , i cili nevojitet, të pasurohet gjithnjë e më shumë, me krijimet e autorëve shqiptarë nga të gjitha trevat e viset, ku banojnë e jetojnë.

Krime këta që as mendohen, në realitet, kanë ndodhur dhe dëshmojnë çdo ditë para Evropës e botës. Ja sepse s'ka kohë për pritshmëri, s'ka asnjë mëdyshje dhe s'ka pse të ketë asnjë hezitim nga Tribunali i Hagës për të hetuar dhe vënë para përgjegjësise autorët e këtyre krimeve. Nuk ka arsye të heshtet, të anashkalohen qoftë edhe ata që i kanë kryer, pavarësisht nga ata që i kanë urdhëruar. S'ka asnjë arsye që të heshte e të anashkalohen veprime e qëndrime vandale e shoviniste që shfaqen hera-herës nga serbët në Kosovë dhe grekët me shqiptarët. Qoftë edhe raste të shkëputura duhen vlerësuar me rigorozitet, hetuar dhe parandaluar në kohë. Kjo nuk është histori e trilluar, është realitet dhe është shkruar me

qëllim që të jepet një shpjegim i zbulimeve, të cilat janë bërë përmes projektit “Gjenocidi i forcave serbe kundër shqiptarëve në Kosovë, 1997-1999) i iniciuar dhe i mbështetur nga Presidenti Akademik Prof. Dr. Skendër Kodra, Ph.D, Drejtori i Departamentit për marrëdhënie me publikun (Akademik Prof. Dr. Flori Bruqi, Ph.D) i Akademisë së Shkencave dhe Arteve Shqiptaro-Amerikane në New York, Tiranë, Prishtinë dhe Shkup dhe i shkruar nga autori Akademik Prof. Dibran Fylli, nga Kosova, nga korriku 1997 deri në qershor të vitit 1999 si dhe hulumtimet tjera të tij në këto 20 vitet e fundit si regjisor filmi dhe letrar për viktimat civile, varrezat masive, vrasjet makabre që i ka bërë ushtria, policia e paramilitarët serb në Kosovë.

Dihet mire që Kryeprokurorja Karla Del Ponte/GJND, i dërgoi raportin e parë Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, në nëntor të vitit 1999, në lidhje me gjetjen dhe vendndodhjet e varrezave masive, ku vetëm gjatë gjashtë muajve të parë ishin zbuluar 195 varreza masive me 2 108 kufoma. Në vitin 2000 ishin regjistruar edhe 325 varreza masive me 1 577 të vdekur.

Arsyeja e dytë për këtë projekt është mungesa e hetimit të krimeve ligjore penale për vrasjet e më shumë se 10 600 civilëve dhe mungesa e pranimit zyrtar nga ana e UNMIK-ut, Eulex-it, Republikës së Serbisë ndaj familjeve në lidhje me atë që u ka ndodhur të dashurve të tyre, nga janari i vitit 1998 deri në qershor të vitit 1999.

Arsyeja e tretë dhe ndoshta më e rëndësishmja është se shpresoj që ky libër të mund të shfrytëzohet si bazë e një përpjekjeje për të ringjallur procesin e pajtimit dhe të faljes që UNMIK-u, Eulex-i pretendon se e kishte iniciuar në vitin 1999/2000.

Nga zbulimet e z. Dibran Fylli, më duket se ekziston një vijë e kuqe nga viti 1989 deri në vitin 1999, gjë që i tregon qartë

ndërlidhjet në të gjitha veprimet që ndërmorën autoritetet serbe në Kosovë, kundër popullatës shqiptare, shumicë në Kosovë.

Kjo gjithashtu mbështetet qartazi nga informacioni i zbuluar gjatë dëgjimit gjyqësor në Hagë për rastet e krimeve të luftës kundër ish presidentit të Jugosllavisë Slobodan Milosheviç dhe zyrtarëve të tij të policisë dhe ushtrisë.

Më 26 shkurt 2009, këta ish-zyrtarë policorë dhe ushtarakë të ish-Jugosllavisë dhe Serbisë u dënuan nga Dhoma e III e Gjyqit të Gjykatës për krimet e bëra kundër njerëzimit në Kosovë, në vitin 1999:

1. Ish-zëvendëskryeministri jugosllav, Nikola Shainoviç,
 2. Gjenerali i Armatës Jugosllave, Nebojsa Pavkoviç,
 3. Gjenerali i policisë serbe, Sreten Lukiç, secili prej tyre u dënua me nga 22 vjet burgim për krime kundër njerëzimit dhe për shkak të shkeljes së ligjeve ose zakoneve të luftës.
 4. Gjenerali i Armatës jugosllave, Vlladimir Llazareviç, dhe
 5. Shefi i Personelit të Përgjithshëm, Dragoljub Ojdaniç, u gjetën fajtorë për ndihmën dhe nxitjen e kryerjes së një numri krimesh të dëbimit dhe shpërnguljes së dhunshme të popullatës shqiptare të Kosovës, dhe secili nga ata u dënua me nga 15 vjet burgim.
- Prokuroria i fajësoi që të pestë për krime të bëra gjatë fushatës së terrorit dhe dhunës së drejtuar kundër popullatës etnike shqiptare të Kosovës, në fillim të vitit 1999. Secili nga të akuzuarit kishte pohuar se kishte marrë pjesë në një ndërmarrje të përbashkët kriminale, qëllimi i së cilës ishte të modifikonte ekuilibrin etnik në Kosovë për të siguruar vazhdimin e kontrollit nga autoritetet serbe. Plani duhej të ekzekutohej me mjete kriminale, duke përfshirë internimet, vrasjet, dëbimet dhe përndjekjet e detyrueshme të shqiptarëve të Kosovës.

Gjatë verës së vitit 1999, pas tërheqjes së forcave policore dhe ushtarake serbe, UNHCRja mori raporte të shumta për trupat e

vdekur që gjendeshin në puse dhe në varreza masive gjithandej në Kosovë. Pas disa muajsh ndihmë me rastet e viktimave të puseve, u zbuluan një sërë veprimesh kriminale të bëra kundër fëmijëve të pafajshëm, burrave dhe grave.

Autori Akademik Prof. Dibran Fylli, për aq sa ka qenë e mundur, është përpjekur të sqaroj pothuajse të gjitha masakrat serbe ndaj shqiptarëve që janë bërë në Kosovë (1998-1999); se çfarë ka ndodhur me viktimat e gjetura në puse dhe në varreza masive nëpër Kosovë e Serbi.

Autori ka biseduar dhe ka takuar dëshmitarë, farefisn dhe fqinjët e viktimave. Shumë nga këta kanë folur haptazi për përvojën e tyre dhe kanë dhënë shpjegime, të cilat i kanë argumentuar me fotografitë e asaj që kishte ndodhur. Të tjerët ishin emocionalisht jo të qëndrueshëm ose dukeshin shumë të frikësuar për t'i paraqitur vëzhgimet e tyre lidhur me vrasjet.

Aq sa ishte e mundur, bisedat me dëshmitarët janë paraqitur në formën e tyre origjinale si dhe autori ato gjurmime i ka filmuar dhe disa syresh janë të edituar në RTK.

Kjo është bërë me qëllim që herët apo vonë me synim të qartë që Libri i akademik Fyllit të jetë sa më besnik, e mundur ndaj fakteve dhe gjurmëve historike.

Disa konsiderime të nevojshme u janë kushtuar termave gjuhësore dhe paraqitjes, por sa më pak që ishte e mundur.

Në këtë mënyrë studiuesi (lexuesi) është në gjendje të formojë mendimin e tij për atë se çfarë ndodhi, pikërisht ashtu siç bëri autori, në xhirimet e tij televizive gjatë dhe pas luftës.

“Përparësia” e tij ishte se ai kishte parë me sy shumë krime makabre që i kishin bërë forcat serbe ndaj popullsisë së pambrojtur shqiptare si dhe autori kishte në mendje procesin e gjurmimit dhe verifikimit të rasteve të vrasjeve të shumë civilë shqiptar, që i kishin bërë me pushkatim policia dhe ushtria Jugosllave.

Libri siguron shumë informacione lidhur me këtë, por nuk kalon nëpër zbulimet e detajuara fizike “trup për trup”.

Kjo ndoshta do të bëhej e mërzitshme për lexim, dhe njerëzit, të cilët janë posaçërisht të interesuar, mund të konsultohen me raportin e projektit të ndihmës dhe librin e tij.

Gjithashtu autori ka kufizuar përdorimin e fotografive të trupave të vdekur, sepse një përdorim i tepërt i fotografive të tilla, në vend që të nxisë interesim dhe keqardhje, aktivizon mekanizmat mbrojtës dhe krijon distancë.

Ky libër do t'u japë një identitet shumicës së viktimave (pushkatimeve), vrasjeve në puse si dhe viktimave të varrezave masive, një emër me të cilin lexuesi mund të lidhet - jo vetëm statistika, të cilat nuk thonë asgjë për tragjedinë njerëzore prapa shifrave. Në Kosovë, është traditë që të respektohet i vdekuri, duke ia vendosur fotografinë mbi varrin e tij, nëse është e mundur, dhe njerëzit në Kosovë janë të interesuar në një lloj “pllake përkujtimore”, siç e paraqet edhe ky prezantim. Fatkeqësisht, mjaft viktima në Kosovë, deri më tani kanë mbetur vetëm si numra në statistikat e Kombeve të Bashkuara dhe në Gjykatën Ndërkombëtare të Krimeve të Luftës, në Hagë. Të afërmit e viktimave janë të bindur se ajo që ndodhi faktikisht në Kosovë gjatë periudhës janar 1998, deri në qershor 1999, duhet të dokumentohet dhe publikohet në forumet ballkanike dhe ndërkombëtare.

Ata do të ndjeheshin se u është bërë një padrejtësi e madhe, nëse vuajtjet dhe vrasjet, të cilat ishin fati i aq shumë shqiptarëve të Kosovës, vuajtje të cilat më vonë u ekspozuan si akte kriminale, po tëmbeteshin të panjohura për opinionin e gjerë.

Me kalimin e kohës, për autorin Dibran Fylli është bërë e rëndësishme të mos ua kthej shpinën përvojave të tij. Pas tragjedive shpesh do t'i dëgjoni njerëzit të thonë, “kanë ndodhur aq shumë gjëra sa që është e vështirë të fokusoheni në raste specifike”.

Përderisa e pranojmë se ne as nuk mund të dokumentojmë, e as të marrim tërë të keqen në botë, ndoshta na duhet të fokusohemi në këtë rast, në rastin e Kosovës.

Vrasjet, dhe në shumë raste përdhunimet dhe gjymtimet, të cilat ishin bërë, meritojnë vëmendjen tonë, sepse këto raste paraqesin shembuj shumë të qartë të shkeljeve të së drejtës ndërkombëtare dhe të të drejtave të njeriut. Sipas mendimit tim, këto raste duhet të përfshihen në procesin e pajtimit që duhet të ndodhë midis serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës, më mirë më herët se sa më vonë. Shpresa ime është që ky dokumentim të mund të jetë një pjesë e një baze të projektuar për të iniciuar një qasje ndaj pranimi të padiskutueshëm të asaj se çfarë ka ndodhur, gjatë procesit të pajtimit dhe faljes midis palëve, të cilat kanë qenë fqinjë me shekuj.

Për më tepër, shpresoj që puna e autorit Fylli të mund të shfrytëzohet për të iniciuar një proces të shumëpritur hetimor dhe ndjekjeje penale ndaj autorëve të krimeve të luftës, gjë që do të kishte mundësi të kombinohej me një Komision të së Vërtetës, i ngjashëm me atë që ishte bërë në Afrikën Jugore pas shfuqizimit të ligjit të aparteidit. Me qëllim që të kalohet në procesin e paqes, pranimi ose njohja nga të gjitha palët, janë fjalët kyçe; pa pranimin, nuk do të ndodhë kurrfarë zhvillimi ndërnjerëzor, dhe qëndrimet e vjetra si dhe krijimet e miteve do të vazhdojnë të dominojnë marrëdhëniet e ndërsjella.

Të gjitha të dhënat dhe informacionet në këtë libër, i cili ka të bëjë me viktimat civile, janë hartuar pas kontrollit dhe verifikimit të të dhënave të KNKK-së, GJND-së në Hagë, Qendrës Juridike Humanitare në Beograd, UNMIK-ut/OMPF-së në Prishtinë, dhe OSBE-së në Prishtinë, KMDNJ-së e Burimeve shtesë të autorit janë hulumtimet dhe intervistat e bëra nga vetë autori prej vitit 2001 deri më 2004 dhe nga 2006 deri më 2009.

Emrat e autorëve të krimeve mund të gjenden gjithashtu në secilën komunë, nëregjistrat që i kanë degët lokale të Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDL NJ) dhe OJQ-ve lokale që merren me viktimat e luftës në periudhën 1998-1999.

Autori Dibran Fylli, ka shfrytëzuar të njëjtët emra gjeografikë si edhe burimet si p.sh. KNKK, UNMIK-u /OMPF, HLC dhe tjera organizata që kanë vepruar në Kosovë. Kjo është e nevojshme të bëhet me qëllim të sigurimit të kontrollit të informacioneve dhe të të dhënave, të cilat paraqiten në librin e tij.

Datat për disa ngjarje mund të paraqiten ndryshe nga ajo që bëhet normalisht, p.sh. nuk ka datë ose vend të saktë, sepse trupat e vdekur janë gjetur dhe identifikuar nga ekipet e mjekësisë ligjore të GJND-së nga njësitet OMPF-së gjatë një periudhe dhjetëvjeçare (1999-2009), kur nuk dihet asnjë datë vdekjeje ose zhdukjeje.

Kriminelët serbë kanë përdorur taktikë djallëzore dhe të ligë, duke i zhvendosur viktimat nga vendet ku ishte kryer krimi në vende të tjera, shpesh shumë larg, me qëllim që të maskohet, ose të vështirësohet gjetja dhe identifikimi i trupave të vdekur.

Kjo metodë ishte përdorur në gjithë periudhën e luftës nga janari 1998 deri në qershor 1999. Nga janari 1998 deri qershor 1999, kur dhe ku forcat ushtarake, paraushtarake, policore dhe milicia civile e terrorizuan popullatën civile të shqiptarëve të Kosovës me aksionet e tyre vrasëse dhe shkatërrimtare.

Dokumentet tjera tregojnë se kur dhe ku janë gjetur viktimat pas datës 20 qershor 1999, kur zyrtarët e KFOR-it dhe të UNMIK-ut kishin kontroll të plotë në Kosovë, pas tërheqjes së njësisive të ushtrisë dhe policisë serbe nga Kosova.

Të gjithë trupat e gjetur dhe të identifikuar nga janari 1998 deri më 20 qershor 1999 mund të gjenden në një vend ku janë bërë krimet, ose një vend ku trupat e vdekur janë gjetur në varreza masive, ose vendin ku viktimat kanë lindur ose jetuar.

Të gjithë trupat e gjetur dhe të identifikuar pas 20 qershorit 1999 mund të gjenden në dokumentin e regjistrimit të atyre viktimave, për të cilët data e vdekjes ose zhdukja është e panjohur. Varrezat masive të regjistruara në Serbi, ku janë gjetur të paktën 836 civilë shqiptarë të Kosovës të detyruar fizikisht dhe të terrorizuar në shtëpitë e tyre nga ana e forcave ushtarake, paraushtarake dhe policore serbe, në sulmet e tyre në fshatra, në periudhën shkurt-dhjetor 1998, të regjistruar nga UNHCR-ja.

Këto organizime ushtarake dhe policore ishin makineria e terrorizimit gjithëpërfshirës dhe vrasjeve të rrëmujshme të civilëve shqiptarë të Kosovës, që përfundimisht i detyruan ata ta linin Kosovën. Afro 1 milion civilë dhe rreth 500 000 të tjerë u detyruan ta kalonin kohën të fshehur në pyje dhe male.

Ky projekt nuk do të mund të realizohej pa pjesëmarrjen gjithëpërfshirëse dhe aktive të Akademisë së Shkencave dhe Arteve Shqiptaro-Amerikane, posaçërisht autorit Dibran Fylli, që përgatiti materialin mbi viktimat e luftës...

Prof. Dr. Flori Bruqi

*Drejtori i Departamentit për mardhenie me publikun i
Akademisë së Shkencave dhe Arteve Shqiptaro-Amerikane
në New York, Tiranë, Prishtinë dhe Shkup*

BURIMET DHE LITERATURA

- /Dokumentet mbi politikën e jashtme të Mbretërisë serbe 1903-1914, libri VII, vëllimi 1, f. 617- 618, Beograd 1980/
- Prof. Dr. Hakif Bajrami, /Politika e shfarosjes së shqiptarëve dhe kolonizimi serb i Kosovës 1844-1995/
- Sabile Basha, /Dëbimet e shqiptarëve dhe kolonizimi i Kosovës gjatë viteve 1877/1995/
- /Raportet e publikuara të Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Kosovë /KMDLNJ/
- Dibran Fylli, /Argumente /Drenica dikur e sot /, Tiranë, 1998
- /Shënime nga ditari i luftës/, Açarevë-Drenicë, 1998/1999
- /Krimet serbe në Kosovë, Pa apologji -2/ , Prishtinë
- /Against forgetfulness-Serbian genocide in Kosova 1998-1999/
- Instituti për hulumtimin e krimeve të luftës, /Masakra e Reçakut-Krim kundër njerëzimit/, f.58,147,148, Prishtinë, 2017
- Raporti i Viliam Vokerit, janar 1999
- /Kundër harresës-Gjenocidi i Serbisë në Kosovë/, f.110
- Përshkrim - Bob Dole, 6 shtator 1998, Prishtinë
- Mr. Hajdin Abazi, /Shënime nga Ditari i luftës/, qershor 1998
- Zeqir Bekolli, gazetar i luftës, /Shënime nga ditari i luftës/
- Kosova e Lirë, /Përkujtojmë Dëshmorët e kombit/
- Xhevat Imeri, Shënime Kompleksi Memorial “Adem Jashari”
- Dubravka Stojanoviç, shkencëtare serbe
- Milan Piroçanac, kryeministër i atëhershëm serb
- Dr. Mark Skinner, /Të dhëna nga raporti i ICMP-së/
- Natasha Kandiq, /Gjyqtarja urdhëroi vrasjen e të plagosurve/
- Milazim Kadriu, /Shënime-dëshmi për krimet serbe/, Besianë
- Bedri Tahiri, /Toponimia e Galicës/, Prishtinë, f. 42-44
- Dibran Fylli, /Prekazi brezni trimash/ kronologji, f. 3
- Bedri Tahiri, /Adem Jashari - legjendë e legjendave/, (botimi IV)
- Nga shënimet e Ramë Shabanit dhe Sadie Ramadanit

- Nga shënimet e Bilall Sadri Avdiut, (i mbijetuari i krimit serb)
- Jahir Bejta, Prefekt i Lagjes Nr.2, Skënderaj
- Musa Sabedini, /Vrasje dhe dëshmi/, KMDL NJ.
- KMDL NJ, Instrumentalizim i rrezikshëm i serbëve lokalë në gjenocidin kundër shqiptarëve
- Mr. Kadrush Radogoshi, /Gjakova në shtratin e Prokrustit serb/
- Besim Koci, dëshmitar që i shpëtoi masakrës në Kotlinë
- Radio Kosova e lirë, /Dokumentar për Dëshmorët dhe Martirët/
- Isuf Zheniqi, i mbijetuari i masakrës, /Dëshmi të publikuara/
- Mr.Ibrahim Gashi dhe Mr. Hamdi Fazliu, /Masakra e Celinës-
Masacre in Celina/, f.78-182
- Forumi shqiptar, /Fshati Tërnje/, Një masakër e treguar ndryshe
- Musli Haxha, Shënime dhe dëshmi për krimet serbe
- Gramoz Berisha, i mbijetuari nga masakra e Suharekës
- Valdet Berisha, /Shënime të grumbulluara në terren/
- At dhe Geci, /Gjenocidi serb në Gjilan, Dardanë dhe Viti/
- Lirije Imeraj, dëshmitare e gjallë, e mbijetuara e masakrës
- Daut Imeraj, dëshmitar i gjallë i mbijetuari i masakrës
- Mustafë Dragaj dhe Milazim Thaçi, Dëshmi të dhëna në Hagë
- Raporti i Human Rights Watch
- Milazim Kadriu, Përkujtohen të ekzekutuarit Duriqi e Bogujevci
- Ali Sh. Berisha, /Flijimet për tokën e lirë/ f. 178,179
- Flori Bruqi, /Gjenocidi serbo-malazez në fshatin Beleg/
- Endrit A. Binakaj, /Rrëfime për Masakrën e Belegut/
- Burhan Krasniqi, i mbijetuari nga masakra e Pastaselit, /Dëshmi/
- Tahir Krasniqi, i mbijetuari nga masakra e Pastaselit, /Dëshmi/
- HRW, /Në Pushtetin e Urdhrave, Krimet e Luftës në Kosovë/
- Pajazit Krasniqi, /Lugina e vdekjes/, f.39-146, Prishtinë 2008
- Habib Zogaj, Reporter i luftës, /Shënime nga ditari/
- Ahmet Graçevci, /Zyra për të zhdukurit dhe krime lufte/
- Fadil H. Curri, /Shënime nga terreni për fshatin Mazgit/

- Arkiva e zyrës për zhvillim, Kastriot
- ICRC /Personat e zhdukur, në lidhje me ngjarjet në Kosovë/
- Fondi për të drejtën humanitare, /Dëshmi/
- Hysni Gucati, /Shënime nga ditari/
- Atifete Bytyqi, Shoqata “Familja dhe shpresa”, /Dëshmi/
- Valdet Berisha & Fatmir Morina, /Mes dhembjes dhe shpresës/
- Shoqata për të pagjeturit, Klinë,
- Shënime nga Hamdi K. Aliut, /Krimet serbe në Rezallë/
- Prend Buzhala, /Fletore luftime/
- Ali Gashi, /Shënime nga ditari i luftës/
- Bardhyl Mahmuti, /Mashtrimi i madh/, Botimi III, f.544
- /Rrefime/, Brian Honeybourn, hetues i krimeve të luftës
- Revista “Albi”, Nr.2, Besianë (ish Podujevë)
- Kamil Bitiş, Stamboll, /Për krimet serbe në Kosovë/
- Shënime - dëshmitarët e mbijetuar të masakrës së Poklekut
- Remzije Ferati-Isufi, /Masakra në Familjen Reka/, dokumentar
- Raportet e Mjekësisë ligjore për identifikimin e mbetjeve mortore të Masakres së Mejes
- Sheremet Prokshi, /Fortesa e fundprillit '99/
- Regjistër i të vrarëve dhe të masakruarve 1998/1999, KK Drenas
- Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës
- Bedri Halimi, /Opoja - Aspekti historik, Viktimat njerëzore të terrorit serb në Opojë gjatë viteve 1998-1999/, faqe 505
- KMDLNJ, /Raporti për krimet serbe në Kosovë, 1999/
- Të dhëna dhe shënime nga Argjend Muriqi-Amerikë
- Izet Miftari /Fakte dhe dëshmi për Masakrën e Studimës/
- Prof. Fadil Beqiri, /Akterët e Masakrës në Studime /
- Ferit B. Dibrani, /Rrëfimet për krimet serbe/, f. 149-150
- Xhavit Dauti, /Shënime të mledhuara nga dëshmitarët e gjallë/
- Hajrush Redenica, Dardanë, /Kika II/, Prishtinë 2018
- /Masakra e Qyshkut/, dëshmitë e Akifit dhe Lules/ (HRW)

- /Masakra e Qyshkut/, Raportet e "Human Rights Watch"
- Vushtrria online, /Një rrëfim i rrallë për Masakrën e 22 Majit/
- Rexhep Thaçi, Carrallukë, /Shënime personale/
- Safet Hasani, /Qyteti tragjik/, f.129, 130, 131
- Agron Shala, /Dosja e hapur - Masakra e Dubravës /
- Krimet e luftës në Kosovë 1998-1999, /Monografi 1/
- Raporti i Organizatës "Human Rights Watch" (1999)
- Raportet e KMDLNJ-së, /Gjatë luftës në Prizren /
- Prof. Dr. Jusuf Osmani, /Krimet e Serbisë në Kosovë/, f.464
- KMDLNJ, /Nata e tmerrit/, Mitrovicë, 2000
- Shënimet nga raportet e KMDLNJ-së, Prishtinë 1998/1999/2000
- /Krimet e luftës në Kosovë, (Monografi 1, fq. 46 – 48)
- "Koha ditore", shtator 1998
- Dibran Fylli, /Shënime nga ditari i luftës/, Likofc-Drenicë
- HRW, /Trupat e viktimave - dëshmi të qarta të kasaphanës/
- Gazeta "Koha Ditore", 30.9.1998
- QIK, Informatori ditor nr. 2198 D, Prishtinë, 1 tetor 1998
- HRW, /Një javë e terrorit në Drenicë/ shkurt 1999
- HRW /Nën pushtetin e urdhrave/- Krimet e luftës në Kosovë
- KMDLNJ, Raport mbi shkeljen e të drejtave të njeriut 1998
- Shënimet dhe dëshmitë e Muhamet Ferizajt, fshati Kodrali
- Zëri, /Krimet serbe në Kosovë/
- Patrick Ball, AAAS, "Arratia e shqiptarëve etnikë nga Kosova/
- Gazeta e përditshme shqiptare "Fakti", Shkup, 12 maj 1999
- Jehona Shyti, /Dhunimet si krime kundër njerëzimit/.
- "Flaka" Shkup, 24 maj 1999
- Luljeta Selimi, /Femrat e dhunuara gjatë luftës/...,
- Luljeta Selimi, /Dosja e dhunimit/
- Revista Ekskluzive Nr.1, janar 2000, f.101,
- Revista Ekskluzive Nr.4, prill 2000, f.52
- Raporti i Njësitit të TMK-së, Bat. I-rë, Brigada 121, tetor 1999



Dibran Fylli i lindur më 29.9.1956, në fshatin Açarevë të Skënderajt. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen në Mitrovicë. Para diplomimit në Shkollën e Lartë Teknike, për shkak të rrethanave të kohës, detyrohet të largohet nga Kosova dhe të vendoset në qytetin e Lubjanës. Atje regjistrohet dhe diplomon në Akademinë për Teatër, Radio, Film dhe Televizion (AGRFT), për regji.

Në Kosovë kthehet në vitin 1993 për t'i vazhduar aktivitetet e tij dhe për t'iu bashkuar radhëve të para të UÇK-së. Është pjesëmarrës i shumë betejave, por Beteja e Grykës së Llapushnikut për të është më e veçanta, ku edhe plagoset.

Gjatë luftës i ka botuar veprat: “Argumente-Drenica dikur dhe sot”, Tiranë, 1998 dhe “Të fala nga Stambolli”, poezi, Tiranë, 1998. Është themelues i Trupës Artistike Ushtarake (TAU) “Hamëz Jashari” të UÇK-së, i Manifestimit “Ai është gjallë” (tash “Epopeja e UÇK-së”, 5, 6 e 7 mars, e njohur për opinionin si “Nata e Zjarreve”, pastaj i Festivalit Folklorik “I këndojmë lirisë” në Klinë, i cili mbahet më 6, 7, 8 qershor si dhe i shumë aktiviteteve të tjera kulturore në mbarë Kosovën.

Ka të botuar këto vepra:

- “Argumente-Drenica dikur e sot”, Tiranë, 1998,
- “Të fala nga Stambolli”, poezi, Tiranë, 1998,
- “Ai është gjallë”, poezi, LSHK, Prishtinë, 2000,
- “Sharkia e Drenicës”, “Vorea Ujko”, Klinë, 2005,
- “Edhe kjo është pjesë e jetës”, roman, “Vorea Ujko”, Klinë, 2005,
- “Ditari i Tafrruk Tafrrukucit”, komedi, “Vorea Ujko”, 2006,
- “1365 ditët e jolirisë”, poezi, Prishtinë, 2011,
- “Udhët e sakrificës”, ditar, Prishtinë, 2012,
- “Prekazi brezni trimash”, kronologji, LSHK, Prishtinë, 2012

- “Hasan Prishtina - stërnip i Abdullah Veliqit”, monografi, “Meshari”, Prishtinë, 2013,
- “edhe kjo është pjesë e jetës”, roman (ribotim), Prishtinë, 2013,
- “Sharkia e Drenicës” (ribotim), Prishtinë, 2014,
- ”Tahir Meha - 5 breza pushke lirie”, kronologji, Prishtinë, 2014,
- “Lulëkuqet e lirisë” - Çdo shesh, një përmendore, Antologji poetike, Prishtinë, 2015
- “Prekazi brezni trimash”, kronologji, (ribotim) në shtatë gjuhë, LSHK, Prishtinë, 2016,
- “Fryma e lirisë”, poezi “Meshari”, Prishtinë, 2017,
- “Hasan Prishtina-stërnip i Abdullah Veliqit”, monografi, (ribotim), Prishtinë, 2018
- “Penë e pushkë”, poezi, SHB “Naim Frashëri”, Prishtinë 2018,
- “Tokë e mbjellë me varre” - Krimet serbe në Kosovë 1998/1999, është vepra e radhës e autorit Dibran Fylli.

Dibran Fylli është autor i 35 filmave dokumentarë për dëshmorët e kombit të të gjitha kohërave, të edituar dhe të arkivuar në arkivin e RTK-së, autor i mbi 200 fotografive ekskluzive gjatë kohës të luftës së lavdishme të UÇK-së, xhirues i shumë pamjeve e ngjarjeve nëpër zonat e luftës. Është autor i disa filmave artistikë të metrazhit të gjatë dhe të shkurtër, si dhe i dhjetëra roleve të realizuar në filma të regjisorëve në Kosovë, Shqipëri e Maqedoni. Me filmin e metrazhit të shkurtër “Qyteti i zi”, është pjesëmarrës në tri Festivale ndërkombëtare; Festivalin ndërkombëtar të filmit Ballkanik në Pogradec, Festivalin e filmit “Hyjnesha në fron” dhe Festivalin ndërkombëtar të filmit në Nju Jork-SHBA.

Është anëtar i kryesisë në Lidhjen e Shkrimtarëve të Kosovës. Anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve Shqiptaro-Amerikane të Nju Jorkut.

Jeton dhe vepron në Prishtinë.

NË VEND TË HYRJES

Kosova.....	7
Projektet antishqiptare.....	9
Mbretëritë sunduese.....	11
Historia tregon.....	12
Ëndrra serbe-Serbia e madhe.....	14
Marrëveshja turko-jugosllave e vitit 1938.....	15
Pakti Ballkanik 28.02.1953.....	15
Fakte të viteve 1920/1921.....	17
Drenica flamurtare e lirisë.....	20
Populli liridashës.....	20
Lufta e UÇK-së ishte e pashmangshme.....	21
28 Nëntori i ri.....	23
UÇK ndërron pozicionet dhe taktikën.....	24
UÇK - realitet dhe e sigurt në fitore.....	26
Raporti i ICPM-së-Dr. Mark Skinner	28

KRIMET SERBE NË KOSOVË

Masakra e Likashanit dhe e Qirezit (28.02.1998).....	31
Prekazi - djep i lirisë (5, 6, 7 mars 1998).....	34
Drenica e Janar - Tetorit 1998.....	38
Krimet serbe afër Pikës C-2-Koshare (22-23.04.1998).....	40
Krimet serbe në Lybeniq (25-29.05.1998).....	42
Krimet serbe në Rancë të Shtimes (26.08.1998).....	43
Masakra e Lepajës (15.09.1998).....	44
Krimet serbe në Qyqavicë - Galicë (22.09.1998).....	45
Krimet serbe në Ashlan (22.09.1998).....	47
Masakra e Abrisë (26.09.1998).....	48
Masakra e Reçakut (15.01.1999).....	50
Raporti i Wiliam Wokerit.....	55
Krimi serb në Rakovinë (24.01.1999).....	56

Masakra në Rogovë të Hasit (27-29.01.1999).....	57
Krimet serbe në Skënderaj (20.03.1999).....	59
Krimet serbe në Gjilan, Dardanë e Viti (Mars-Qershor 1999)..	61
Krimet serbe në Gjakovë (24-26.03.1999).....	62
Masakra në Kotlinë të Kaçanikut (24.03.1999).....	64
Masakra në Bellacerkë (25.03.1999).....	66
Krimet serbe në Opterushë (25.03.1999).....	69
Masakra në Celinë (25-26.03.1999).....	71
Masakra në fshatin Tërnje të Therandës (25-28.03.1999).....	74
Krimet serbe në Açarevë (1998/1999) (26.03.1999).....	77
Masakra në familjen Berisha (26.03.1999).....	79
Krimet serbe në Resnik-Klinë (26.03.1999).....	81
Masakra në familjen Imeraj (26.03.1999).....	82
Masakra e Izbicës (28.03.1999).....	84
Krimet serbe në Podujevë (28.03.1999).....	92
Krimet serbe në Poterç të Epërm (29.03.1999).....	93
Krimet serbe në Zllatar, Matiçan, Kodra e Diellit.....	94
Masakra e Irzniqit dhe Belegut (29-30.03.1999).....	95
Masakra e Rudinës (ish-Pastasel) (31.03.1999).....	98
Masakra në Burim të Malishevës (31.03.1999).....	104
Krimet serbe në komunën s Fushë-Kosovës 1999.....	106
Masakra në Krushë të Madhe (25, 26 e 27.03.1999).....	111
Krimet serbe në Mazgit të Ulët (Mars-Maj 1999).....	119
Krimet serbe në komunën e Lypjanit (1998-1999).....	120
Krimet serbe në komunën e Kastriotit (1998-1999).....	126
Krimet serbe në Rahovec (1998-1999).....	129
Masakra në Shtëpinë e Mehdi Vejsës (01-02.04.1999).....	134
Masakra në Mëhallë të Qerimit (1-2.04.1999).....	136
Krimet serbe në Morinë-Skënderaj (02.04.1999).....	138
Krimet serbe në Volljak-Klinë (02.04.1999).....	140
Krimet serbe në Batllavë e Koliq (04.04-25.05.1999).....	141

Masakra e Kralanit (04.04.1999).....	142
Masakra e Rezallës (5.04.1999).....	148
Krimet serbe në Çabiq-Klinë (07.04.1999).....	152
Krimet serbe në Llashticë (13-30.04.1999).....	154
Krimet serbe në Rugën e Kovaçëve në Mitrovicë	155
Krimet serbe së Bellopojë (14.04-19.05.1999).....	156
Krimet serbe në Shamalluk (15.04.1999).....	157
Krimet serbe në fshatin Sllovi të Lipjanit (15-16.04.1999)....	158
Krimet serbe në Mramor-Busi (15-22.04.1999).....	160
Krimet serbe të “Lugu i Demës” Sllovi (16.04.1999).....	161
Masakra e Poklekut-Drenas (17.04.1999).....	162
Krimet serbe në Dyz (18.04.1999).....	165
Krimet serbe në Bërnice dhe Milevc (18.04.1999).....	167
Krimet serbe në Koliq (18-19.04.1999).....	168
Krimet serbe në Grashticë (19-21.04.1999).....	170
Krimet serbe në Rimanishtë (19.04.1999).....	171
Masakra e Mejës-Gjakovë (27.04.1999).....	172
Krimet serbe, Prill-Maj 1999.....	179
Krimet serbe në Fortesë, ish-Vërbovc (31.04-03.05.1999).....	181
Krimet serbe në Grashticë-Keqekollë (1999).....	185
Krimet serbe në Tërstenik-Drenas (1998-1999).....	186
Krimet serbe në Shtuticë-Drenas (1998-1999).....	188
Krimet serbe në Opojë (1998-1999).....	191
Krimet serbe në Nabërgjan të Pejës (01-14.05.1999).....	192
Masakra e Studimes-Vushtrri (02.05.1999).....	194
Krimet serbe në hekurudhën Lipjan-Fushë Kosovë.....	200
Krimet serbe në Shtupel-Klinë (06.05.1999).....	201
Krimet serbe në Kamenicë (11.05.1999).....	202
Masakra në fshatin Qyshk (14.05.1999).....	203
Krimet serbe në Pavlan dhe Zahaq (14.05.1999).....	206
Krimet serbe në Vushtrri (Prill-Maj 1999).....	208

Masakra në Carrallukë të Malisevës (1998-17.05.1999).....	210
Masakra në Shtëpinë e Sezai Pasomës (22.05.1999).....	212
Masakra e Dubravës (22.05.1999).....	215
Krimet serbe në Pakashticë (25.05.1999).....	222
Krimet serbe në Deçan (26.05.1998).....	223
Masakra në Lagjen Tusus të Prizrenit (26.05.1999).....	224
Krimet serbe në familjen Kastrati Fusha e Pejës.....	226
Masakra në familjen e Selatin Gërxheliut në Vushtri.....	227
Krimet serbe në familjen Bala në Pejë (12.06.1999).....	228
Krimet serbe në komunën e Zveçanit (1998-1999).....	229
Krimet e Strukturave kriminale serbe në Mitrovicë...230	

**RAPORTE-DËSHMI
PËR KRIMET SERBE NË KOSOVË**

Vrasjet, ekzekutimet, masakrat.....	233
Krimet serbe në Drenicë (Shtator 1998).....	235
Raporti i KMDL NJ-së (1998-1999).....	236
Raporti i KMDL NJ-së (26.04 - 31.05.1998).....	237
Janar-Shtator 1998.....	238
Qershor 1998.....	240
Korrik 1998.....	240
29 janar 1999.....	241
Janar-Mars 1999.....	242
Raporti i KMDL NJ-së (25.03-21.05.1999).....	244
Mars 1999.....	246
25-27 mars 1999.....	248
Prill 1999.....	249
14-30 prill 1999.....	251
Mars-Qershor 1999.....	252

ORGANIZATAT E HUAJA
PËR KRIMET SERBE NË KOSOVË

Burgosjet dhe kidnapimet.....	257
Spastrimi etnik.....	258
Dhunimet.....	259
Superstruktura kriminale serbe.....	262

KUSH ISHIN KRIMINELËT?

Emrat e kriminelëve serbë që kryen masakra në Kosovë.....	265
Në Reçak.....	266
Në Gjakovë.....	267
Në Padalishtë.....	268
Në Izbicë.....	269
Në Sankoc – Drenicë.....	272
Në Sllatinë.....	273
Në Qyshk.....	274
Në Kishnicë.....	275
Në Klinë.....	277
Në Viti.....	280
Në Fushë-Kosovë.....	281
Askush s'i ndjek kriminelët!.....	282
Kanadezi kujton: Viktima më e re ishte 2-vjeçare, më e vjetra 105.....	285
Fjala e botuesit.....	287
Fjala e recensentit.....	293
Burimet dhe literatura.....	306
Biografia e autorit.....	310

Dibran Fylli
TOKË E MBJELLË ME VARRE
Krimet serbe në Kosovë 1998/1999

Shtëpia botuese
ProkultPress

Formati: 21cm

Tirazhi: 500 copë

Shtypi “Graphical house”
Prishtinë, 2019

Katalogimi në botim - (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

323.282(496.51)“1998/ 1999”

Fylli, Dibran

Tokë e mbjellë me varre : argumente : krimet serbe
në Kosovë 1998/1999 / Dibran Fylli. – Prishtinë,
ProkultPress, 2019. – 317 f. : ilustr. ; 21 cm.

ISBN 978-9951-726-86-3



Botimin e librit për 200 ekzemplar e financoi
Organizata e Veteranëve të Luftës të UÇK-së
Selia Qendrore
Prishtinë
